

MINISTRIA E FINANCAVE

Raport për Zbatimin
e Buxhetit të vitit
2014

Përmbledhje ekzekutive	4
I. HYRJE	5
1.1 Objektivat e Buxhetit 2014	5
1.2 Karakteristikat kryesore të buxhetit 2014	5
II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE	6
2.1 Zhvillimet kryesore makroekonomike	6
2.2 Krahasimi me vendet e rajonit	8
III. POLITIKAT FISKALE DHE EFEKTET NË EKONOMI	11
3.1 Ndryshimet fiskale në vitin 2014 dhe efektet në ekonomi e buxhet.....	11
3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera	21
IV. POLITIKAT E SHPENZIMEVE BUXHETORE	26
4.1 Analiza e shpenzimeve buxhetore	26
4.2 Buxheti i pushtetit vendor	48
4.3 Detyrimet e prapambetura.....	50
4.4 Buxheti i Skemave të Sigurimeve Shoqërore.....	53
4.5 Buxheti i Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.....	59
V. ANEKS: MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE PUBLIKE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS.....	66
5.1 MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES.....	66
5.2 MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE.....	70
5.3 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS	78
5.4 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	86
5.5 MINISTRIA E SHËNDETËSISË.....	100
5.6 MINISTRIA E DREJTËSISË... ..	104
5.7 MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME	108
5.8 MINISTRIA E MBROJTJES	119

5.9	MINISTRIA E KULTURËS	120
5.10	MINISTRIA E FINANCAVE	124
5.10	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	127
5.11	MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË.....	132
5.12	MINISTRIA E MJEDISIT.....	135
5.13	MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN	137
5. 14	MINISTRIA E ENERGISË DHE INDUSTRISE	144
5.16	MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT	150

Përmbledhje ekzekutive

Ekonomia shqiptare ka shfaqur shenja përmirësimi gjatë vitit 2014 duke shënuar shifra pozitive të rritjes tremujore me përjashtim të tremujorit të dytë. Vlera e shtuar në ekonomi ka regjistruar një rritje prej 1.89 për qind krahasuar me vitin 2013. Rritja e kërkesës agregate gjatë vitit 2014 i atribuohet kryesisht zgjerimit të konsumit privat dhe në një masë më të ulët, rritjes së investimeve private dhe konsumit të sektorit publik.

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore arritën në 366.7 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 12.1 për qind krahasuar me vitin 2013, ndërsa në raport me PBB u rritën në 26 për qind nga 24.1 për qind të PBB për vitin 2013.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 253.4 miliardë lekë ose 10.7 për qind më shumë krahasuar me një viti më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 12.4 miliardë lekë nga 12.8 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë dhe me rritje vjetore prej 15 për qind më shumë; të ardhurat nga fondet speciale arritën 70 miliardë lekë, me realizim prej 110.1 për qind dhe me rritje vjetore 16.5 për qind ose 9.9 miliardë leke; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën rreth 10.1 miliardë lekë nga rreth 5.7 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore janë realizuar në rreth 20.7 miliardë lekë.

Administrata doganore ka mbledhur 150.7 miliardë lekë ose rreth 11 miliardë lekë më shumë se një vit më parë, me rritje pothuajse 8 për qind. Administrata tatimore ka mbledhur (përfshirë kontributet) 163.7 miliardë lekë, që do të thotë 13.3 për qind më shumë të ardhura se ato të vitit 2013 ose 19.2 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të vitit 2014, arritën në 438.8 miliardë lekë me një nivel realizimi prej 96.2 për qind ose 17.5 miliardë lekë më pak se planifikimi. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë 44.7 miliardë lekë më shumë ose rreth 11.3 për qind më të larta. Këto shpenzime në fund të vitit 2014 përllogariten në rreth 31 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), nga 28.4 për qind që arritën një vit më parë. Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë vitit 2014, shpenzimet korrente zënë rreth 78 për qind, ndërkohë që shpenzimet për investime zënë rreth 14 për qind dhe detyrimet e prapambetura 8 për qind. Shpenzimet korrente në fund të vitit 2014, kanë arritur në nivelin 441 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rezultojnë 12.3 miliardë lekë më shumë ose 3.8 për qind më të larta. Shpenzimet kapitale deri në fund të vitit 2014 janë realizuar në rreth 92 për qind të planit vjetor. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 96.2 për qind të planit vjetor, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në rreth 90 për qind të parashikimit vjetor. Mosrealizimi i shpenzimeve kapitale lidhet kryesisht me mosrealizimin e fondeve të planifikuara me financim të huaj. Investimet në vitin 2014 arritën në rreth 4 për qind të PBB-së ose nëse ju shtojmë dhe detyrimet e prapambetura të paguara (për investime publike) gjatë vitit 2014 ato arrijnë në 5 për qind të PBB-së nga rreth 4.6 për qind që rezultuan një vit më parë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, investimet gjithsej, duke përfshirë dhe detyrimet e prapambetura, janë rreth 5 miliardë lekë më të mëdha se ato në vitin 2013 ose 7.5 për qind më të larta.

Deficiti i përgjithshëm i buxhetit të shtetit u realizua në masën 81.5 për qind, duke arritur në këtë mënyrë në rreth 5 për qind të PBB-së nga 4.9 për qind që ishte një vit më parë. Financimi i brendshëm i deficitit u realizua në masën 83.4 për qind të parashikimit vjetor, ndërkohë që

financimi i jashtëm u realizua në rreth 79.1 për qind të këtij parashikimi. Huamarrja e brendshme, u realizua në masën 76 për qind.

I. HYRJE

1.1 Objektivat e Buxhetit 2014

Buxheti i vitit 2014 siguroi:

- Rivendosjen e stabilitetit makroekonomik e fiskal, nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme buxhetore ndaj sektorëve prioritarë, të tillë si: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura.
 - *Arritja e një marrëveshje dy palëshe bashkëpunimi me FMN, për të mundësuar uljen graduale të borxhit publik dhe reformat në sektorët kyç të ekonomisë.*
- Vendosjen e një sistemi të shëndetshëm të menaxhimit financiar, i cili nuk do të lejojë krijimin dhe mbartjen e detyrimeve të prapambetura financiare, kryesisht ndaj biznesit, si dhe do të realizojë shlyerjen graduale të stokut të detyrimeve të krijuara tashmë;
 - *Shlyerja e rreth 50 për qind të detyrimeve të prapambetura të evidentuara nga procesi gjithëpërfshirës i auditimit të tyre.*

1.2 Karakteristikat kryesore të buxhetit 2014

- Çdo politikë e re buxhetore/financiare reflektoi opinionin e publikut, biznesit apo shoqërisë civile;
- U shlyhen detyrimet e prapambetura të qeverisë ndaj biznesit për punë dhe shërbime publike të kryera, si dhe rimbursim i TVSH-së dhe tatim fitimit prej rreth 34 miliardë lekë. Kjo krijon hapësirë për më shumë likuiditet dhe investime, që çuan në më shumë kredi dhe punësim;
- Përfitimet sociale shkuan tek ata që e meritojnë dhe jo tek ata që paguajnë për ta përfitur;
- Arsimi ishte prioritet dhe u fokusuar drejt atij profesional, me qëllim sigurimin e një lidhjeje më të mirë mes tregut të punës dhe arsimimit të brezit të ri;
- Shëndetësia ofroi shërbime publike më cilësore, nëpërmjet sigurimit të një mbështetjeje të veçantë ndaj shërbimit spitalor dhe kryerjes së diagnostifikimit falas;
- Fermerët përfituan subvencione, në përputhje me nivelin e prodhimit bujqësor të realizuar;
- Shtresat në nevojë u kompensuan nëpërmjet skemave sociale më transparente dhe ekonomike;
- U hoq tatimi i biznesit të vogël gjë e cila ndikoi pozitivisht në sipërmarrjen private;
- U ul tatim fitimi i biznesit të vogël nga 10 për qind në 7.5 për qind gjë e cila ndikoi pozitivisht në sipërmarrjen private;
- Publiku kishte një qeveri më të vogël, por më eficiente dhe më pak burokratike.

II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE

2.1 Zhvillimet kryesore makroekonomike

Për vitin 2014, sipas vlerësimit paraprak të mbështetur në treguesin e Vlerës së Shtuar Bruto tremujore, ekonomia pati një rritje prej 1.89 për qind krahasuar me vitin 2013. Gjatë vitit 2014 ekonomia shqiptare ka shfaqur shenja përmirësimi duke shënuar shifra pozitive të rritjes tremujore me përjashtim të tremujorit të dytë. Në tremujorin e katërt të vitit 2014 ekonomia **u rrit me 2.42 për qind** kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2013, ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës të vitit 2014 **u rrit me 1.12 për qind**. Kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit ekonomik e dha sektori i ndërtimit, me 1.56 pikë përqindje, pasuar nga “*Shërbimet e tjera*” me 1 pikë përqindje. Me përjashtim të “*Postës dhe komunikacionit*” dhe “*Bujqësisë*”, degë të cilat pësuan një rënie përkatësisht prej 9.5 për qind dhe 2.7 për qind, rritja ekonomike deri në tremujorin e katërt u mbështet nga zgjerimi i aktivitetit në të gjitha degët e ekonomisë. Kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit ekonomik e dha sektori i ndërtimit, me 1.56 pikë përqindje, pasuar nga “*Shërbimet e tjera*” me 1 pikë përqindje. Në tremujorin e tretë të 2014, degët që shënuan rritje vjetore kanë qenë: “*Ndërtimi*” me rritje prej +10.8 për qind, “*Tregti, Hotele dhe Restorante*” me rritje prej +3.3 për qind, “*Shërbime të Tjera*” me rritje prej +3.2 për qind, “*Transporti*” me rritje prej 3.0 për qind dhe “*Industria*” me rritje prej +1.6 për qind.

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, struktura e rritjes ekonomike është ushqyer kryesisht nga kërkesa e brendshme. Rritja e besimit në ekonomi dhe kushtet e favorshme financiare kanë mbështetur rritjen e konsumit dhe të investimeve private gjatë vitit 2014. Investimet private u ndikuan pozitivisht nga rritja e besimit të bizneseve, rritja e kapaciteteve shfrytëzuese, rritja e numrit të porosive të reja dhe lehtësimi i kushteve të kreditimit. Flukset hyrëse të IHD-ve, (duke e pastruar nga privatizimet me kapital të huaj) mbështetën rritjen e këtij komponenti, veçanërisht në tremujorin e parë të vitit. Rikuperimi i investimeve, do të varet nga rritja e qëndrueshme e kërkesës për mallra dhe shërbime, si dhe nga vazhdimi i përmirësimit të kushteve financiare. Ndërkohë që kërkesa e jashtme vlerësohet të ketë patur një kontribut lehtësisht negativ.

Të dhënat e papunësisë sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës (LFS) tregojnë një rritje të punësimit gjatë 2014 dhe gjithashtu një rritje të normës së papunësisë krahasuar me 2013. Norma e papunësisë në tremujorin e katër 2014 ishte 18.0 për qind kundrejt 17.1 për qind që ishte një vit më parë. Në tremujorin e katërt të vitit 2014 numri i personave të punësuar në moshë pune (15-64 vjeç) ishte 1,039,336. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë ai u rrit me 82,628 persona ose 8.6 për qind. Numri i personave të papunë në moshë pune ishte 227,407, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë ai u rrit me 30,458 persona.

Ekonomia shqiptare vijon të regjistrojë vlera të ulta të inflacionit nën objektivin e Bankës së Shqipërisë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, inflacioni mesatar rezultoi 1.6 për qind, më i ulët se ai i vitit 2013. Inflacioni në muajin dhjetor shënoi vlerën 0.7 për qind. Rënia e theksuar e inflacionit gjatë këtij muaji u diktua nga rritja e ulët e çmimeve të prodhimeve ushqimore dhe nga rënia e vazhduar e çmimit të naftës, e cila ka ulur më tej kostot e prodhimit e të transportit të mallrave dhe shërbimeve. Në aspektin makroekonomik, nivelet e ulëta të inflacionit vazhdojnë të përcaktohen nga ecuria e dobët e kërkesës agregate, por ngadalësimi i fortë i inflacionit gjatë

tremujorit të fundit duket se i detyrohet më së shumti rënies së inflacionit të importuar. Norma bazë e interesit ka qendruar në nivelin e 2.25 për qind që prej muajit maj 2014.

Treguesit monetarë kanë shfaqur dinamikë të dobët gjatë vitit 2014, duke reflektuar kërkesën e ulët të ekonomisë për financim. Rritja vjetore e agregatit M3 ka shënuar një vlerë të lartë rritje vjetore prej 4 për qind vetëm në muajin e fundit të 2014. Deri në muajin dhjetor të vitit 2014 depozitat janë rritur me 1.02 për qind dhe kredia me 2.2 për qind në krahasim me dhjetorin e vitit 2013. Financimi i sektorit publik nga ana e bankave ka qenë i ulët, ndërkohë që kontributi i kredisë në ekonomi u kthye pozitiv vetëm në tremujorin e tretë të vitit, pas tkurrjes së vërejtur në 12 muajt e mëparshëm. Megjithatë, ky gjallërim mbetet ende i brishtë. Bankat, bizneset dhe individët vazhdojnë të kenë qasje konservatore ndaj riskut. Rritja e kredisë është e segmentuar, si në terma të bankave aktive në kreditim, ashtu edhe në drejtim të sektorëve të ekonomisë që janë financuar. Kredia për biznese ka qenë nxitësi kryesor i rritjes së kredisë për sektorin privat. Ajo ka regjistruar fluks pozitiv në këta dy muajt, kryesisht në formën e financimit afatshkurtër. Në fund të muajit dhjetor, rritja vjetore e saj ishte 2.4 për qind. Përmirësimi i kredisë për biznese është më i pranishëm në kredinë për likuiditet dhe më pak në atë për investime.

Në anën tjetër, kredia për individë ka shfaqur një ecuri të dobët. Rritja vjetore e kredisë për individë shënoi 1.2 për qind në fund të muajit dhjetor. Zhvillim pozitiv dhe i qëndrueshëm është rritja e dukshme e kreditimit në lekë, kundrejt një ecurie të dobët të atij në valutë, duke ndihmuar kështu një përcjellje më të mirë të stimullit monetar në ekonomi. Kredia në lekë u rrit me 6.1 për qind në terma vjetorë në muajin dhjetor, ndërkohë që kredia në valutë është tkurrur me 0.4 për qind kundrejt vitit të kaluar. Niveli i kredive me probleme deri në tremujorin e katërt të vitit 2014 ka shkuar në nivelin e 22.8 për qind, duke pësuar një rënie prej 2.2 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Pjesa dërrmuese e kredive me probleme, vijon të mbulohet me nivele të larta provigjionesh të rezervuara nga sistemi bankar. Parametrat e shëndetit të sistemit bankar në tërësi paraqiten në nivele të konsoliduara dhe relativisht mjaft të sigurta. Gjithashtu vihet re një përmirësim i këtyre parametrave kundrejt një vitit më parë, kjo si për sa i takon mjaftueshmërisë së kapitalit, likuiditetit të tij, ashtu edhe normës së fitimit të sistemit bankar.

Në tremujorin e fundit, një Euro u këmbye mesatarisht me 139.74 lekë ose 0.5 për qind më lirë se një vit më parë. Ndonëse në këtë periudhë deficitit tregtar rezultoi në zgjerim, prurjet më të larta valutore në terma vjetorë, të sinjalizuara nga depozitat, si dhe nënçmimi i euros në tregjet ndërkombëtare, duket të kenë dobësuar pozitat e tij edhe në tregun vendas. Dollari amerikan vazhdoi të fitojë terren ndaj lekut, si në terma vjetorë (8.4 për qind) ashtu edhe në ato tremujorë (6.1 për qind), duke reflektuar trajektoren e kursit euro/ dollar në tregje ndërkombëtare në tremujorin e katërt. Në këtë periudhë, vlera mesatare e një Dollari amerikan ishte përafërsisht 114 lekë, ndër më lartët në dy vitet e fundit.

Eksportet për periudhën janar – dhjetor 2014 ishin 3.8 për qind më të larta se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Importet e mallrave për periudhën janar - dhjetor 2014 ishin 6.7 për qind më të larta se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficitit tregtar për periudhën janar – dhjetor 2014 është përkeqësuar me 9.4 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve është 46.3 për qind.

Në terma të ndikimit në ekonomi, ecuria e regjistruar vlerësohet të ketë dhënë një kontribut negativ prej 3.8 pikësh përqindjeje në ndryshimin vjetor të kërkesës agregate. Ndikimin më të qenësishëm në këtë ecuri e ka dhënë zgjerimi i përshpejtuar i importit. Ndërkohë, eksporti i mallrave është rritur me ritme të ulëta. Sipas të dhënave të detajuara të tregtisë së jashtme në

mallra, kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë zgjerimi vjetor i eksportit të kategorisë “Tekstile dhe këpucë” me rreth 24.6 për qind. Në këtë kategori përfshihen mallrat për eksport me material porositësi. Kontribut tjetër të rëndësishëm pozitiv dha edhe kategoria “Ushqim, pije dhe duhan”, eksporti i të cilës ishte rreth 14.1 për qind më i lartë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj kategorie, rritja e përshpejtuar e eksportit të mallrave bujqësore udhëhoqi ecurinë e regjistruar. Në anën tjetër, eksporti i produkteve të kategorisë “Materiale ndërtimi dhe metale” është zvogëluar në nivel vjetor, i ndikuar prej rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare. Kontributin më të madh negativ në ecurinë e eksporteve e dha rënia e përshpejtuar prej 12.3 për qind e eksportit të kategorisë “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike”. Aktiviteti eksportues i vendit vijon të mbështetet kryesisht në partnerë tregtarë si: Italia, Malta, Kosova, Spanja, Greqia dhe Turqia. Në anën tjetër, origjina e produkteve të importuara prej vendit tonë vijon të mbetet më e larmishme, ku vendet e BE-së zënë peshën kryesore ndaj totalit.

Në tremujorin e katërt flukset hyrëse neto të IHD-ve mbetën në të njëjtin nivel si një vit më parë duke financuar 60 për qind të deficitit të llogarisë korente për këtë tremujor. Për vitin 2014 në total flukset hyrëse neto të IHD-ve u ulën me 13.4 për qind në terma vjetorë. Pas një rritje vjetore prej 6.6 për qind, rezervat valutore arritën në 2,1 miliardë Euro në fund të vitit, duke mbuluar 4,6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh. Stoku i borxhit të jashtëm bruto u rrit me 7,9 për qind në terma vjetorë dhe qëndroi në 66 për qind të PBB-së vjetore të planifikuar. Borxhi afatgjatë, kryesisht ai qeveritar, vazhdon të përbëjë më shumë se 80 për qind të borxhit total. Bilanci i përgjithshëm i pagesave, në tremujorin e katërt të vitit 2014, rezultoi me ulje të mjeteve të rezervës me rreth 39 milionë Euro.

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Krahasuar me vendet e rajonit Shqipëria shënoi rritje ekonomike të kënaqshme për vitin 2014, duke lënë pas Malin e Zi, Kosovën, Bosnje dhe Hercegovinën dhe Serbinë, por duke mbetur pas Maqedonisë dhe Turqisë. Gjatë 2014 prodhimi industrial në Bosnje dhe Hercegovinë vazhdoi të tkurret. Gjithashtu edhe Serbia shënoi tkurrje të PBB-së reale si pasojë e kontributit negativ të konsumit privat dhe formimit bruto të kapitalit fiks. Sipas treguesve të disponueshëm, Kosova ka përjetuar stanjacion gjatë 2014 si pasojë e ngërçit politik dhe vonesave në investime publike. Ekonomia e Maqedonisë mbajti një rritje të qendrueshme, me një normë vjetore rritje prej 3.8 për qind, duke përfituar nga projektet e infrastrukturës publike dhe zgjerimi i prodhimit në zonat e lira ekonomike.

Tabela 1: Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto (Rritja vjetore ne %, në terma real)	Parashikim ECFIN					
	2013	2014	2015	2016	Q3 -2014	Q4 - 2014
Maqedonia	2.7	3.8	3.5	3.6	4.3	2.7
Mali i Zi	3.3	1.4	3.0	3.7	1.3	:
Serbia	2.6	-1.8	-0.3	1.2	-3.8	-1.8
Turqia	4.2	2.9	3.7	4.0	1.9	2.6
Shqipëria	1.4	1.9	3.0	3.5	3.9	2.4

Bosnja dhe Hercegovina	2.5	1.4	:	0.5	2.4
Kosova	3.4	:	:	1.4	:

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN);

Kushtet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor mbetën sfiduese me norma të larta papunësie, veçanërisht tek të rinjtë. Siç vihet re edhe nga shifrat, për vitin 2014 Shqipëria regjistroi një normë papunësie prej 17.9 për qind, duke lënë pas pothuajse të gjithë vendet e rajonit përveç Turqisë, e cila regjistroi vlerën më të ulët të normës së papunësisë prej 10.0 për qind. Norma më e lartë u regjistrua në Bosnje dhe Hercegovinë pasuar nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

Tabela 2: Norma e papunësisë

Në përqindje

Norma e Papunësisë (në %)	Parashikim ECFIN				Q3 - 2014	Q4 - 2014
	2013	2014	2015	2016		
Maqedonia	29.0	28.0	27.5	26.4	27.9	27.6
Mali i Zi	19.5	18.0	18.4	16.8	16.4	18.1
Serbia	22.1	18.9	21.4	21.8	17.6	16.8
Turqia	9.1	10.0	10.5	10.5	10.1	10.7
Shqipëria	16.4	17.9	16.6	15.6	17.4	18.0
Bosnja dhe Hercegovina	44.5	43.6	:	:	43.7	43.6
Kosova	30.0	:	:	:	:	:

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN);

Disekuilibrat e jashtëm mbeten sfidë e rëndësishme në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në tremujorin e katërt deficitet e llogarisë korente u thelluan në shumicën e ekonomive të rajonit (Shqipëria, Mali i Zi, Kosova), ndërsa për disa vende të tjera fundvitit solli rritje të eksporteve dhe ulje të deficitit të llogarisë korente (Serbia, Maqedonia dhe Turqia).

Inflacioni i ulët mbeti karakteristikë e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, por dinamika e çmimeve kanë qenë mjaft heterogjene në të gjithë rajonin. Indeksi i Çmimeve të Konsumit mbeti pozitiv në Serbi (2,2 për qind) dhe Shqipëri (1,6 për qind), duke qendruar nën kufirin e poshtëm të intervalit të tolerancës së Bankës Qendrore. Inflacioni i ulët dhe performanca e dobët ekonomike bëri që Bankat Qendrore të dy vendeve të ulnin normën bazë të interesit. Vendet e tjera si Maqedonia, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina vazhduan trendin deflacionist.

Tabela 3: Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (Inflacioni)

Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (Inflacioni) (ndryshimi vjetor në %)	Parashikim ECFIN				Q3 - 2014	Q4 - 2014
	2013	2014	2015	2016		
Maqedonia	2.8	-0.3	1.3	1.7	-0.3	-0.4
Mali i Zi	-2.1	-2.3	0.4	2.0	-2.6	-0.8
Serbia	2.2	1.7	3.2	4.3	2.1	1.7
Turqia	7.5	8.9	6.3	5.8	9.2	8.8
Shqipëria	1.9	1.6	2	2.5	1.7	1.3
Bosnja dhe Hercegovina	-0.1	-0.9	:	:	-0.5	-0.1

Kosova* 1.8 0.4 : 1.0 0.1
 Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN);

Tabela 4: Balanca Korrente

Balanca korrente (në % të PBB)	Parashikim ECFIN					
	2013	2014	2015	2016	Q3 -2014	Q4 -2014
Maqedonia	-1.8	-1.3	-2.4	-2.2	-1.9	-1.3
Mali i Zi	-14.6	-15.3	-15.6	-16.9	-15.9	-15.3
Serbia	-6.1	-6.0	-5.3	-5.4	-6.3	-6.0
Turqia	-7.9	-5.8	-3.6	-4.2	-5.8	-5.8
Shqipëria	-10.7	-12.9	-12.9	-13.5	-12.6	-12.9
Bosnja dhe Hercegovina	-5.7	-7.6	:		-7.6	-7.6
Kosova	-6.4	-8.0	:		-1.7	-2.7

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN);

Sektori financiar në Ballkanin Perëndimor shfaq shenja rigjallërimi gjatë 2014. Kreditimi për korporatat u kthye pozitiv në Shqipëri (për herë të parë që nga marsi 2013). Deri tani, nivelet më të larta të NPL-ve janë regjistruar në Shqipëri dhe në Serbi, në 22,8 për qind dhe 22,5 për qind të totalit të kredive, respektivisht.

Për sa i përket zhvillimeve fiskale në rajon, në shumë vende performanca buxhetore është përmirësuar për shkak të rritjes së të ardhurave (bazuar në rritjen e mëparshme të normave të taksave apo përpjekjeve për mirëadministrim) dhe kufizimit të shpenzimeve (masa për konsolidim fiskal dhe shpenzime të ulëta kapitale, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina). Pavarësisht përpjekjeve për konsolidim fiskal, Shqipëria vazhdon të regjistrojë vlera të larta deficiti dhe borxhi publik krahasuar me vendet e rajonit. Për vitin 2014 Shqipëria regjistroi nivelin më të lartë të borxhit publik pasuar nga Serbia. Ky deficit përfshin edhe 34 miliardë detyrime të prapambetura (pra rreth 2.4 për qind e PBB-së është shlyerja e detyrimeve të prapambetura për vitin 2014). Nëse zhvishet nga detyrimet e prapambetura deficiti është 2.7 për qind i cili është i krahasueshëm me rajonin.

Tabela 5: Bilanci fiskal

Balanca e pergjithshme e qeverise (Deficiti fiskal) (në % të PBB)	Parashikim ECFIN					
	2013	2014	2015	2016	Q3 - 2014	Q4 - 2014
Maqedonia	-3.9	-4.2	-3.5	-3.2	-2	-3.4
Mali i Zi	-5.3	-1.5	-5.7	-4.8	-0.7	-3.0
Serbia	-5.5	-6.7	-4.9	-3.9	-5.4	-6.7
Turqia	-1.6	-2.1	-2	-1.8	:	:
Shqipëria	-4.9	-5.1	-3.9	-3.0	-2.2	-5.1
Bosnja dhe Hercegovina	-2.2	1.8	:		1.6	:
Kosova	-3.1	-2.2	:		0.2	-2.3

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN);

Tabela 6: Borxhi publik

Borxhi publik total (në % të PBB)	Parashikim ECFIN					
	2013	2014	2015	2016	Q3 - 2014	Q4 - 2014
Maqedonia	34.2	38.0	39.1	40.1	:	:
Mali i Zi	58.1	59.6	62.3	65.6	58.0	59.6
Serbia	59.4	71.0	76.9	81.0	67.9	71.0
Turqia	36.3	:	35.3	34.2	:	:
Shqipëria	64.9	71.3f	71.2	69.7	67.8	69.2
Bosnja dhe Hercegovina	42.5	40.5	:		30.4	30.0
Kosova	8.9	10.6	:		10.0	10.6

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN);

*Shënim: Ne shifrën e borxhit ne tabelën 6 nuk janë përfshire 72 miliardë lekë detyrime të prapambetura.

III. POLITIKAT FISKALE DHE EFEKTET NË EKONOMI

3.1 Ndryshimet fiskale në vitin 2014 dhe efektet në ekonomi e buxhet

Ndryshimet fiskale në vitin 2014 dhe efektet në ekonomi e buxhet

Gjatë vitit 2014 u zbatuan një sërë masash fiskale dhe thjeshtim të procedurave të biznesit, të cilat synuan rritjen e bazës së tatueshme dhe adresimin e çështjeve problematike në sektorë të caktuar të ekonomisë, nga pikëpamja fiskale.

Një element i rëndësishëm i politikës së taksave gjatë vitit 2014 ishte adresimi i problematikave kryesore të biznesit në drejtim të procedurave tatimore dhe doganore, të cilat rezultuan në kohë dhe kosto të larta për biznesin, si dhe në mundësi për evazion.

Zbatimi i ndryshimeve të politikës tatimore, të hyra në fuqi nga 1 janar 2014 (paketa fiskale) sollën efekte e dëshiruara tek përmirësimi i klimës së biznesit si dhe ka sjellë efekte pozitive në zhvillimin ekonomik të vendit dhe më konkretisht si më poshtë vijon:

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Sektori shëndetësor:

Nga data 1 prill 2014 filloi zbatimi i përjashtimit nga TVSh-ja të furnizimit të barnave dhe shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private. Efekti financiar negativ në të ardhurat e vitit 2014 u vlerësua minus 1 miliard lekë, efekt ky i cili balancohej me uljen e shpenzimeve buxhetore po për vitin 2014 për ISKSH-në, në masën 900 milionë lekë. Pra

efekti neto i kësaj politike ishte minus 100 milion lekë. Në mbyllje të vitit 2014, rezultoi se efekti negative nga TVSh ishte -1.7 miliardë lekë dhe jo 1 miliard lekë sa parashikimi fillestar. Lidhur me impaktin që kjo masë pati tek qytetari shqiptar, sipas të dhënave të INSTAT, rezultoi se gjatë vitit 2014 u ul indeksi i çmimeve të shërbimeve shëndetësore me -5.6 për qind krahasuar me një vit më parë.

Tabela 7: Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (ndryshimi vjetor)	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shëndeti	2.6	12.8	4.1	1.5	-1.5	-5.6
Medikamentet dhe produkte të tjera farmaceutike	1.7	6.8	4.9	1.6	-2.4	-6.2
Shërbime mjekësore, para-mjekësore dhe dentare	7.4	47.8	0.5	2.1	1.7	0.8
Shërbime spitalore	3.0	14.5	4.0	0.9	-0.2	-8.7

Burimi: INSTAT (2015);

Industrializimi:

Në adresim të nevojave të sektorëve prioritarë për zhvillimin e vendit si fason, sektori mineral, në maj të vitit 2014, Këshilli i Ministrave zgjeroi listën e makinerive dhe pajisjeve të përjashtuara nga TVSh-ja. Kjo masë rriti *cash-in* e biznesit vendas për më shumë investime, megjithëse ndikoi negativisht në të ardhurat e buxhetit të shtetit me rreth 1.5 miliardë lekë të paparashikuar në buxhetin fillestar.

Spektori Hidrokarbur:

Paketa Fiskale e vitit 2014 hoqi çdo përjashtim nga taksat të sektorit hidrokarbur, nga TVSh-ja, nga akciza dhe nga tatimi mbi të ardhurat personale të personelit të huaj. Sektori i hidrokarbureve, për vetë specifikën e tij, pati një kuadër të plotë ligjor e nënligjor në të cilin është e përcaktuar tërësia e veprimtarisë së operatorëve në hidrokarbure, përfshirë dhe trajtimin fiskal. Gjatë vitit 2014, u arkëtuan në doganë rreth 4.3 miliardë lekë TVSh dhe 1.8 miliardë lekë akcizë, duke përfshirë kështu këtë sektor në radhën e gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë subjekt i pagesës së taksave. Vetëm tatimi mbi të ardhurat e personelit të huaj arritën në vlerën rreth 900 milionë lekëve për vitin 2014.

Akcizat

Cigaret:

Në koherencë me politikën e Ministrisë së Shëndetësisë për uljen e nivelit të duhanpirjes në vend, gjatë vitit 2014 u aplikua një normë e lartë e akcizës së cigareve, nga 70 lekë/paketa që ishte më parë në 90 lekë/paketa. Kjo masë arriti efektin e dëshirueshme në uljen e nivelit të duhanpirjes dhe rrjedhimisht me një impakt negativ në të ardhurat nga akciza për administratën doganore.

Efektin pozitiv në të ardhurat e buxhetit të shtetit nga rritja e akcizës për vitin 2014 u parashikua rreth 3.3 miliardë lekë, duke marrë si bazë për llogaritjen e efekteve konsumi vjetor prej 36000 ton cigare. Kjo masë nuk arriti të kishte efektin e dëshirueshëm në të ardhurat buxhetore për dy arsye:

- U rritën importet e cigareve në fund të vitit 2013, si rezultat i kësaj mase;

- U ul konsumi i cigareve në vend si rezultat i kombinimit të kësaj mase me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë për ndalimin e duhanpirjes.

Taksat Nacionale

Nga 1 janar 2014 u rrit taksa e qarkullimit me 10 lekë/litri dhe efekti i pritshëm në buxhet u vlerësua në rreth 5.6 miliardë lekë. Nga kjo rritje e taksës, u parashikua një rritje të çmimit final të shitjes së naftës dhe benzinës, prej rreth 6 për qind.

Paralajmërimi i rritjes së kësaj taksë nga 1 janari 2014, u shoqërua me rritje të importeve të karburanteve gjatë muajve tetor-dhjetor 2013 me 146,130 ton nga 118,471 ton që ishte në tetor-dhjetor 2013. Kjo solli rritjen e rezerva të brendshme të operatorëve ekonomikë, të cilët e hodhën në treg për shitje sasinë e importuar tepër, në muajt e parë të vitit duke sjellë një ulje të importeve reale gjatë tre muajve të parë të vitit 2014. Gjithashtu, megjithëse kjo sasi karburanti e importuar gjatë muajve të fundit të vitit 2013 me pagimin e taksave të ulëta, u shit në muajt e parë në tregun vendas me një çmim të rritur duke rritur me 5.5 për qind rritjen e çmimit final të shitjes me pakicë të naftës dhe benzinës në vend. Gjatë muajve të mëpasshëm u mbaj ky çmim i rritur dhe vetëm në tetor u reflektua një ulje prej 4.4 për qind e çmimit të shitjes me pakicë si rezultat i uljes së çmimeve të karburanteve në bursat ndërkombëtare. Gjithashtu tre muajt e fundit të vitit 2014 u vunë në prodhim edhe rafineritë vendase, duke kontribuar me rreth 60 mijë ton karburante në vend.

Tabela më poshtë, tregon uljen/rritjen reale të çmimit të shitjes me pakicë të naftës dhe benzinës, sipas çdo muaji të vitit 2014. Siç vërehet, në muajin dhjetor 2014, çmimi i benzinës është më i ulët se çmimi i muajit janar 2014.

Tabela 8: Çmimi i shitjes me pakicë të benzinës

Viti	Muaji	Çmimi i shitjes me pakicë, në lekë/litër	Përqindja e ndryshimit në muaj
2013	Tetor	176.9	
	Nëntor	176.9	0.0%
	Dhjetor	176.9	0.0%
2014	Janar	186.9	5.7%
	Shkurt	186.9	0.0%
	Mars	183.9	-1.6%
	Prill	183.9	0.0%
	Maj	183.9	0.0%
	Qershor	183.9	0.0%
	Korrik	183.9	0.0%
	Gusht	183.9	0.0%
	Shtator	183.9	0.0%
	Tetor	175.9	-4.4%

	Nëntor	175.9	0.0%
	Dhjetor	165.9	-5.7%
2015	Janar	164	-1.1%

Burimi: *Ministria e Financave(2015)*;

Taksat vendore

Ndryshime të rëndësishme u propozuan lidhur me këtë grup taksash, në kuadër të zbatimit të objektivave të programit qeverisës.

- U shfuqizua Taksa Vendore e Biznesit të Vogël, taksë lokale që paguhej nga subjektet me xhiro vjetore qarkullimi deri në 8 milionë lekë dhe mblidhej nga administrata tatimore vendore. Efekti negativ në të ardhurat e pushtetit vendor u vlerësua në rreth 2 miliardë lekë.
- Subjektet e biznesit të vogël (me xhiro vjetore nga 2 në 8 milionë lekë) u taksuan me 7.5 për qind mbi “fitimin”. Ky tatim mblidhet nga administrata tatimore qendrore dhe të ardhurat i kalojnë organeve të pushtetit vendor. Efekti i pritshëm ishte 1.2 miliardë lekë, ndërsa faktikisht u mblodhën 1.7 miliardë lekë.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale mbi pagat u reformua, duke zëvendësuar taksimin e sheshtë me një shkallë unike dhe me një prag përjashtimi me taksimin progresiv, sipas skemës së mëposhtme:

0 deri në 30 000	0 për qind
30 001 deri në 123000	13 për qind
Mbi 123000	23 për qind

Reformimi i taksimit mbi pagat synoi rritjen e drejtësisë së sistemit tatimor, duke shtuar barazinë horizontale midis individëve: për të ardhura më të larta detyrimi tatimor në përqindje është më i lartë dhe është në linjë me programin e Qeverisë aktuale.

Efektet financiare në buxhetin e shtetit duke patur parasysh të dhënat e vitit 2013, u parashikuan në rreth minus 1.5 miliardë lekë, ndërkohë që pas mbylljes së vitit buxhetor rezultoi se ky efekt ishte më i madh, rreth 2 miliardë lekë.

Tatimi mbi fitimin

Nga data 1 janar 2014, norma e tatimit mbi fitimin u rrit në 15 për qind nga 10 për qind që ishte. Ky propozim ishte në koherencë me formulën e taksimit progresiv në Shqipëri dhe me logjikën që individi që fiton më shumë paguan më shumë taksa. E njëjta filozofi është edhe me bizneset: bizneset e vogla paguajnë 7.5 për qind tatim mbi të ardhurat e tyre personale, ndërsa bizneset e mëdha paguajnë 15 për qind tatim mbi fitimin e tyre vjetor të tatueshëm.

Masat në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit dhe uljes së kohës dhe kostos së bizneseve

Gjatë vitit 2014 u zbatuan një sërë masash në drejtim të thjeshtimit të procedurave tatimore, disa prej të cilave patën edhe efekt negativ në të ardhurat tatimore.

- U vendos një afat minimal për garancinë bankare të vendosur nga subjekti tatimpagues me qëllim apelimit të vendimit të Drejtorisë së Apelimit.

Me Paketën Fiskale 2014, qeveria i ofroi biznesit një lehtësi, duke vënë edhe garancinë bankare si mjet për të garantuar shlyerjen e detyrimit tatimor, me qëllim ankimin në Drejtorinë e Apelimit të njoftim vlerësimeve. Në këtë mënyrë, tatimpaguesi nuk ishte më i detyruar që të paguante detyrimin tatimor, por mjafton që të vendosë një garanci për shumën e tatimit dhe kamatëvonesën. Ky ndryshim u bë me qëllim lënien e likuiditetit në duart e biznesit edhe në rastet kur apelohej një njoftim vlerësimi i administratës tatimore.

- Në rrjedhën e ndryshimeve të politikave fiskale dhe konkretisht në uljen e tatimit të biznesit të vogël, ka dalë e nevojshme të bëhen disa ndryshime në këtë ligj, të cilat konsistojnë në përcaktimin si agjent tatimor për mbledhjen e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve.
- Për të minimizuar problematikën disavjeçare të vonesave në çregjistrimin e bizneseve, u ndryshua ligji i procedurave tatimore duke kufizuar kontrollin e subjekteve sipas një analize risku. Pra me marrjen e njoftimit jo çdo subjekt do t'i nënshtrohet kontrollit, por vetëm subjektet, të cilat paraqesin risk të lartë evazioni. Ky propozim sjell lehtësimin e procedurave për çregjistrimin e subjekteve.
- U ul vlera e transaksioneve që duhet të kryhen nga tatimpaguesit nëpërmjet sistemit bankar nga 300 000 lekë që është aktualisht në 150 000 lekë. Ky ndryshim u bë si nevojë për ngushtimin e hapësirës ligjore për qarkullimin me para në dorë dhe qarkullimin kasë-bankë;
- U zgjat afati i kontrollit dhe aprovimit të tepricës kreditore nga organet tatimore, nga 30 ditë që ishte në 60 ditë. Ky ndryshim i dha më shumë kohë administratës tatimore për kryerjen e kontrollit të kërkesave të tatimpaguesve për tepricën kreditore;
- Tatimpaguesve, të cilët ankimojnë vendimet apo vlerësimet e administratës tatimore që ndikojnë detyrimet tatimore, iu la si opsion mundësia për vendosjes e garancisë bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor pa përfshirë gjokat. Më parë, tatimpaguesit për të apeluar këto vendimi duhej patjetër të paguanin detyrimin tatimor pa përfshirë gjokat, duke sjellë kështu edhe vonesa në rimarrjen e tyre nga organi tatimor në rast të rrëzimit të vendimit nga Drejtoria e Apelimit;
- Për herë të parë i lind detyrimi Drejtorisë së Apelimit për publikimin e qëndrimeve të mbajtura nga kjo Drejtori gjatë ushtrimit të funksioneve të saj. Ky ndryshim është propozuar për të unifikuar qëndrimet që mban kjo Drejtori ndaj tatimpaguesve të ndryshëm për çështje me natyrë të ngjashme;
- U hoqën penalitetet për tatimpaguesit, të cilët ndryshonin deklaratën fillestare, duke i dhënë kështu subjekteve një incentivë për rregullimin e deklarimeve. Më parë, tatimpaguesi detyrohej të paguante një gjobë, të barabartë me 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit, gjatë të cilit pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, shuma nuk mund të jetë më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar:
 - ✓ Për efekte fiskale u njohën provigjionet e sistemit bankar me synim uljen e nivelit të borxheve të këqija;

- ✓ U bë falja e gjobave administrative tatimore. Gjatë vitit 2014 u miratua dhe zbatua ligji për faljen e gjobave administrative të vëna nga administrata tatimore për periudhën mars-gusht 2013. Kjo masë hoqi një barrë të rëndësishme të borxhit të bizneseve ndaj administratës tatimore dhe që pati një impakt negativ në të ardhurat tatimore me rreth 2,9 miliardë lekë.


Të gjitha masat e mësipërme ndikuan në përmirësimin e klimës së bizneseve në vend dhe në disa raste edhe me efekte negative në të ardhurat tatimore dhe doganore.

3.2. Treguesit Fiskal për periudhën janar-dhjetor 2014

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore arritën në 366.7 miliardë lekë, -0.3 për qind më pak se parashikimi për 12-mujorin e vitit 2014 dhe 12.1 për qind më shumë se një vit më parë.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat ishin në nivelin 253.4 miliardë lekë ose rreth -2.7 për qind më pak nga rreth 260.5 miliardë lekë të planifikuara për periudhën dhe 10.7 për qind më shumë krahasuar me një vit më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 12.4 miliardë lekë nga 12.8 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë (-2.6 për qind më pak) dhe me rritje vjetore prej 15 për qind më shumë; të ardhurat nga fondet speciale arritën 70 miliardë lekë, me realizim prej 110.1 për qind dhe me rritje vjetore 16.5 për qind ose 9.9 miliardë lekë; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën rreth 10.1 miliardë lekë nga rreth 5.7 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë rreth 20.7 miliardë lekë nga 21.6 miliardë të një viti më parë, me rënie vjetore - 4.1 për qind.


Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 150.7 miliardë lekë, -3.5 për qind më pak se parashikimi për vitin 2014. Administrata tatimore ka mbledhur rreth 102.8 miliardë lekë të ardhura tatimore dhe 60.9 miliardë lekë të ardhura nga kontributet. Krahasuar me planin, administrata tatimore ka një mosrealizim prej -0.7 për qind në total.



Burimi: Ministria e Financave (2015);


Analiza e të ardhurave për periudhën janar-dhjetor 2014

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore arritën në 366.7 miliardë lekë, -0.3 për qind më pak se parashikimi për 12-mujorin e vitit 2014 dhe 12.1 për qind më shumë se një vit më parë.





Burimi: Ministria e Financave (2015);

Të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 10.1 miliardë lekë nga rreth 5.7 miliardë lekë të një viti më parë.





Burimi: Ministria e Financave (2015);

Të ardhurat tatimore për periudhën 12-mujore arritën në 335.9 miliardë lekë, -0.3 për qind më pak se parashikimi për vitin 2014 sipas buxhetit vjetor të ndryshuar dhe 12 për qind më shumë se një vit më parë.





Burimi: *Ministria e Financave (2015);*

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat arritën në nivelin 253.4 miliardë lekë ose rreth 7 miliardë lekë më pak se parashikimi për periudhën dhe 10.7 për qind më shumë krahasuar me 12- mujin e një viti më parë ose 24.5 miliardë lekë në vlerë absolute:





Burimi: *Ministria e Financave (2015);*

Të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 12.4 miliardë lekë, -2.6 për qind më pak se të ardhurat e planifikuara për këtë periudhë dhe me rritje vjetore prej 15 për qind ose 1.6 miliardë lekë më shumë:





Burimi: Ministria e Financave (2015);

Të ardhurat nga fondet speciale arritën 70 miliardë lekë me rritje vjetore 16.5 për qind ose 9.9 miliardë lekë:



Burimi: Ministria e Financave (2015);


Të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 20.7 miliardë lekë nga 21.6 miliardë të një viti më parë, me rënie vjetore -4.1 për qind dhe realizim të planit prej 91.4 për qind.




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 150.7 miliardë lekë, -3.5 për qind më pak se parashikimi për 2014, dhe rreth 11 miliardë lekë më shumë se një vit më parë, me rritje pothuajse 8 për qind. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, zërat me rritje janë TVSh, Taksa doganore dhe Akciza me rritje vjetore respektivisht 10.7 për qind, 0.9 për qind dhe 8.1 për qind. Me rënie paraqiten për këtë periudhë të ardhurat nga renta ku për 12-mujorin 2014 janë mbledhur vetëm 6.6 miliardë nga 8.1 miliardë të mbledhur një vit më parë. Rënia vjetore prej gati -19 për qind (rreth -18 për qind krahasur me planin e periudhës) ka ardhur kryesisht nga rënia e çmimit të naftës në eksport.

Të Ardhurat në Dogana në Vite




Të ardhurat në Dogana sipas Taksave




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Administrata tatimore ka mbledhur (përfshirë kontributet) 163.7 miliardë lekë, që do të thotë 13.3 për qind më shumë të ardhura se 12-mujori i vitit 2013 ose 19.2 miliardë lekë më shumë (përfshirë dhe kontributet). Totali i të ardhurave tatimore (pa përfshirë kontributet) ishte për periudhën rreth 102.8 miliardë lekë, duke patur një rritje prej 15.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe një realizim të planit në masën 98.6 për qind, ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 10.3 për qind mbi baza vjetore. Ecuri pozitive ka Tatimi mbi fitimin, mbledhja e të cilit për këtë periudhë krahasuar me një vit më parë, pësoi rritje në masën 42.1 për qind, ndërsa TVSh ka pasur një rritje prej 10.5 për qind mbi baza vjetore; Taksat nacionale kanë pësuar rritje prej 27.9 për qind krahasuar me një vit më parë. Rënie për periudhën 12-mujore ka pësuar Tatimi mbi të Ardhurat Personale me -2.4 për qind, për arsye se zbatimi i taksës së sheshtë pati një efekt më të madh se parashikimi.

Të Ardhurat në Tatime në Vite




Të ardhurat në Tatimeve sipas Taksave



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Nga të dhënat për 12-mujorin 2014, lidhur me kontributin e sektorëve të ekonomisë në totalin e të ardhurave tatimore (i referohemi këtu totalit të mbledhur nga DPT) rezulton rritje e të ardhurave të mbledhura nga: “Tregtia”, “Shërbimet”, “Transporti” dhe “Ndërtimi” përkatësisht me 42.6, 14, 80.5, 20.5 për qind më shumë se një vit më parë ; ndërsa sektori i Prodhimit ka pësuar rënie me 40.2 për qind.

Të ardhurat Tatimore sipas Sektoreve të Ekonomisë



Burimi: Ministria e Financave (2015);

3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera


Taksimi i konsumit (indirekt) dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar janë mbledhur gjithsej për 12-mujorin, 123.8 miliardë lekë ose 10.6 për qind më shumë se një vit më parë.

Të ardhurat e mbledhura nga TVSh në import ishin në nivelin e 97.4 miliardë lekë. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSh-ja në doganë përbëjnë rreth 78.6 për qind të të ardhurave gjithsej nga TVSh-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 9.4 miliardë lekë më shumë ose 10.7 për qind. Të ardhurat e mbledhura mbi furnizimet e brendshme janë 26.5 miliardë lekë TVSh për periudhën, me rritje vjetore të ndjeshme në nivelin 10.5 për qind. Rimbursimi i TVSh-së për periudhën 12-mujore nga tatimet dhe doganat ka arritur 9.8 miliardë lekë me një rritje vjetore prej 31.4 për qind.

Të dhënat 12-mujore mbi shpërndarjen sektoriale të TVSh-së tregojnë se “Tregtia”, “Shërbimet”, “Transporti” dhe “Ndërtimi” kanë peshën sipas rëndësisë në totalin e TVSh-së së mbledhur brenda vendit, me rreth 164.5 për qind, 33.533 dhe 25.4 për qind të totalit të mbledhur (si pasojë e kalimit si subjekte me TVSh-së të 2,234 subjekte me xhiro mbi 8 milionë lekë).

TVSH-ja sipas Sektoreve të Ekonomisë



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Akcizat

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën janar–dhjetor arritën në rreth 40.9 miliardë lekë; 8.1 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013; të ardhurat nga kjo taksë ishin ndjeshëm nën nivelin e pritshëm, me rreth -8.2 për qind më pak.



Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qenë si vijon:

- Sasia e karburanteve të zhdoganuara për periudhën janar – dhjetor 2014 është 481,776 ton, me rritje vjetore 4.8 për qind.
- Sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën janar – dhjetor 2014 është 2,976 ton, me rënie vjetore prej 19.4 për qind.
- Sasia e birrës së zhdoguar për periudhën janar – dhjetor 2014 është 26,102 mijë litra, me një rënie vjetore prej -6.7 për qind. Ky trend negativ ka filluar që në vitin 2010. Arsyeja kryesore e këtij trendi lidhet me rritjen e prodhimit vendas dhe dominimin e tij në tregun vendas.
- Kafeja e zhdoguar për periudhën janar-dhjetor ka qenë 3.7 për qind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë duke arritur në 7,413 ton.

Tabela 9: Të ardhurat nga Akcizat

Mallrat e	Njësia e	Janar -Dhjetor		Diferenca 13-12	
		2013	2014	Në njësi fizike	në përqind
Forta	matjes				
Cigare	Ton	3,694	2,976	-718	-19,4
Kafe	Ton	7,148	7,413	264	3,7
Birrë	Mijë litra	27,962	26,102	-1,86	-6,7
Karburante	Ton	459,832	481,776	21,947	4,8

Burimi: Ministria Financave (2015);





Burimi: Ministria e Financave (2015);

Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 28.9 miliardë lekë për periudhën janar-dhjetor ose -2.3 për qind me pak se një vit më parë dhe me realizim të planit për vitin 2014 në masën 102.3 për qind. Sipas burimit të të ardhurave individuale që taksohen, bazuar në të dhënat për 12-mujorin 2014, situata pasqyrohet në grafikun më poshtë:



Burimi: Ministria e Financave (2015);


Negative është ecuria e tatimit mbi pagat në sektorin shtetëror, e cila ka pësuar një rënie prej 29.4 për qind në krahasim me një vit më parë, për arsye të uljen e tatimit mbi pagën si rezultat i zbatimit të taksës së sheshtë, që ndikoi dukshëm në uljen në 10% të tatimit të pagave nën 130 mijë lekë/muaji.

Positive është ecuria e tatimit mbi pagat në sektorin privat, e cila ka pësuar një rritje prej 11.7 për qind në krahasim me një vit më parë pavarësisht se numri i subjekteve tatimpaguese ka rënë me -12,073 njësi, të cilin e kryeson sektori i Shërbimeve me -4,884 njësi, Tregtisë me -4,095 njësi, sektori prodhues me -1,807 njësi ndjekur nga Ndërtimi dhe Transporti. Të ardhurat nga interesat mbi depozitat dhe investimi në obligacione kanë pësuar një rënie prej -22.1 për qind kryesisht nga interesat e depozitave bankare, të cilat zënë rreth 88.5 për qind të totalit, ndërsa të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit zënë vetëm 11.5 për qind të totalit.


Të ardhurat nga dividendët kanë pësuar një rritje prej 25 për qind në krahasim me një vit më parë. Tatimi mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme (nga individët) kanë pësuar një rritje prej 183 për qind në krahasim me një vit më parë. Kjo rritje është ngushtësisht e lidhur me efektin e ligjit të faljes së gjobave administrative për periudhën mars-gusht 2013, i cili parashikoi rivlerësimin e pasurisë. Për këtë arsye, gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013 të ardhurat nga kjo taksë kanë qenë në shifra modeste.

Tatim Fitimi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 12-mujorin 2014 arritën në rreth 21.5 miliardë lekë nga 15.1 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të ndjeshme prej 42.1 për qind si pasojë e rritjes së normës së taksës së Tatim Fitimit me 50 për qind.



Tatimi mbi Fitimin sipas sektorëve



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Duke iu referuar të dhënave mbi tatim fitimin sipas sektorëve të ekonomisë për 12-mujorin, në rritjen e tatim fitimit në vlerë nominale ka ndikuar rritja prej 48.3 për qind e derdhjes së tatim fitimit nga sektori privat, ndërsa ndërmarrjet shtetërore (kryesisht OSSHE dhe KESH) kanë pësuar rënie me -6.6 për qind krahasuar me një vit më parë duke zbutur dhe rritjen e tatim fitimit me 42.1 për qind në total për këtë periudhë 12-mujore. Duke marrë parasysh rritjen e normës së tatim fitimit nga 10 për qind në 15 për qind përsa i përket tatim fitimit real, në total ka pësuar rënie me 7.9 pikë përqindje nga viti i kaluar dhe ky efekt negativ lidhet me mospagesën e tatimit fitimit nga OSSHE dhe KESH.

Sektorët me rritje nominale janë sektori i *Ndërtimit* me 79.8 për qind si pasojë dhe e mbledhjes së tatim ditimit për apartamentet e pashitura, sektori i *Transportit* me 57.7 për qind si pasojë e zgjerimit të bazës së taksueshme me 55 njësi ose 11.8 për qind me shumë dhe sektori *Tregtisë* me 60.7 përqind si pasojë e shtimit të operatorëve në treg me 524 njësi ose 10.5 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Kanë pësuar rritje dhe sektori i prodhimit me 22.2 për qind dhe sektori i shërbimeve me 32.2 për qind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat dhe mbi tokën bujqësore. Për 12-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 3.7 miliardë lekë nga 4 miliardë lekë të parashikuara dhe 49.9 për qind më të larta se një vit më parë.

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën janar – dhjetor 2014, me mosrealizim të planit në masën -4.5 për qind. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash kanë pësuar një rritje prej 14.6 për qind. Kjo rënie është e lidhur me të ardhurat nga renta minerale në eksport, e cila gjatë tremujorit të fundit të vitit pësoi një rënie të dukshme si rezultat i uljes së çmimeve të naftës bruto në bursat ndërkombëtare.

Këtu theksojmë ecurinë pozitive të taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, rentës minerare dhe me rënien e taksës së karbonit të mbledhura nga administrata tatimore të detajuara si më poshtë (referuar të dhënave për 12-mujorin):

- Nga taksa e qarkullimit mbi karburantet janë mbledhur rreth 11 miliardë lekë për periudhën 12-mujore 2014;
- Nga renta minerare janë mbledhur nga administrata tatimore rreth 1.8 miliardë lekë nga 0.82 miliardë lekë të mbledhura një vit më parë;
- Nga taksa e karbonit janë mbledhur nga administrata tatimore rreth 2.38 miliardë lekë.

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar – dhjetor janë rreth 5.9 miliardë lekë; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013 të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 55 milionë lekë ose 0.9 për qind.



Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar – dhjetor 2014, arritën 12.4 miliardë lekë nga 12.8 miliardë lekë të planifikuara, ndërsa kundrejt vitit 2013 të ardhurat janë rritur me rreth 15 për qind. Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë të cilat përmenden më sipër) kanë mbledhur rreth 7 miliardë lekë nga 7.2 miliardë lekë të parashikuara.

Të ardhurat e fondeve speciale



Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën janar – dhjetor 2014 arritën në 70 miliardë lekë, me një rritje prej 10.1 për qind kundrejt planit dhe 16.5 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20.8 për qind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, rreth 69.7 miliardë lekë janë kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe 316 milionë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 61.5 miliardë lekë dhe nga Sigurimet Shëndetësore janë mbledhur 8.2 miliardë lekë.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 12-mujore rezulton se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 7.56 për qind ose rreth 33,179 njësi kundrejt mesatares 12-mujore të 2013; sektori i “Tregtisë” dhe “Shërbimeve” patën rritje përkatësisht me 17.7 për qind dhe 6.5 për qind, “Ndërtimi” 5.8 për qind dhe prodhimi me 4.7 për qind. Ndërsa sektori i “Transportit” ka pësuar rënie me -12.3 për qind më pak se mesatarja e së njëjtës periudhë një vit më parë.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

IV. POLITIKAT E SHPENZIMEVE BUXHETORE

4.1 Analiza e shpenzimeve buxhetore

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit

Zbatimi i buxhetit të shtetit në kohë sipas programeve dhe parashikimeve buxhetore, kontribuon dhe nxit ekonominë nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve publike. Në këtë kuadër, realizimi efektiv dhe në kohë i shpenzimeve buxhetore, sipas planit të dakordësuar edhe me

Fondin Monetar Ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet një prioritet i qeverisë. Në këtë kontekst, në fillim të vitit 2014 është punuar intensivisht për shpërndarjen e fondeve në një kohë sa më të shpejtë. Çelja e buxhetit në ditët e para të muajit janar 2014, ka ndikuar pozitivisht në kryerjen e shpenzimeve dhe për rrjedhojë në rritjen e kërkesës së brendshme në treg dhe stimulimit të ekonomisë në përgjithësi.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit, përfshirë shpenzimet e pushtetit vendor dhe fondet speciale për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, për vitin 2014 arritën në 438.8 miliardë lekë, nga 456.4 miliardë lekë të parashikuara, me një nivel realizimi të planit prej 96.2 për qind ose 17.5 miliardë lekë më pak se parashikimi vjetor. Shpenzimet e vitit 2014 krahasuar me ato të 2013, janë 44.7 miliardë lekë më shumë ose 11.3 për qind më të larta. Në rritjen e këtyre shpenzimeve për 44.7 miliardë lekë, peshën kryesore e zënë 33.9 miliardë lekë fonde të shpenzuara faktikisht nga qeveria aktuale për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të mbartura në vite nga qeveria e mëparshme. Procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, vazhdon të mbetet një prioritet i qeverisë në kuadrin e rivendosjes së financave publike në trajektoren e qëndrueshmërisë afatgjatë. Ky proces ndihmon në çlirimin e potencialit të rritjes ekonomike, të ngurtësuar tashmë prej disa vitesh dhe së bashku me politikën për përmirësimin e cilësisë së shpenzimeve në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe shërbimit ndaj qytetarit janë dhe do të vazhdojnë të jenë orientuesit e politikës ekonomike të qeverisë në periudhën afatmesme.

Në analizën e shpenzimeve për vitin 2014 janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i buxhetit, nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, si dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura.


- Fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i planifikuar për vitin 2014, në shumën 1.5 miliardë lekë, deri në fund të muajit dhjetor është realizuar (ekzekutuar) 1 492 416 mijë lekë, nga të cilat 100 milionë lekë për shpenzime personeli, 779 416 mijë lekë për shpenzime të tjera korrente dhe 613 milion lekë për investime. Pra nga fondi rezerve nuk janë shpenzuar rreth 7,584 mijë lekë.
- Fondi i kontigjencës për vitin 2014, ka qenë 4,750 milionë lekë. Ky fond është akorduar me Vendime të Këshillit të Ministrave në masën rreth 3,696 milionë lekë. Deri në fund të vitit 2014, ky fond është përdorur në masën 4,688,030 mijë lekë nga të cilat, rreth 4,256,343 mijë lekë për shpenzime korrente dhe 431,687 mijë lekë për investime. Kanë mbetur pa u përdorur 61,970 mijë lekë.
- Detyrimet e prapambetura sipas planifikimit në ligjin e buxhetit vjetor, janë çelur 35 miliardë lekë dhe janë paguar deri në fund të vitit 2014 rreth 33.9 miliardë lekë. Nga këto, rreth 12 miliardë lekë janë shpenzime korrente, 13 miliardë lekë janë rimbursim TVSh-je dhe 10 miliardë lekë shpenzime kapitale, për investime publike të kryera por të papaguara.

Gjatë vitit 2014, buxheti i shtetit u ndryshua me dy Akte normative. Më specifikisht, nëpërmjet Aktit normativ nr.1, datë 17.09.2014, u synua:


- Zgjidhja e çështjes së financimit të pagesave për Personat me Aftësi të Kufizuar, të akumuluar ndër vite me rreth 4.3 miliardë lekë,
- Rritja e nivelit të realizimit të projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm në masën 8.7 miliardë lekë,
- Ulja e nivelit të deficitit buxhetor nga 6.6 për qind e PBB, në 6.3 për qind të PBB.

Ndërsa me Aktin normativ nr.2, datë 29.12.2014, u bë e mundur:

- Lehtësimi i nivelit të realizimit të projekteve të investimeve publike në vitet e ardhshme, duke siguruar një fond të konsiderueshëm për shpronësimet publike, në masën 1.5 miliardë lekë,
- Mbështetja e sektorit të energjisë elektrike, nëpërmjet shlyerjes së detyrimeve kontraktuale ndaj sektorit privat, në masën 1.5 miliardë lekë, dhe
- Rritja e nivelit të realizimit të investimeve publike.



Burimi: Ministria e Financave (2015);



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Më poshtë paraqesim buxhetin e vitit 2014, si dhe ndarjen sipas natyrës së shpenzimeve. Sikurse është cituar më sipër, buxheti faktik i vitit 2014 është 438.8 miliardë lekë, ku shpenzimet korente prej 341.1 miliardë lekësh zënë 78 për qind të totalit të shpenzimeve, shpenzimet kapitale prej 60.6 miliardë lekësh zënë rreth 14 për qind dhe fondi për shlyerjen e detyrimeve të

prapambetura prej 33.9 miliardë lekësh, zë rreth 8 për qind të totalit të shpenzimeve faktike të vitit 2014.

Në mënyrë të detajuar, tabela në vijim paraqet treguesit fiskalë të konsoliduar, (në milionë lekë) për periudhën janar-dhjetor 2014, të krahasuar me të dhënat faktike të vitit 2013:


Tabela 10: Treguesit fiskal të konsoliduar

Të dhënat në milion Lekë

Nr.	E M Ë R T I M I	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca		Diferenca	
		2013	2014	2014	Fakt / Plan 2014	% kundrejt Plan 2014	Fakt 2014 /2013	% kundrejt Fakt 2013
	TOTALI TË ARDHURAVE	327.178	367.949	366.721	-1.228	99,7%	39.543	12,1%
	TOTALI I SHPENZIMEVE	394.118	456.404	438.849	-17.555	96,2%	44.731	11,3%
I.	Shpenzime Korrente	328.641	349.350	341.012	-8.338	97,6%	12.371	3,8%
I.1	Personeli	70.716	73.205	71.373	-1.832	97,5%	657	0,9%
I.2	Interesat	43.335	40.100	40.075	-25	99,9%	-3.260	-7,5%
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	32.424	36.486	33.124	-3.362	90,8%	700	2,2%
I.4	Subvencionet	1.574	1.600	1.599	-1	99,9%	25	1,6%
I.5	Shpenzime për fonde speciale	127.644	135.860	136.336	476	100,4%	8.692	6,8%
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	29.787	37.199	32.985	-4.214	88,7%	3.198	10,7%
I.7	Shpenzime të tjera sociale	23.161	24.900	25.520	620	102,5%	2.359	10,2%
II.	Fondi Rezervë, Kontigjenca	0	3.050	0	-3.050	0,0%	0	
III.	Shpenzime Kapitale	65.477	66.004	60.749	-5.255	92,0%	-4.728	-7,2%
IV.	Detyrimet e prapambetura	0	35.000	33.919	-1.081	96,9%	33.919	
V.	Transferta të tjera	0	1.500	1.669	169	111,3%	1.669	
VI.	Fond shpronësimi	0	1.500	1.500	0	100,0%	1.500	
	DEFIÇITI BUXHETOR	-66.940	-88.455	-72.128	16.327	81,5%	-5.188	7,75%
	Financim i Brendshëm	56.129	50.644	42.237	-8.422	83,4%	-	-24,8%
	Financim i Huaj	10.811	37.811	29.891	-7.899	79,1%	19.080	176,5%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në këndvështrimin e ecursisë së shpenzimeve buxhetore të përgjithshme, grafiku i mëposhtëm paraqet performancën në dhjetë vitet e fundit, në shumë absolute dhe ritmin e rritjes në përqindje. Në terma vjetore, shpenzimet e përgjithshme të vitit 2014, janë rritur me 11.3 për qind në krahasim me vitin paraardhës.



Burimi: Ministria e Financave (2015);


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2014, kanë financuar 125 programe buxhetore dhe kanë synuar realizimin e 817 produkteve të 16 ministrive, 39 institucioneve qendrore dhe fondeve speciale për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e 65 bashkive, 308 komunave dhe 12 qarqeve. Ministrinë dhe institucionet buxhetore, që përfaqësojnë buxhetin qendror kanë shpenzuar 404.2 miliardë lekë ose 92.4 për qind të totalit të shpenzimeve, ndërsa njësitë e qeverisjes vendore kanë shpenzuar 33 miliardë lekë ose 7.6 për qind të totalit të shpenzimeve të përgjithshme të vitit 2014. Në përgjithësi evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministrinë e linjës, me pak përjashtime për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit Evropian. Tabela në vijim paraqet performancën e produkteve buxhetore të planifikuara nga ministrinë, sipas nivelit të realizimit plotësisht, pjesërisht dhe plotësisht e porealizuar.

Tabela 11: Performanca e produkteve buxhetore të planifikuara nga ministrinë

Emri i Ministrisë	Numri i Produkteve buxhetore			
	Plan	Realizuar		Pa realizuar
		plotësisht	pjesërisht	
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	73	31	34	8
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	39	29	7	3
Ministria e Kulturës	15	9	4	2
Ministria e Arsimit dhe Sportit	72	45	19	8
Ministria e Shëndetësisë	28	24	3	1
Ministria e Mjedisit	70	58	7	4
Ministria e Mbrojtjes	34	31	3	0
Ministria e Zhvillimit Urban dhe	44	35	9	0
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	56	51	4	1
Ministria e Financave	50	34	6	10
Ministria e Bujqësisë, Zhvill. Rural dhe Admin. të	82	80	0	2
Ministria e Integritimit Evronian	29	11	16	2
Ministria e Drejtësisë	52	38	8	6
Ministria e Punëve të Brendshme	110	101	6	3
Ministria e Punëve të Jashtme	32	29	3	-
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	35	35	-	-
Totali	821	641	129	51

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Nga 821 produkte të parashikuara për vitin 2014, janë realizuar plotësisht 641 produkte ose 78 për qind, realizuar pjesërisht 129 produkte ose 16 për qind dhe nuk janë realizuar 51 produkte ose 6 për qind e planit të vitit 2014. Përqindjet e realizimit të produkteve buxhetore të planifikuara nga ministrinë e linjës paraqiten në grafikun e mëposhtëm:




Nivelin më të lartë të realizimit të produkteve e kanë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise, si dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Për ministrinë me performancën më të ulët, arsyet e mosrealizimit të plotë, apo në kohë të produkteve lidhen kryesisht me mosrealizimin e investimeve të parashikuara për këto produkte për shkak të mosrealizimit në kohë të procedurave të prokurimit dhe një arsye tjetër lidhet me rialokimin e fondeve në projekte të tjera dhe moskorigjimi i planit të produkteve që vijnë si pasojë e këtij ndryshimi.

Shpenzimet korrente


Në këtë zë të shpenzimeve përfshihen shpenzimet e personelit të administratës publike, shpenzimet për pagesën e interesave mbi borxhin publik, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, subvencionet, shpenzimet për fondet speciale të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, shpenzimet për buxhetin vendor dhe shpenzimet e tjera të përkrahjes sociale, si: ndihma ekonomike, pagesa e papunësisë, kompensimi i ish-të përndjekurve politikë, etj. Këtu përfshihen edhe përdorimet e fondit rezervë, fondit të kontingjencës, si dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura, që shkojnë për shpenzime personeli dhe operative të tjera.

Në fund të muajit dhjetor 2014, shpenzimet korrente u realizuan në 341 miliardë lekë, nga 349.4 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e vitit 2014. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në masën 97.6 për qind, duke u shoqëruar kështu me një mosrealizim prej 8.3 miliardë lekë.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë 12.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 3.8 për qind më shumë. Sikurse evidentohet nga grafiku, shpenzimet për pensionet dhe kujdesin shëndetësor përbëjnë rreth 40 për qind të totalit të shpenzimeve korrente, me rreth 136.3 miliardë lekë.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Ndërkohë, zëri i dytë më i madh i shpenzimeve korente përbëhet nga shpenzimet për personelin e administratës publike, e kështu me radhë deri tek shpenzimet për mbrojtjen sociale, pra ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara.


Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit, përfaqësojnë rreth 20.9 për qind të totalit të shpenzimeve korrente dhe rreth 16.3 për qind të totalit të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, të realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2014. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime janë realizuar në masën 97.5 për qind, pra 71.3 miliardë lekë nga 73.2 të planifikuara në buxhetin fillestar të vitit 2014, duke paraqitur një mosrealizim (ose kursim) prej 1.8 miliardë lekë ose 2.5 për qind më pak se plani vjetor. Në mosrealizimin e këtyre shpenzimeve ka ndikuar:

- Mosplotësimi i vendeve vakante në Ministrinë dhe institucione të ndryshme. Mosplotësimi i vendeve vakante ka ardhur për arsye të efekteve në kohë që ka pasur periudha tranzitore e shfuqizimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe miratimit e hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.
- Ndryshimi i skemës së shpërblimeve të fundvitit u shoqërua me mospërdorimin e plotë të fondit të veçantë të parashikuar për këtë qëllim. Megjithatë një pjesë e fondit të veçantë është përdorur sipas një politike të re të motivimit të punonjësve mbi bazën e performancës. Mbi këtë bazë janë dhënë shpërblime për disa punonjës të administratës publike që me rezultatet e tyre kanë përmirësuar ndjeshëm shërbimet ndaj publikut, në sektorët më të rëndësishëm si: Arsimi, Shëndetësia, Rendi publik, etj. Gjithashtu nëpërmjet këtij fondi kanë përfituar shpërblime edhe pensionistët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Në krahasim me vitin 2013, shpenzimet e personelit rezultojnë 657 milionë lekë më të larta ose 0.9 për qind më shumë. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e këtyre shpenzimeve, evidentohen ndryshimet në strukturat e ministrive, rritja e pagave për punonjësit e policisë, rritja


e pagës minimale në shkallë vendi dhe pagesat e punonjësve në listë pritjeje si pasojë e ristrukturimit. Këto janë elementët kryesorë të cilët kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve të personelit për 2014.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 11.7 për qind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2014 ose 40.1 miliardë lekë, paraqesin një nivel realizimi prej 99.9 për qind të planit vjetor. Në krahasim me vitin e kaluar këto shpenzime rezultojnë rreth 3.3 miliardë lekë më të ulëta ose 7.5 për qind më pak. Ndër arsyet kryesore që kanë ndikuar në uljen e shpenzimeve për interesa në vitin 2014, përmendim uljen e normave të interesit në tregun e brendshëm, e asociuar me uljen e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë, si dhe me nivelin e lartë të likuiditetit në sistemin bankar. Ndërkohë, për sa i përket borxhit të jashtëm interesat e tij në shumë absolute vlerësohen me 796 milionë lekë rritje si rezultat i shtimit të disbursimeve dhe stokut të borxhit të jashtëm.




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Në shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, përfshihen të gjitha shpenzimet e tjera korrente të institucioneve publike, që nuk janë paga për personelin, por të domosdoshme për funksionimin e institucionit dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarin.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes arritën në rreth 33.1 miliardë lekë nga 36.5 miliardë lekë të parashikuara në buxhetin fillestar, duke shfaqur kështu një nivel realizimi vjetor prej 91 për qind. Pra këto shpenzime rezultojnë në rreth 3.4 miliardë lekë më të ulta se plani vjetor dhe 700 milionë lekë (ose 2.2 përqind) më pak se realizimi i tyre në vitin 2013. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2014 janë orientuar në sektorë prioritarë të infrastrukturës dhe ekonomisë. Rreth 13 miliardë lekë ose 40 për qind e totalit të këtyre shpenzimeve janë shpenzuar në infrastrukturën rrugore dhe shërbimet publike. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale nga 1.2 miliardë lekë në vitin 2013, në buxhetin e vitit 2014 janë realizuar në masën 2.3 miliardë lekë, pra gati dy herë më shumë se në vitin 2013. Gjithashtu në këtë zë përfshihen edhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndaj individëve dhe biznesit të akumuluar prej vitesh nga qeveria e mëparshme. Gjatë vitit 2014, janë shlyer detyrime të ndryshme ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe detyrime gjyqësore ndaj individëve dhe kompanive të ndryshëm të biznesit, në vlerën totale prej 12 miliardë lekësh shpenzime korrente.




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet për subvencione në fund të muajit dhjetor 2014, arritën në 1.599 milionë lekë, duke u paraqitur kështu në nivelin e parashikimit, me një nivel realizimi prej 99.9 për qind në terma vjetorë. Në krahasim me vitin e kaluar, këto shpenzime rezultojnë 25 milionë lekë më të larta ose 1.6 për qind më shumë. Politikat për shpenzime për subvencione kryesisht në shërbimin hekurudhor dhe atë të ujësjellësve janë të njëjta prej disa vitesh dhe për rrjedhojë edhe niveli realizimit të tyre është i njëjtë nga viti në vit. Këta sektorë duhet doemos të reformohen dhe të ristrukturohen me qëllim që subvencionet të vijnë në ulje dhe në invers të saj të rritet performanca e tyre. Me ndarjen e re territoriale, ndërmarrjet e ujësjellësve kanë mundësi të


rajonalizohen dhe të orientohen drejt ekonomisë së shkallës duke ulur shpenzimet fikse administrative në maksimum. Gjithashtu këto ndërmarrje duhet të orientohen drejt komercializmit duke eliminuar subvencionet e diferencave midis kostove dhe tarifave të shitjes së ujit.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet për fonde speciale përfshijnë shpenzimet e buxhetit për fondet speciale, të krijuara me ligj që administrojnë skemën e sigurimit shoqëror, shëndetësor, dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, shpenzimet faktike për fondet speciale (në të cilin përfshihet edhe kompensimi i pronarëve për 1.3 miliardë lekë) arritën në 136.3 miliardë lekë nga 135.9 miliardë lekë të parashikuara në buxhetin fillestar, me një tejkalim të planit prej 421 milionë lekë ose rreth 0.4 për qind më shumë. Në krahasim me vitin e kaluar këto shpenzime rezultojnë 9.3 miliardë lekë më të larta ose rreth 6.8 për qind më shumë. Kjo rritje e shpenzimeve i atribuohet kryesisht shpenzimeve për sigurimet shëndetësore, të cilat rezultojnë me një mosrealizim të planit prej 685 milionë lekë ose 2.1 për qind më pak se plani fillestar dhe shpenzimeve për sigurimet shoqërore, të cilat rezultojnë me një tejkalim të planit prej rreth 2.2 miliardë lekë ose 2.2 për qind më shumë se plani fillestar. Më konkretisht, shpenzimet për Sigurimet Shoqërore, në fund të dhjetorit 2014, arritën në 102.8 miliardë lekë, nga 100.6 të planifikuara për 2014 dhe shpenzimet për Sigurimet Shëndetësore, arritën në 32.2 miliardë lekë nga 32.9 miliardë lekë të parashikuara për vitin 2014. Ndërkohë, shpenzimet për kompensimin e pronarëve, të cilat arritën në 1.3 miliardë lekë nga 1.4 miliardë lekë të planifikuara, shfaqin një nivel realizimi prej rreth 94 për qind.




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Krahasuar me vitin e kaluar, shpenzimet për fondet speciale rezultojnë rreth 9.3 miliardë lekë më të larta dhe kjo shpërndahet për Sigurimet Shoqërore 5.9 miliardë lekë më shumë dhe shpenzimet për Sigurimet Shëndetësore 2.1 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet për kompensimin e pronarëve rezultojnë rreth 600 milionë lekë më pak se viti 2013. Si rezultat, shpenzimet për fondet speciale paraqiten në nivelin 9.3 miliardë lekë më shumë se viti 2013.

Shpenzime të Pushtetit Vendor

Shpenzimet e pushtetit vendor përfshijnë shpenzimet e kryera me të ardhurat e veta të njësisve të qeverisjes vendore, si dhe nga grantet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara të qeverisë. Në këtë zë shpenzimesh, përfshihen të gjitha shpenzimet e NJQV-ve, kryesisht për personelin dhe shpenzime të tjera operative të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Shpenzimet e pushtetit vendor zunë rreth 7.6 përqind të shpenzimeve korrente për vitin 2014. Për periudhën janar-dhjetor 2014, shpenzimet e pushtetit vendor kanë arritur në 33 miliardë Lekë, nga 37.2 miliardë të planifikuara për vitin 2014, duke rezultuar me një kursim prej 4.2 miliardë Lekë ose 11.3 përqind në terma vjetore. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime paraqesin një nivel realizimi prej 88.7 përqind.




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore për pushtetin vendor ka ardhur kryesisht nga mospërdorimi i pjesës së Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Në krahasim me vitin 2013, këto shpenzime rezultojnë 3.2 miliardë lekë më të larta ose 10.7 për qind më shumë. Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2014, janë ndër më të mëdhatë në 10 vitet e fundit. Rreth 14 miliardë lekë ose 42.5 për qind e totalit të shpenzimeve të buxhetit vendor janë destinuar për investime në rrugë, ujësjellësa, shkolla, qendra shëndetësore dhe infrastrukture vendore, ndërkohë që në vitin 2013 shpenzoheshin për investime vetëm 10 miliardë lekë ose 34 për qind e buxhetit vendor. Rreth 30 për qind e buxhetit vendore është destinuar për shërbime publike dhe vetëm 27.5 për qind e buxhetit vendore gjatë vitit 2014 është përdorur për shpenzime administrative.

Shpenzime të tjera të mbrojtjes sociale

Në zërin e shpenzimeve të tjera të mbrojtjes sociale, përfshihen shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike, kompensimi për ish-të përndjekurit politikë dhe kompensimet për shtresat në nevojë. Shpenzimet për pagesën e papunësisë, në fund të dhjetorit 2014, arritën në 912 milionë lekë nga 1 miliard lekë të planifikuara, duke u shoqëruar me një mosrealizim prej 88 milionë lekë. Në terma vjetorë, ky zë shpenzimesh shfaq një nivel realizimi prej rreth 91 për qind të planit fillestar. Në krahasim me vitin e kaluar, këto shpenzime rezultojnë 112 milionë lekë më të larta ose 10.2 për qind më shumë.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet për ndihmën ekonomike, që përbëjnë edhe zërin kryesor të shpenzimeve të përkrahjes sociale, në fund të dhjetorit arritën në 22.8 miliardë lekë, nga 21 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin fillestar, duke shfaqur kështu një tejkalim të planit me rreth 1.8 miliardë ose 8.8 për qind në terma vjetore. Në krahasim me vitin 2013 këto shpenzime rezultojnë rreth 17.5 për qind më të larta ose 3.4 miliardë lekë më shumë. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë rritje të shpenzimeve përmendim detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme ku vetëm gjatë vitit 2014 janë paguar si detyrime të prapambetura rreth 2.5 miliardë lekë.


Shpenzimet për kompensimin e ish të përndjekurve politikë arritën në 1,759 milionë lekë nga 1,800 milionë lekë të planifikuara, duke shfaqur kështu një nivel realizimi prej rreth 98 për qind të planit vjetor. Me qëllim që të bëhet kompensimi i ish të përndjekurve politikë e kryesisht për ata që jetojnë akoma, në mesin e vitit 2014 është bërë ndryshimi i ligjit për këtë problem. Kuadri ligjor i ndryshuar synon kompensimin e këtyre shtresave në një kohë sa më të shpejtë. Në vijim të këtyre ndryshimeve dhe me marrjen e masave të nevojshme gjatë vitit 2014 përfundoi dhënia e kështit të dytë, të tretë dhe filloi kësti i katërt për të përndjekurit politikë që janë ende gjallë. Shpenzimet për kompensimin e shtresave në nevojë, të planifikuara në nivelin 1.1 miliard lekë, u përdoren me Vendim të Këshillit të Ministrave për shpërblimin e pensionistëve në fund të vitit.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale përfshijnë fondet e planifikuara për investime publike të qeverisë qendrore dhe vendore, me financim të brendshëm nga të ardhurat publike ose nëpërmjet huamarrjes së brendshme, por edhe projektet me financim të huaj, pra që financohen nga një marrëveshje kredie apo granti të një qeverie apo institucioni financiar të huaj. Gjithashtu, ky zë shpenzimesh përfshin edhe fondet e shpërndara gjatë vitit buxhetor nga Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontingjencës për investime.


Në fund të vitit 2014, shpenzimet faktike kapitale arritën në nivelin 60.6 miliardë lekë, nga 66 miliardë lekë të planifikuara për periudhën 12-mujore, duke shfaqur kështu një nivel realizimi vjetor prej 91.8 për qind. Në terma absolute, investimet publike për vitin 2014, rezultojnë rreth 5.2 miliardë lekë më pak se plani vjetor dhe rreth 4.7 miliardë lekë më pak se shpenzimet faktike kapitale të vitit 2013. Megjithatë, duhet të mbahet në konsideratë fakti se, ndërsa ky zë

shpenzimesh përfshin fondet e alokuara gjatë vitit nga fondi rezervë dhe kontingjenca për investime, ai nuk merrë në konsideratë detyrimet e prapambetura për shpenzimet kapitale. Kjo për arsyen se



Burimi: Ministria e Financave (2015);

fondi i detyrimeve të prapambetura është përfshirë në tabelën e treguesve fiskalë si zë më vete, që shpërndahet gjatë vitit, për shpenzime korrente dhe/ose kapitale. Prandaj, nëse do të shtohet edhe fondi prej rreth 10 miliardë lekë i shpërndarë për investime publike nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit, shpenzimet kapitale faktike arrijnë në nivelin prej rreth 71 miliardë lekë që do thotë 5 miliardë lekë më shumë nga plani i vitit 2014 dhe po ashtu 5 miliardë lekë më shumë se realizimi i vitit 2013.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, arritën në 34 miliardë lekë nga 35.2 miliardë të planifikuara, duke u shoqëruar kështu me një nivel realizimi prej 96.2 për qind. Në krahasim me vitin e kaluar investimet me financim të brendshëm rezultojnë rreth 2.7 miliardë lekë ose 7.4 për qind më të ulëta. Ndërkohë, investimet me financim të huaj, të planifikuara në

nivelin 29.9 miliardë lekë, u realizuan në masën 26.8 miliardë lekë ose në të njëjtin nivel të vitit 2013. Buxheti i investimeve për vitin 2014 ka financiar sektorë dhe degë të ndryshme të ekonomisë, të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejt në rritjen ekonomike për këtë periudhë.

Disa nga treguesit e arritur nga financimi i projekteve dhe fushave të ndryshme për vitin 2014 janë:

Në fushën e arsimit

- Ndërtimi dhe rikonstruksioni i 60 shkollave 9-vjeçare dhe i 14 shkollave të arsimit të mesëm;
- Ndërtimi i 46 terreneve sportive në 12 qarqet e vendit;
- Ndërtimi i 3 objekteve arsimore në institucionet e arsimit të lartë;
- Financimi dhe përfundimi i 96 kontrata/objekte në vazhdim nga viti 2009-2013;
- Blerje pajisje e orendi për më shumë se 90 institucione arsimore;
- Digjitalizimin e sistemit para-universitar shqiptar, i cili përbëhet nga 4 komponentë. Secili komponent luan një rol të rëndësishëm brenda Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Arsimit (SKMA) dhe synon krijimin e një shoqërie të bazuar në njohuri, informacion dhe teknologji.
- Ndërtimi i infrastrukturës sportive i projektit “Tirana Olimpik Park”;
- Projekti “Për ngritjen dhe funksionimin e QNSRT”, si dhe të tjera projekte të huaja, me fonde të qeverisë shqiptare dhe Qeverisë Italiane.

Këto investime të kryera mundësojnë sigurimin e kushteve më të mira të infrastrukturës dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, për rreth 580 mijë nxënës/fëmijë si dhe për 38,300 mësues/edukatorë e punonjës të institucioneve arsimore.

Në fushën e shëndetësisë

- Është kryer kostimi i 10 paketave për sëmundjet më të rëndësishme të zemrës dhe veshkave, duke bërë të mundur kontraktimin dhe financimin e pacientëve edhe në spitalet private;
- Fillimi i Check-up pa pagesë për moshat 40-65 vjeç;
- Është blerë një CT skaner për Spitalin e Traumës;
- Janë blerë 2 mamografi lëvizëse;
- Është kryer për herë të parë pas 25 vjetësh dezinfektimi i zonave ligatinore të vendit;
- Janë realizuar ndërhyrje të rëndësishme në infrastrukturën e disa spitaleve si:
 - Ndërtimi i Spitalit Psikiatrik në Vlorë;
 - Kompletimi dhe shndërrimi i ish-Sanatoriumit në Spital Universitar;
 - Ndërhyrje në patologjinë e barrës në Maternitetin “Koço Gliozheni”;
 - Rikonstruksion i plotë dhe pajisje mobilierie për Shërbimin e Neurologjisë në QSUT.
- Blerja e një helikopteri sanitar;
- Blerja e një pakete prej 20 autoambulancash;
- Blerja e 2 angiografeve për QSUT dhe Spitalin Rajonal Shkodër;
- Blerja e një rezonance manjetike për Spitalin Universitar të Traumës;
- Blerje e një pakete pajisjesh mjekësore moderne për shërbimin e Kardio-kirurgjisë në QSUT;
- Blerje e një pakete inkubatorësh për Maternitetet e Tiranës.

Në fushën e ekonomisë

- Reforma “Doing Business” ka bërë që të përmirësohet renditja me 40 vende në Raportin “Të bësh biznes 2015”;
- Paketa mbështetëse për sektorin e industrisë fason, ka sjellë këto impakte pozitive:

- Rritje e eksportit me 26.1 për qind krahasuar me një vit më parë;
- Rritje e punësimit të industrisë fason me mbi 5000 vende të reja;
- Rritje e numrit të subjekteve të industrisë fason me 3.8 për qind krahasuar me vitin 2013;
- Sporteli aktiv “One-Stop-Shop” për industrinë e fasonëve pranë AIDA.
- Mbështetja financiare për bizneset nëpërmjet:
 - Fondit për ekonominë kreative;
 - Fondit të konkureshmërisë;
 - Fondit të inovacionit.

Infrastruktura

- Ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore i 83.3 km rrugë;
- Rikonstruktuar 64.42 km rrugë;
- Ndërtuar 85 798 ml “Lidhje të reja të furnizimit me ujë”;
- Ndërtuar 166 508 ml “Rrjet kanalizimesh të ujërave të zeza i shtruar”;
- Ndërtuar dy Impiante të Trajtimit të Ujërave të Zeza.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

- Remonti i 28 hidrovorëve;
- Ndërtimi i Labororit Veterinar;
- Rritja e financimit për skemat mbështetëse në bujqësi;
- Nëpërmjet Programit “Zonat malore drejt tregut”:
 - Ndërtimi i 25 objekteve infrastrukturore rurale;
 - Rehabilitimi i 31.4 km rrugëve rurale;
 - Rehabilitimi i 11 skemave kullimi;
 - Digjitalizimi i Regjistrimit të Tokës Bujqësore në 41 komuna/bashki;
 - Ndërtimi i Portit të Ri të Peshkimit në Durrës.

Kultura

- Restaurimi dhe Mirëmbajtja e Monumenteve të Kulturës në Qendrën Historike të Qytetit të Beratit;
- Restaurimi dhe mirëmbajtja e Kalasë së Durrësit, Krujës, Elbasanit, Tiranës dhe Gjirokastrës;
- Mirëmbajtje dhe pastrimi i monumenteve: Kisha e Marmiroit, Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Mavrovës;
- Mirëmbajtje dhe ndërhyrje restauruese në fasadën e Muzeut Arkeologjik Korçë;
- Mirëmbajtje, konservim dhe restaurim në banesën Oso Kuka në Kalanë Rozafa, Shkodër.
- Rikonstrukcioni i Sheshit “Nënë Tereza”;
- Rikonstrukcioni i muzeve:
 - Arkeologjik, Durrës;
 - Historik Kombëtar;
 - Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë;
 - Kombëtar të Fotografisë “Marubi”;
 - Onufri dhe Muzeun Etnografik;
 - Skënderbeu dhe Muzeun Etnografik Krujë;
 - Muzeu i Ri të Përgjimeve Sekrete “Muzeu i Gjetheve”;

- Muzeu i Ri i Bashkëjetesës.
- Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale;
- Veprimtari dhe punime të ndryshme në kuadër të 70-vjetorit të Çlirimit të vendit.

Drejtësia

- Janë kompensuar 648 pronarë;
- Është ndërtuar Burgu Berat, sipas kushteve të caktuara nga Bashkimi Evropian.

Mirëqenia Sociale dhe Rinia

- Trajnuar dhe pajisur me certifikatë 13 102 persona;
- Nga programet direkt të nxitjes së punësimit janë punësuar/trajnuar, 3 913 persona;
- Ofruar ndërmjetësime për 16 000 punëkërkues të papunë;
- Rinovim Zyrash në Aparatin e Ministrisë Mirëqenies Sociale dhe Rinise;
- Blerje kabinetesh për Qendrat e Formimit Profesional;
- Rikonstrukcion për Zyrat e Punësimit;
- Rikonstrukcion godine për Qendrën e Shërbimit Rinor, Tiranë;
- Projekti “Mbështetja për përfshirjen sociale të komunitetit rom”;
- Projekti “Modernizim i Asistencës Sociale”.

Zhvillimi Urban dhe Turizmi

- Ndërhyrjet emergjente dhe rikonstrukcione të banesave të romëve;
- Shpronësime të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i veprave publike;
- Projekti “Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i Zonës Bregdetare”.

Deficiti publik

Niveli i shpenzimeve prej 438.8 miliardë lekësh, me të ardhurat faktike prej 366.7 miliardë lekë rezultuan në një deficit buxhetor prej 72.1 miliardë lekë nga 88.4 miliardë lekë i planifikuar për vitin 2014. Ky deficit u financua kryesisht nëpërmjet huamarrjes së brendshme dhe të huaj, përfshirë mbështetjen buxhetore të dhënë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Më konkretisht, nëpërmjet burimeve të brendshme u financua 42.2 miliardë lekë deficit, ndërkohë që 29.9 miliardë lekë u financuan nga huamarrja e huaj, e cila përbëhet nga mbështetja buxhetore dhe financimi i projekteve të huaja.

Borxhi publik

Borxhi publik i Qeverisë Qendrore në fund të vitit 2014 vlerësohet 977,102 milionë lekë ose 69.11 për qind e PBB-së.



Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm janë vlerësuar përkatësisht 39.94 për qind dhe 29.17 për qind i PBB-së. Ndërkohë, nëse i referohemi dhe detyrimeve të prapambetura, borxhi total vlerësohet në 71.76 për qind në raport me PBB-në.

Tabela 12: Ecuria e Stokut të Borxhit

Në milion LEKË	2010	2011	2012	2013	2014
Stoku Borxhit	715,371.01	772,516.93	827,980.79	884,692.28	977,102.19
I. Stoku Borxhit Brendshëm	407,371.80	438,582.00	470,358.47	520,786.36	564,673.33
-shtetëror	401,821.00	429,924.80	454,695.37	500,868.36	538,640.59
-garantuar	5,550.80	8,657.20	15,663.10	19,918.00	26,032.74
II. Stoku Borxhit Jashtëm	307,999.21	333,934.93	357,622.32	363,905.92	412,428.86
-shtetëror	268,124.46	294,275.97	319,832.52	332,499.72	383,921.58
-garantuar	39,874.75	39,658.96	37,789.80	31,406.20	28,507.28
PBB	1,239,645	1,300,624	1,335,488	1,364,782	1,413,931
Stoku Borxhit Gjithsej/PBB	57.71%	59.40%	62.00%	64.82%	69.10%
Stoku Borxhit Brendshëm/PBB	32.86%	33.72%	35.22%	38.16%	39.94%
Stoku Borxhit Jashtëm/PBB	24.85%	25.67%	26.78%	26.66%	29.17%
Stoku Borxhit Gjithsej + Arrears/PBB				70.06%	71.76%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Gjatë vitit 2014 borxhi është rritur me 10.45 për qind ose 92.4 miliardë lekë krahasuar me vitin e kaluar, ku peshën më të madhe, për sa i përket rritjes, rreth 52.51 për qind, e ka pasur borxhi i jashtëm.




Burimi: Ministria e Financave (2015);

Nga grafikët e mësipërm vërehet se borxhi gjatë vitit 2014 ka pësuar një rritje krahasuar me vitet e mëparshme. Gjithsesi, duhet marrë në konsideratë që nga 92.4 miliardë lekë shtesë në stokun e borxhit, 12.9 miliardë lekë i atribuohen shtesës së shkaktuar nga ndryshimi në kursin e këmbimit.

Në këtë kontekst, rezulton se realisht 79.5¹ miliardë lekë kanë shkuar për të mbuluar diferencën ndërmjet ardhurave dhe shpenzimeve në buxhet. Gjithashtu duhet theksuar se nga 79.5 miliardë lekë, 33.9 miliardë lekë i janë akorduar likuidimit të detyrimeve të prapambetura duke bërë që deficitin për zërat e tjerë të shpenzimeve në buxhet të vlerësohet në rreth 45.6 miliardë lekë.

Huamarrja e brendshme vjetore për vitin 2014 ishte buxhetuar në vlerën e 50.24 miliardë lekë². Në përputhje me parashikimet makroekonomike mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore, si dhe parashikimin e likuiditetit për mbylljen e vitit 2014 dhe fillimin e vitit 2015, huamarrja vjetore në tregun e brendshëm u planifikua në 40 miliardë lekë. Ndërkohë, realizimi në fund të vitit 2014 rezultoi në 37,75 miliardë lekë ose 94.38 për qind e planit të huamarrjes.

Aktorët kryesorë të cilët realizuan huamarrjen e brendshme gjatë vitit 2014 ishin: BKT e cila financoi 53.08 për qind të totalit të realizimit vjetor, Fondi Prestigj me 28.72 për qind dhe Banka “Credins” me 23.40 për qind. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe Banka “Raiffeisen” ka ulur³ portofolin e saj të investimeve në tituj qeveritarë.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Një nga problemet e konstatuara në realizimin e huamarrjes së brendshme gjatë vitit 2014 ka qenë tërheqja substanciale e Bankës Raiffeisen nga investimi në titujt qeveritar me 20.5 miliardë

¹ *Sqarim:* Diferenca prej 7.4 miliardë lekë ndërmjet këtyre të dhënave dhe deficitit të pasqyrës vjetore fiskale rezultoi nga mospërfshirja e garancive dhe sektorit energjetik në pasqyrën fiskale

² Referuar Aktit Normativ për vitin 2014

³ Banka Raiffeisen ka maturuar 32.92% të portofolit të saj për vitin 2014

lekë. Gjatë kësaj tërheqje Banka Raiffeisen ka menaxhuar që të ul ekspozimin në titujt afatgjatë duke maturuar 23.2 miliardë lekë në obligacione dhe duke shtuar portofolin e bonove të thesarit me 2.7 miliardë lekë. Një menaxhim i kësaj natyre ka ndodhur edhe nga bankat e tjera pjesëmarrëse në instrumentet financiarë shtetërorë duke vështirësuar procesin e thellimit të mëtejshëm të raportit ndërmjet instrumenteve afatgjata dhe afatshkurtra. Bankat përshtasin një politikë konservatore nga pikëpamja e ekspozimit ndaj riskut afatgjatë duke qenë se ato investojnë në ankandet e titujve qeveritarë përmes strategjisë “Held to maturity” në mungesë të një tregu sekondar të zhvilluar ku bonot dhe obligacionet mund të shiten me lehtësi dhe me kosto të ulët në rast nevojë për likuiditet.

Pavarësisht zhvillimeve të përmendura më lart, Ministria e Financave ka qenë në gjendje që të plotësojë pa problem nevojat e Qeverisë për likuiditet gjatë gjithë vitit 2014 dhe njëkohësisht është arritur që financimi neto të realizohet më së shumti (60.74 për qind) nëpërmjet instrumenteve me afat të gjatë maturimi, duke rritur jetëgjatësinë e borxhit dhe njëkohësisht duke ulur riskun e refinancimit.

Në financimin e deficitit me instrumentet afatgjatë peshën më të madhe e zënë obligacionet 10-vjeçare me 55.94 për qind, obligacionet 7-vjeçare 21.92 për qind, obligacionet 2-vjeçare 15.71 për qind dhe 3-vjeçare 7.08 për qind, ndërkohë që obligacionet 5-vjeçare janë ulur (maturuar).

Tabela 13: *Financimi i deficitit sipas instrumentave të tregut të brendshëm*

<i>Në milion LEKË</i>	Mars 2014	Qershor 2014	Shtator 2014	Dhjetor 2014
Financimi i Deficitit	8,659.80	21,419.10	32,952.71	37,749.59
Instrumenta Financiare Gjithsej	8,659.80	21,419.10	32,952.71	37,749.59
Bono Thesari Gjithsej	2,116.30	10,413.90	7,310.07	14,820.95
-Bono Thesari Lekë	2,116.30	10,413.90	8,550.93	13,332.92
-Bono Thesari Euro	0.00	0.00	-1,240.86	1,488.03
Obligacione Gjithsej	6,543.50	11,005.20	25,642.65	22,928.65
Obligacione Lek	6,543.50	11,005.20	20,311.85	17,597.85
- Oblig.e qeverisë 2-vjeçare	1,118.90	1,846.00	-508.45	-1,729.95
- Oblig.e qeverisë 3-vjeçare	-1,867.40	-1,170.50	-377.00	1,623.00
- Oblig.e qeverisë 5-vjeçare	1,329.00	-170.30	924.70	-149.60
- Oblig.e qeverisë 7-vjeçare	3,963.00	6,897.70	10,562.40	5,027.10
- Oblig.e qeverisë 10-vjeçare	2,000.00	3,602.30	9,710.20	12,827.30
Obligacione Euro	0.00	0.00	5,330.80	5,330.80

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Pavarësisht përmirësimeve të dukshme, vlen të theksohet që portofoli i borxhit në terma afatmesëm dhe afatgjatë mbetet ende i ekspozuar ndaj riskut të refinancimit dhe për këtë arsye është planifikuar vazhdimi i përmirësimit të tij në kuadër të zgjatjes së jetëgjatësisë dhe rritjes së qëndrueshmërisë.

Për sa i përket borxhit të garantuar, gjatë vitit 2014 ky borxh është rritur me 3.2 miliardë lekë dhe e gjithë rritja e garancive i atribuohet garancive të brendshme, të cilat janë emetuar në favor të korporatës KESH sh.a. në vlerën e 6.1 miliardë lekëve me qëllim që të garantohet rritja e

eficiencës së sistemit energjetik. Ndërkohë, garancitë e jashtme vlerësohen në ulje me 2.9⁴ miliardë lekë.

Huamarrjes lokale vazhdon të jetë në nivele minimale krahasuar me totalin e borxhit publik. Gjatë vitit 2014 huamarrja lokale është realizuar në vlerën e 462 milionë lekëve dhe në total niveli i stokut vlerësohet në 854.8 milionë lekë⁵.


Gjatë vitit 2014 janë disbursuar rreth 385.0 milionë Euro, nga të cilat 384.6 milionë Euro i përkasin borxhit shtetëror. Krahasuar me vitin 2013 vërehet një rritje e konsiderueshme e disbursimeve, e cila vlerësohet rreth 199.9 milionë Euro.

Tabela 14: Disbursimet e borxhit të jashtëm

Në milion Euro	2010	2011	2012	2013	2014
Disbursime Total	472.88	222.01	277.85	185.04	385.02
Disbursime Shtetëror	461.12	205.76	267.61	179.68	384.55
Disbursime Garanci	11.76	16.25	10.24	5.36	0.47

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Kjo rritje i atribuohet mbështetjes buxhetore në një vlerë prej 218.7 milionë Euro. Ndërkohë disbursimet e projekteve me financim të huaj janë në nivele relativisht të ulëta krahasuar me vitin e kaluar, (rreth 19 milionë Euro më pak).



⁴ Realisht garancitë e jashtme janë ulur me 3.1 miliardë lekë, por efekti i zhvlerësimit të monedhës vendase ka bërë që ato të vlerësohen në rritje

⁵ Pesha e mbajtur nga borxhi i pushtetit vendor në raport me totalin e borxhit publik vlerësohet 0.09%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Rreth 87% e disbursimeve të projekteve me financim të huaj i atribuohen sektorëve të Transportit, Ujësjellës-Kanalizimeve dhe sektorit të Energjisë, përkatësisht 45.85%, 22.51% dhe 19.05%.

Shuma e angazhuar dhe e padisbursuar është në nivele të larta rreth 790 milionë Euro (pa përfshirë mbështetjen buxhetore të padisbursuar). Ky tregues kërkon vëmendje nga ana e ministrive të linjës lidhur me kontraktimin e projekteve të reja dhe eficiencën e projekteve ekzistuese.

Përsa i përket marrëdhënieve me kreditorët, Republika e Shqipërisë vazhdon të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme me kreditorët e projekteve me financim të huaj duke paraqitur një nivel bashkëpunimi të lartë dhe duke përcjellë konfidencë tek kreditorët nëpërmjet likuidimit të detyrimeve të saj në kohë.

Gjatë vitit 2014 në kuadër të financimit të projekteve, Republika e Shqipërisë ka pasur marrëdhënie dinamike me kreditorë të tillë si BERZH, KFW, IDB, EIB, IDA, qeverinë Austriake, IBRD, etj, duke disbursuar në total shumën prej 166 milion Euro dhe duke nënshkruar projekte që kapin vlerën e 759 milion Euro.


4.2 Buxheti i pushtetit vendor

Reforma e decentralizimit në përgjithësi dhe ajo e decentralizimit fiskal në veçanti, ka rritur në mënyrë të ndjeshme mundësinë e rritjes së fondeve për shërbime dhe investime publike në nivel vendor. Gjithashtu, ajo ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme strukturën e burimeve të të ardhurave të pushtetit vendor. Në vitin 2002, që përfaqëson edhe vitin e fundit të skemës së vjetër të financimit të pushtetit vendor, kjo strukturë ishte 76 me 24 për qind në favor të burimeve që vinin nga buxheti i shtetit. Në buxhetin e vitit 2014, të ardhurat për financimin e pushtetit vendor për ushtrimin e funksioneve të veta siguroheshin mbi 60 për qind nga taksat dhe tarifatat vendore dhe më pak se 40 për qind nga buxheti i shtetit.

Buxheti vendor në vitin 2014 zinte 2.4 për qind të PBB-së dhe ishte me i madhi i 5 viteve të fundit.

Paketa fiskale për pushtetin vendor e miratuar në dhjetor të vitit 2013, e cila hyri në fuqi në janar 2014 pati efekte pozitive në rivendosjen e ekuilibrave të nevojshëm fiskale të munguar dhe në krijimin e një mjedisi fiskal të drejtë, të ndershëm e nxitës për individin, biznesin dhe ekonominë publike.

Heqja e taksës së biznesit të vogël, rifutja e tatimit të thjeshtuar të fitimit, ndryshimi në nivelin e taksës mbi pasurinë, si dhe çlirimi i autonomisë fiskale nga kufizimet për vendosjen e tarifave vendore ka pasur efekte pozitive në buxhetin e vitit 2014. Në kontekstin e këtyre reformave fiskale njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2014, kanë mbledhur në total të ardhura tatimore në masën 12 447 milionë lekë, vlerë e cila është 1 622 milionë lekë më e madhe ose 15 për qind më lartë se në vitin 2013.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Për vitin 2014, pushteti vendor ka mbledhur 1 224 milionë lekë ose afërsisht 50 për qind më shumë të ardhura nga taksat mbi pasurinë. Nga kjo taksë ndër vite janë mbledhur pak të ardhura dhe për rrjedhojë kjo taksë nuk e ka patur peshën që duhej të kishte në strukturën e të ardhurave të pushtetit vendor. Ndërhyrjet që u bënë nëpërmjet paketës fiskale në vitin 2014 sollën që të ardhurat të rriteshin në mënyrë të ndjeshme. Të ardhurat nga taksat e biznesit të vogël paraqiten me rënie, por rënia e këtyre të ardhurave do të ketë efekte pozitive në këtë sektor për vitet e tjera, pasi me uljen e barrës fiskale do të investohen më shumë duke krijuar vende të reja pune. Edhe të ardhurat nga taksat e tjera janë 600 milionë lekë më shumë ose 10 për qind më të larta se në vitin 2013.

Tabela 15: Të ardhurat tatimore


Në mijë lekë

Lloji i Taksës	2013	2014	Ndryshimi	
			në vlerë	Në përqindje
Tatimi mbi biznesin e vogël	1 975	1 709	-266	-13,5%
Tatimi mbi pasurinë	2 454	3 678	1,224	49.8
Taksa e tarifa të tjera	6 396	7 060	664	10%
TOTALI	10.825	12,447	1,622	15%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të njësisve të qeverisjes vendore

Shpenzimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2014, kapin shumën 33 miliardë lekë, shifër kjo që është rreth 3 miliardë lekë më shumë ose afërsisht 10.7 për qind më e larta se shpenzimet e realizuara në vitin 2013. Brenda shumës së shpenzimeve për pushtetin vendor prej 33 miliardë lekë, 10 milion lekë janë transferata nga pushteti vendor në atë qendror, si komisione ligjore për rolin si agent tatimor për mbledhjen e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël.



Burimi: Ministria e Financave (2015);

Tabela 16: Shpenzimet dhe të ardhurat buxhetore sipas peshës specifike

Në përqindje

	Bashkitë	Komunat	Qarqet	Total
Shpenzimet	59,6 %	34,3 %	6,1 %	100 %
Të ardhurat	72,2 %	27,1 %	0,7 %	100 %

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Pjesa më e madhe e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në buxhetin faktik të vitit 2014, respektivisht 59.6 për qind për shpenzimet dhe 72.2 për qind për të ardhurat, realizohen nga bashkitë. Komunat kanë realizuar 34,3 për qind të vlerës së të ardhurave dhe kryejnë 27.1 për qind të shpenzimeve totale. Po ashtu edhe Këshillat e Qarqeve kanë realizuar 6.1 për qind të vlerës së të ardhurave dhe kryejnë 0.7 për qind të shpenzimeve totale.

4.3 Detyrimet e prapambetura

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura si komponent i rëndësishëm i stabilizimit të Financave Publike ka qenë dhe mbetet prioritet i Qeverisë. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 05.02.2014, u miratua Strategjia e Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura. Kjo strategji parashikon dhe programon shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe njëkohësisht edhe masat e nevojshme dhe ndërhyrjet e duhura ligjore për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Pas këtij dokumenti filloi procesi i shlyerjes së pagesave të prapambetura për subjektet/individët kundrejt të cilëve institucionet buxhetore kishin detyrime të maturuara dhe të paguara përpara dhjetorit të vitit 2013.

Fondet e caktuara për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nuk janë pjesë e buxhetit të miratuar për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme. Fondet buxhetore për këtë kategori miratohen nga Ministri i Financave si zë më vete në buxhet dhe rrisin nivelin maksimal të shpenzimeve për çdo njësi të qeverisjes qendrore, mbështetur në masën e detyrimeve të

prapambetura. Në kuadër të strategjisë së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura këto detyrime do të shlyhen brenda periudhës 2014-2016.

Në bazë të strategjisë, në buxhetin e vitit 2014, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura u planifikua fondi prej 35 miliardë lekë, nga të cilat janë paguar rreth 34 miliardë lekë me një realizim rreth 97 për qind të fondeve të alokuara. Në tabelën e mëposhtme jepet detajimi i alokimit të fondeve dhe realizimit të tyre, e ndarë sipas kategorive të përcaktuara në Strategjinë e Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura.

Tabela 17: Detajimi i alokimit të fondeve sipas Strategjisë së Shlyerjes së Detyrimeve të prapambetura:

Detyrimet sipas kategorive	Viti 2014		Paguar në përqindje
	Çelur miliard lekë	Paguar miliard lekë	
Detyrime për kontrata të investimeve publike	10.1	9.8	97
Detyrime për shpenzimet për mallra dhe	5.6	5.2	93
Rimbursimi i TVSH-së dhe Tatim Fitimi	12.9	12.8	99
Kategori të tjera nga të cilat	6.4	6	94
Vendime Gjyqësore	3.5	3.2	91
Shpronësime	0.4	0.3	75
PAK	2.3	2.3	100
Emergjencia civile dhe shpërblime për lindjet	0.2	0.2	100
Totali	35	34	97

Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për kategorinë “Kontrata për Investimet Publike”, gjatë vitit 2014, janë alokuar rreth 10.1 miliardë lekë, të cilat i përkasin detyrimeve për periudhën 2005-2013. Deri në fund të vitit 2014 janë paguar rreth 9.8 miliardë lekë ose 97 për qind të totalit të financuar për këtë kategori.

Ministritë kryesore në realizimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për këtë kategori janë si më poshtë vijon:

- Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës janë alokuar 7.8 miliardë lekë nga të cilat janë paguar 7.7 miliardë lekë ose rreth 99 për qind e fondit total;
- Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë alokuar 926 milionë lekë nga të cilat janë paguar 834 milionë lekë ose rreth 90 për qind e fondit total;
- Për Ministrinë e Punëve të Brendshme janë alokuar 105 milionë lekë nga të cilat janë paguar 94 milionë lekë ose rreth 90 për qind e fondit total;
- Për projektet e infrastrukturës rurale janë alokuar 541 milionë lekë nga të cilat janë paguar 395 milionë lekë ose rreth 73 për qind e fondit total.

- Detyrimet të prapambetura për kategorinë “Shpenzimet për mallra dhe shërbime”, gjatë vitit 2014 janë alokuar rreth 5.6 miliardë lekë, të cilat i përkasin detyrimeve për periudhën 2005-2013 dhe deri në fund të vitit 2014 janë paguar rreth 5.2 miliardë lekë ose 93 për qind të totalit të financuar.

Ministritë kryesore në realizimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për këtë kategori janë si më poshtë vijon:

- Për Ministrinë e Shëndetësisë janë alokuar 3.5 miliardë lekë nga të cilat, janë paguar 3.4 miliardë lekë ose rreth 97 për qind e fondit total;

- Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë alokuar 253 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 242 milionë lekë ose rreth 96 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Mbrojtjes janë alokuar 1.1 miliardë lekë nga të cilat, janë paguar 848 milionë lekë ose rreth 79 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Punëve të Brendshme janë alokuar 309 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 300 milionë lekë ose rreth 97 përqind e fondit total.
- Për sa i përket shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për kategorisë “*Rimbursim i TVSH-së*”, gjatë vitit 2014 janë alokuar rreth 12.9 miliardë lekë nga të cilat, deri në fund të vitit 2014 janë paguar rreth 12.8 miliardë lekë ose 100 përqind e fondit të alokuar për këtë kategori.
 - Në kategorinë “*Të tjera*” (sipas klasifikimit në Strategjinë për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura përfshihen detyrimet për vendime gjyqësore, shpronësime, pagesat për personat me aftësi të kufizuar (PAK), emergjenca civile dhe shpërblimet për lindjet, etj). Fondi i alokuar për:
 - a. Vendime Gjyqësore gjatë vitit 2014 është rreth 3.5 miliardë lekë nga të cilat janë paguar rreth 3.2 miliardë lekë ose 91 përqind e totalit të alokuar;
Ministritë kryesore në realizimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për këtë kategori janë si më poshtë vijon:
 - Për Ministrinë e Financave janë alokuar 813 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 809 milionë lekë ose rreth 99 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës janë alokuar 650 milionë lekë nga të cilat janë paguar 614 milionë lekë ose rreth 95 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Mjedisit janë alokuar 271 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 262 milionë lekë ose rreth 97 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë alokuar 309 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 254 milionë lekë ose rreth 82 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit janë alokuar 294 milionë lekë nga të cilat janë paguar 271 milionë lekë ose rreth 73 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes janë alokuar 144 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 141 milionë lekë ose rreth 98 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë janë alokuar 91 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 90 milionë lekë ose rreth 99 përqind e fondit total;
 - Për Ministrinë e Punëve të Brendshme janë alokuar 231 milionë lekë nga të cilat, janë paguar 201 milionë lekë ose rreth 87 përqind e fondit total.
 - b. Shpronësime rreth 1.6 miliardë lekë nga të cilat janë paguar rreth 1.5 miliardë lekë ose 75 përqind e totalit të alokuar,
 - c. PAK është rreth 2.3 miliardë lekë dhe janë paguar 2.3 miliardë lekë ose 100 përqind e totalit të alokuar,
 - d. Emergjenca civile dhe shpërblimi i lindjeve rreth 0.2 miliard dhe paguar 0.2 miliard lekë ose 100 përqind e totalit të alokuar.

4.4 Buxheti i Skemave të Sigurimeve Shoqërore

Në programin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2014 ishin këta objektiva:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme, nëpërmjet reformimit dhe zbatimit të një sistemi sigurimesh shoqërore, i cili i përgjigjet më mirë stadi të arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit, por dhe në harmoni me zhvillimet e ardhshme.
- Intensifikimi i përpjekjeve për përmirësimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen graduale, por më të shpejtë të kontributeve, në krahasim me rritjen e përfitimeve, si dhe duke ulur gradualisht peshën specifike të subvencioneve buxhetore.
- Pjesëmarrja e plotë e ISSH-së dhe bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare për realizimin e një reforme thelbësore të sistemit të sigurimeve shoqërore e cila tashmë është e realizuar dhe ka filluar zbatimin.

Në funksion dhe zbatim të këtyre objektivave, janë arritur rezultatet sipas fushave të mëposhtme:

Në fushën e përfitimeve

- U realizuan menjëherë të gjithë procedurat administrative të rritjes së pensioneve, si dhe pagesave për mbi 598 mijë përfitues nga data 01.08.2014, si dhe në favor të pensionistëve, me një efekt financiar prej 998 milionë lekësh.

Pensioni mesatar dhe të ardhurat mesatare të pensionistëve paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela 18: Pensioni mesatar dhe të ardhurat mesatare të pensionistëve *Lekë/muaj*

Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014
Pensioni mesatar i pleqërisë					
Pensionet Urbane	12,153	12,654	13,324	14,076	14,710
Pensionet Rurale	6,576	7,139	7,457	7,465	7,383
Të ardhurat mesatare të pleqërisë					
Pensionet Urbane	13,737	14,166	14,836	15,591	16,266
Pensionet Rurale	7,258	7,748	8,059	8,05	7,963

Burimi: Ministria e Financave (2015);

- U realizua në një kohë rekord e gjithë procedura administrative e dhënies së shpërblimeve dhe pagesave për afër 600 mijë përfitues me një efekt financiar rreth 1,296 milionë lekë.
- U zbatuan standarde të reja në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj pensionistëve sidomos në fushën e transparencës së përfitimeve të caktuara. Hapi më i rëndësishëm është bërë në drejtim të transparencës së pagesave nëpërmjet qeverisjes së tyre me sisteme informatike të cilat, ndër të tjera kanë përmirësuar ndjeshëm edhe administrimin financiar të sistemit.
- Një përmirësim rrënjësor i punës, në luftën kundër informalitetit si në fushën e të ardhurave ashtu edhe në atë të përfitimeve. Kjo është arritur nëpërmjet përdorimit të software-ve të ndryshme, të krijimit të bazës së të dhënave të përfituesve e kontribuesve, lidhjes së tyre me Regjistrin e Gjendjes Civile dhe data-bazat e sistemeve të tjera.
Numri i përfituesve në pesë vitet e fundit paraqitet si më poshtë:

Tabela 19: Numri i përfituesve të pensionit

(Numër)

Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014
Pensionistë Urbanë					
Pensione Pleqërie	12,153	12,654	13,324	14,076	14,710
Pensione Invaliditeti	6,576	7,139	7,457	7,465	7,383
Pensione Familjare					
Pensionistë Rurale					
Pensione Pleqërie	13,737	14,166	14,836	15,591	16,266
Pensione Invaliditeti	7,258	7,748	8,059	8,05	7,963
Pensione Familjare	7,258	7,748	8,059	8,05	7,963
Totali i numrit të pensioneve	7,258	7,748	8,059	8,05	7,963

*Burimi: Ministria e Financave (2015);***Në drejtim të të ardhurave dhe administrimit financiar të sistemit**

- U intensifikuan përpjekjet për plotësimin e detyrës së programuar për të ardhurat nga kontributet e personave të vetëpunësuar në bujqësi, nga kontributet vullnetare dhe të ardhurat e tjera, nën përgjegjësi të mbledhjes nga ISSH, duke arritur që në total plani të realizohet 318.7 për qind, me një tejkalim në shumë absolute prej 5,917.9 milionë lekë.
- U tejkaluan ndjeshëm të ardhurat në të gjithë zërat e programuar apo subjektet kontribuese, por në mënyrë të veçantë, si pasojë e zbatimit të dispozitave të faljes së kamatvonesave për personat e vetëpunësuar në bujqësi, të ndryshimeve ligjore në zbatim të reformës së sistemit, të cilat fokusojnë një lidhje të drejtpërdrejtë të kontributeve të derdhura me masën e pensionit, programi i të ardhurave nga kontributet e personave të vetëpunësuar në bujqësi u realizua 348 për qind ose me një tejkalim të të ardhurave në shumën 5,422.6 milionë lekë.
- Në vitin 2014 evidentohen përmirësime të ndjeshme të punës së DPT në drejtim të realizimit të të ardhurave, të luftës kundër evazionit, të kontributeve si dhe të rritjes së ndjeshme të numrit të kontribuesve dhe mbledhjes së borxheve. Programi financiar i të ardhurave që mbledhen nga DPT për llogari të fondit të sigurimeve shoqërore është realizuar 101.3 për qind me një tejkalim prej 673 milionë lekë.
- Për vitin 2014, në total janë realizuar 61,719.8 milionë lekë të ardhura me një tejkalim ndaj programit për 6,590.8 milionë lekë ose 111.9 për qind. Krahasuar me vitin 2013, të ardhurat rezultojnë me një rritje në shumë absolute prej 10,329 milionë lekë ose rreth 20 për qind. Viti 2014 është viti i parë ku reflektohet ndalim i shtesës së deficitit të sistemit të sigurimeve shoqërore pasi të ardhurat janë rritur me 10,329 milionë lekë kundrejt 6,013 milionë lekëve që janë rritur shpenzimet.

Tabela 20: Të ardhurat e vitit 2014


N.R	Emërtimi	Në milion lekë		Në përqindje
		Plan	Fakt	
1	Nga subjektet juridike e fizike	52,423	53,095.95	101.28
2	Nga subjektet e tjera		6.84	
3	Nga sigurimi i të vetpunësuarve në bujqësi	2,187	7,609.61	347.95
4	Nga sigurimet vullnetare	370	425.27	114.94

Të ardhura nga investimet financiare dhe			
5 kamatëvonesa	149	582.14	390.70
Totali i të ardhurave	55,129	61,719.81	111.96

Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Megjithëse norma ligjore e kontributit është reduktuar nga 38.5 në 24.5 për qind, të ardhurat e realizuara në vitin 2014, jo vetëm që janë më të lartat në 10 vitet e fundit, por evidentojnë edhe një rritje të ndjeshme.

Të ardhurat në 10 vitet e fundit paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Natyrshëm evidentohet se tejkalimi i të ardhurave është kryesisht pasojë e rritjes së ndjeshme të numrit të personave të siguruar në skemë, i cili rezulton 654,561 persona kundrejt 561,169 persona që ishte në vitin 2013. Numri mesatar vjetor i kontribuesve ndaj një viti më parë është rritur me mbi 17 për qind ose 93,392 persona më shumë.

Tabela 21: Numri i personave të siguruar në skemë


Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014
Sipas Subjekteve	505,229	518,808	501,511	510,747	608,517
Buxhetore	132,885	139,177	138,232	138,01	138,651
Jobuxhetore	22,239	21,987	20,929	20,029	20,549
Firma Private	170,121	182,358	188,632	201,27	226,888
Të Vetëpunësuar	65,26	78,998	79,357	80,05	86,167
Të Vetëpunësuar në Bujqësi	106,054	87,795	66,62	64,674	127,728
Të siguruar vullnetarisht	8,670	8,493	7,741	7,114	8,534
Nga shteti	29,825	27,669	33,394	36,928	32,789

**Me përfitim afatshkurtër
Kontribues në total**

**12,91 15,669 14,816 13,494 13,255
547,964 562,146 549,72 561,169 654,561**

Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Si rezultat i rritjes së numrit fizik të kontribuesve, në vitin 2014 evidentohet një përmirësim i ndjeshëm i Normës së Varësisë së Sistemit, e cila shpreh raportin midis përfituesve dhe kontribuesve. Në vitin 2013 ky raport ishte 1.02 përfitues për 1 kontribues, në vitin 2014 Norma e Varësisë rezulton 0.89 përfitues për 1 kontribues, siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Për vitin 2014, është realizuar tërheqja e plotë e transfertës shtetërore për fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme e suplementare, e rakorduar dhe shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në shumën prej 46,419 milionë lekë, si dhe transfertat për financimin e shpërblimit të fundvitit në shumën 1,296 milionë lekë, gjithsej 47,715 milionë lekë.

Në drejtim të shërbimeve dhe informatizimit të sistemit

- Gjatë vitit 2014 nga sistemi i sigurimeve shoqërore u trajtuan me pagesa përfitimi rreth 585 mijë përfitime të të gjitha llojeve e kategorive, si dhe përfitimet për sëmundje, barrë lindje për rreth 13 mijë përfitues. Gjithashtu ISSH vazhdoi të administrojë skemën e pensioneve të posaçme, skemën e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skemën e sigurimeve suplementare të ushtarakëve, pilotëve, ushtarakëve të nëndetësëve, policisë së shtetit, skemën e trajtimeve financiare të veçanta për minatorët e punonjësit e industrisë ushtarake, skemën e trajtimeve të veçanta për familjet e dëshmorëve me mbi 31 mijë përfitues, si dhe pagesat për rimbursimin e shpenzimeve të funeraleve.
- Në vitin 2014, ISSH transferoi në buxhetet familjare rreth 99.6 miliardë lekë ose 6.3 për qind me shumë se një vit më parë. Duke shtuar edhe efektet financiare të shpërblimit të fundvitit në vlerë absolute, në vitin 2014 ndaj një viti më parë transfertat për buxhetet familjare është rritur me rreth 7.3 miliardë lekë ose rreth 7.8 për qind më shumë. Për të realizuar këto

transferta dhe për mbulimin e tyre me fonde, organet e sigurimeve shoqërore drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjentëve kontaktojnë çdo muaj me mbi 1.3 milionë njerëz. Shpenzimet e sistemit të sigurimeve shoqërore në 10 vitet e fundit paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Është punuar intensivisht dhe përfunduar procesi i krijimit të databazës së përfitimeve dhe të sistemit të informatizuar të pagesave e pensioneve. Gjatë vitit 2014 u futën në sistem 100 për qind e përfitimeve që paguhen në qytete dhe po vazhdohet intensivisht për përfundimin e tij edhe për pagesat në fshatra.
- Ka vazhduar puna për përqendrimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë në arkivën e përqendruar dhe për digjitalizimin e dokumentacionit arkivor të periudhave të sigurimit. Gjatë vitit 2014, ka vazhduar puna për digjitalizimin e të dhënave arkivore me programin e ri, pra përmes procesit certifikim-skanim-digjitalizim-konsolidim i bazës së të dhënave ku është filluar me dokumentacionin e Drejtorisë Rajonale Tiranë. Ka përfunduar procesi i krijimit të bazës së të dhënave të vjetërsisë në punë për ish-kooperativat bujqësore në 9 Drejtori Rajonale. Edhe në 3 rajonet e mbetura pothuaj është përfunduar hedhja e parë dhe po punohet, për marrjen në dorëzim të regjistrave të subjekteve shtetërore para vitit 1994, në Drejtorinë e Arkivit të Përgjithshëm, për certifikimin e tyre, hedhjen e të dhënave dhe së fundmi për kontrollin dhe komentimin e të dhënave individuale.
- Ka përfunduar baza teknike për sistemin e integruar të administrimit të kontributeve, ndërfaqësimi i këtyre sistemeve me programin e administrimit të derdhjes së kontributeve me zyrën e tatim-taksave.
- Janë përfunduar marrëveshja në fushën e sigurimeve shoqërore me Belgjikën, janë përgatitur e diskutuar materialet përfundimtare me Kanadanë, etj., si dhe për marrëveshje bilaterale dhe në fushën e bashkëpunimit teknik, me një sërë vendesh të tjera si: Rumania, Hungaria, Maqedonia, Çekia, Luksenburg, etj. Gjithashtu kanë filluar bisedimet për marrëveshjet me Gjermaninë dhe Austrinë, si dhe jemi në hapat fillestare të punës për marrëveshjen me Italinë.

Shpenzimet dhe rezultati financiar

Janë respektuar çdo muaj limitet e programuar të fondeve për shpenzimet e administrimit, si edhe për transferta në buxhetet familjare e shpenzime të tjera. Në përfundim, shpenzimet për sistemin e sigurimeve shoqërore u mbyllën në masën 99.95 për qind ose nga 101,548 milionë lekë të programuara, u realizuan 101,498 milionë lekë.

Shpenzimet për sigurimet shoqërore sipas programeve paraqiten në tabelën më poshtë :

Tabela 22: Shpenzimet për sigurimet shoqërore sipas programeve

N. R	Emërtimi	Në milion lekë		Në përqind
		Plan	Fakt	
1	Shpenzime për sigurimin shoqëror të detyrueshëm	85,220.94	85,295.78	100,09
2	Shpenzime për programe të veçanta të shtetit	9,602.31	9,632.79	100,32
3	Shpenzime për Sigurime Suplementare	4,782.74	4,707.28	98,42
4	Shpenzime për administrimin	1,942	1,862,3	95,9
Totali i Shpenzimeve		101,548	101,498.15	99,95

Burimi: Ministria e Financave (2015);

- Duke shtuar edhe shpenzimet nga programi i shpërblimit të pensionistëve për fundvitin, në vitin 2014 shpenzimet faktike rezultojnë 102,794 milionë lekë, kundrejt 102,844 milionë lekë të programuara ose u realizuan 99.95 për qind.
- Në mënyrë të veçantë është bërë kujdes për respektimin e treguesve të programuar për shpenzimet administrative korrente apo edhe për investime, ku programi u realizua në masën 95.9 për qind. Nga 1,942 milionë lekë të programuara, janë shpenzuar 1,862.3 milionë lekë, ku kostoja e administrimit të sistemit zuri 1.85 për qind të shpenzimeve, nga të cilat deri në 5 për qind të shpenzimeve që parashikohet si kufi nga ligji i sigurimeve shoqërore.
- Puna e bërë, tejkalmi i ndjeshëm i të ardhurave, mbajtja në kufijtë e programuar të shpenzimeve dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit për buxhetin e ISSH kanë sjellë si pasojë që viti 2014, si vit parapërgatitor i fillimit të zbatimit të reformës së pensioneve, të mbyllet me një rezultat shumë pozitiv, pra tejkalm të të hyrave me shpenzimet në masën 6,641 milionë lekë. Ky fakt drejtpërdrejt reflekton të gjithë mundësitë për plotësimin e normativës së Fondit Rezervë të Sigurimeve Shoqërore, si dhe për një reduktim të deficitit vjetor të sistemit.

Rezultati financiar i vitit paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela 23: Rezultati financiar buxhetor

N.R	Emërtimi	Në milion lekë		Në përqindje
		Plan	Fakt	
I	Të hyrat në Fondin e Sigurimeve Shoqërore	102,844	109,434.81	106.41
	Kontribute dhe të ardhura të tjera	55,129	61,719.81	112.0
	Financime nga buxheti për sistemin e sigurimeve	46,419	49,419	100.0
	Financime nga buxheti për shpërblimin e pensionistëve	1,296	1,296	100.0
II	Shpenzimet	102,844	102,794,15	99.95
	Transferta në buxhetet familjare	99,606	99,635.85	100.03

Shpenzime administrimi	1,942	1,862,3	95.90
Shpërblimi i pensionistëve	1,296	1,296	100.00
III Rezultati	0	6,640.67	

Burimi: Ministria e Financave (2015);

4.5 Buxheti i Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor

Objektivat kryesore të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor për vitin buxhetore 2014 ishin:

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore).
- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare të skemës, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve.
- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave.
- Realizimi i marrëdhënieve kontraktuale korrekte midis FSDKSH dhe ofruesve të shërbimit shëndetësor në funksion të përmirësimit të shërbimit.
- Hartimi i paketave të para të shërbimeve spitalore që financohen tërësisht nga Fondi në spitalet publike e private, me qëllim mbulimin e nevojave të popullatës.
- Intensifikimi i punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore, në kujdesin shëndetësor, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore nga Fondi.
- Përgatitja e kushteve për financimin e shërbimit të kontrollit bazë mjekësor bazë, të shtetasve të moshës 40-65 vjeç

Gjate vitit 2014 u shënuan këto arritje:

- U përdorën me efektivitet burimet e skemës, duke bërë të mundur financimin, sipas programeve dhe duke forcuar kontrollin e shpenzimeve.
- U bë zgjerimi i listës së barnave me 56 barna, pa rritur shpenzimet e rimbursimit, nëpërmjet përjashtimit nga TVSH të barnave, si dhe nëpërmjet administrimit të barnave të shtrenjta në farmacitë e spitaleve rajonale, duke mënjeluar marzhin e farmacisë.
- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 2.4.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 40-65 vjeç” u iniciua një program kombëtar që synon depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet prevalente me qëllim kujdesin për shëndetin, parandalimin e sëmundjeve dhe komplikacioneve, zbulimin e hershëm të çrregullimeve, mjekimin në fazat e hershme dhe përmirësimin e kulturës shëndetësore.
- U realizua trajnimi i personelit të qendrave shëndetësore të shërbimit parësor për kryerjen e procesit të kontrollit bazë për popullatën e grupmoshave 40-65 vjeç, si dhe u financua fushata publicitare, për ndërgjegjësimin e popullatës, lidhur me rëndësinë e kryerjes së këtij procesi.
- U financuan qendrat shëndetësore për sigurimin e medikamenteve bazë që duhet të kenë qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë periudhës së dimrit.
- U punua intensivisht në grupe pune me pjesëmarrës nga Fondi, Ministria e Shëndetësisë, QSUT e institucione të tjera, për miratimin e dhjetë paketave të shërbimeve spitalore që përfshijnë shërbimin e dializës, të kardiologjisë e kardiokirurgjisë, transplantin e veshkës,

implantin koklear, si dhe u arrit miratimi i këtyre paketave me VKM nr.308, datë 21.5.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”.

- U arrit financimi i paketave spitalore në spitalet jopublike, me mbulim 100 për qind nga FSDKSH.

Më poshtë paraqitet situata financiare e FSDKSH për vitin 2014, duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet.

I. Të Ardhurat

Për vitin 2014, të ardhurat në total janë realizuar 32 494 595 mijë lekë ose 98.73 për qind e shumës së programuar, me një mosrealizim prej 1.36 për qind të programit ose në shumën 449 207 mijë lekë. Realizimi sipas zërave është:

Tabela 24: Të ardhurat

Nr	Të Ardhurat	Viti 2014		Realizimi në përqindje	Pesha specifike në përqindje ndaj totalit
		Programimi	Realizimi		
1.	Kontributet e sigurimit shëndetësor Totali	8,202,000	8,008,133	97.64	24.7
A	- Nga DPT në BSH	8,107,000	7,925,000	97.76	
B	- Nga ISSH (fermerët)	95,000	83,133	88	
2.	Transferta e buxhetit të shtetit:	24,590,800	24,351,412	98.89	74.9
A	- Për shërbimin parësor	8,575,000	8,575,000	100	26.5
B	- Për shërbimin spitalor	16,015,800	15,776,412	98.26	48.5
3.	Të ardhura të tjera	117,000	135,050	115.43	0.4
	Totali të Ardhurat (1+2+3)	32,909,800	32,494,595	98.73	100

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Transfertat e buxhetit shtetit përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave me 74.9 për qind të totalit. Kontributet e sigurimit shëndetësor përbëjnë 24.7 për qind të totalit ndërsa të ardhurat nga burime të tjera përbëjnë 0.4 për qind të totalit të të ardhurave.

Realizimi i të ardhurave sipas burimeve paraqitet si më poshtë:

a. Të ardhurat nga kontributi i sigurimeve shëndetësore.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore janë realizuar 97.64 përqind e programimit ose në shumën prej 8,008,133 mijë lekë, nga të cilat:

- 7,925,000 mijë lekë nga kontributet të mbledhura nga organet tatimore e të transferuara në llogaritë e FSDKSH, ose 97.76 përqind e programimit. Ne fakt gjatë vitit 2014 nga organet tatimore janë mbledhur kontribute të sigurimeve shëndetësore në vlerën **7,782,559** mijë lekë, vlerë kjo e konfirmuar nga sistemi i thesarit. Diferenca prej **142,441** mijë lekë, përbën shumën të kontributeve të sigurimeve shëndetësore të mbledhura nga organet tatimore një vit më parë e të transferuara në llogaritë e Fondit gjatë vitit 2014.
- 83,133 mijë lekë janë transferuar nga ISSH si kontribut i fermerëve. Nga kjo shumë 24 milionë lekë janë të raportuara në sistem si klasë 4 (të mbledhura një vit më parë e të transferuara (të hyra) në llogaritë e FSDKSH gjatë vitit 2014). Shuma prej 83,133 milionë lekë e transferuar, përbën 88 përqind e programimit.

Maksimizimi i arkëtimit të kontributeve të sigurimeve shëndetësore të mbledhura nga Organet Tatimore është arritur si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me këtë administratë dhe mbikëqyrjes së procesit nga drejtoritë rajonale.

Gjithashtu edhe drejtoritë rajonale për maksimizimin e arkëtimit të kontributeve të mbledhur nga fermerët për çdo muaj kanë bashkëpunuar me organet e Sigurimeve Shoqërore të rajonit tyre për shumën e kontributeve të mbledhura, të arkëtuara dhe detyrimin e mbetur.

b. Transferta nga buxheti i shtetit

Për vitin 2014, transfertat e buxhetit të shtetit për shërbimin parësor është realizuar në masën 100 për qind të programimit, në vlerën 8,575,000 mijë lekë.

Në shumën buxhetore të programuar për shërbimin spitalor është përfshirë transfertat për financimin e spitaleve rajonale dhe bashkiake, transfertat për financimin e paketave shëndetësore spitalore në zbatim të VKM nr. 308, datë 21.05.2014 dhe transfertat për mbulimin e shpenzimeve për trajtimet e veçanta spitalore rast pas rasti sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Për periudhën 12-mujore 2014, transfertat nëpërmjet thesarit për financimin e spitaleve rajonale dhe bashkiake janë bërë në shumën 15,932,500 mijë lekë.

FSDKSH ka tërhequr në masën e plotë shumën prej 33,300 mijë lekë të programuar për financimin e paketave shëndetësore spitalore në zbatim të VKM nr.308, datë 21.05.2014.

Në fund të vitit 2014 rezulton se FSDKSH ka tërhequr nga thesari shumën 42 200 mijë lekë ose 84.4 për qind të programimit për mbulimin e shpenzimeve për trajtimet e veçanta spitalore rast pas rasti sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

c. Të ardhurat e tjera

Gjatë vitit 2014, janë arkëtuar të ardhura të tjera në shumën prej 135,050 mijë lekë ose 115.43 për qind e programit. Në këtë zë të ardhurash janë përfshirë të ardhurat nga sigurimi vullnetar, nga zhdëmtimet, nga shitja e librezave të shëndetit, nga bashkë-pagesat, nga dhënia me qiraja e ndërtesës, bashkë-pagesat, interesat e depozitave. Realizimi i të ardhurave të tjera për çdo zë përbërës paraqitet si më poshtë:

- Nga bashkë-pagesat janë arkëtuar 60,868 mijë lekë, e cila përbën 45 për qind të shumës të ardhurave të tjera.
- Nga zhdëmtimet 51,642 mijë lekë ose 38.2 për qind të shumës të ardhurave të tjera.
- Nga sigurimi vullnetar 5,375 mijë lekë ose 4 për qind të shumës të ardhurave të tjera.
- Pjesa tjetër është arkëtuar nga zëra të tjerë, si shitja e librezave të shëndetit, nga depozitat, nga qiraja, kamatvonesat, etj.

II. Shpenzimet

Për vitin 2014, shpenzimet janë realizuar në shumën 32,225,046 mijë lekë ose 97.9 për qind e programit, me diferencë kundrejt planit prej 684,754 mijë lekë.

Në fund të vitit 2014, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me programin vjetor, paraqitet si më poshtë:

Tabela 25: Shpenzimet

Në mijë lekë

Shpenzimet	Programimi	Fakti	Realizim i në përqindje	Peshë specifike në përqindje ndaj totalit
Shpenzime për rimbursimin e barnave (likuidimi)	8,340,000	8,251,406	98.94	25.6
Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor	6,985,000	6,686,504	95.73	20.8
Shpenzime administrative	724,000	702,646	97.05	2.2
Shpenzime për Investime	126,500	106,730	84.37	0.3
Shpenzime për Spitalin Rajonal Durrës	718,500	718,500	100.00	2.2
Shpenzime për shërbimin spitalor (nëpërmjet thesarit)	16,015,800	15,759,260	98.29	48.9
Totali i Shpenzimeve	32,909,800	32,225,046	97.90	100.0

Burimi: Ministria e Financave (2015);

a. Shpenzimet e Rimbursimit të barnave

Për periudhën 12-mujore të vitit 2014, janë paguar listëtregues në vlerën 8,251,406 mijë lekë nga 8,340,000 mijë lekë të programuara ose janë realizuar 98.9 për qind e programimit. Kundrejt planit, shpenzimet e rimbursimit janë realizuar më pak në shumën – 88,594 mijë lekë.

Në uljen e shpenzimeve të rimbursimit të barnave, veç punës për mirëmenaxhimin e situatës, kanë ndikuar heqja e TVSH për barnat nga muaji prill 2014, si dhe zbatimi i Urdhrit të Ministrit Shëndetësisë nr. 320, datë 29.07.2014 për tregtimin e disa barnave të listës të rimbursueshme nëpërmjet farmacive spitalore, gjë e cila ndikoi në përjashtimin e marzhit të fitimit të farmacive të rrjetit të hapur, duke dhënë impakt financiar nga muaji shtator.

b. Shpenzimet për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor

Për vitin 2014, qendrat shëndetësore janë financuar në vlerën 6,686,504 mijë lekë ose në masën 95.7 për qind të programimit. Qendrat shëndetësore për këtë vit janë financuar me – 298,496 mijë lekë më pak nga programimi, pasi prej tyre nuk janë realizuar treguesit e aktivitetit dhe bonusit.

Financimi i QSH sipas zërave paraqitet:

- Për buxhetin fiks, të gjitha QSH janë financuar në masën 99 për qind ose në shumën 5,572,483 mijë lekë. Diferenca prej 1 për qind kundrej programimit është efekti i mbajtjes së pjesës mbi 2 për qind të rezultatit financiar për disa qendra shëndetësore.
- Buxheti për aktivitetet, është financuar në masën 97.4 për qind e programimit ose në shumën prej 664,834 mijë lekë. Për vitin 2014 qendrat shëndetësore janë financuar më pak me 2.6 për qind të programimit, pasi financimi i tyre është bërë në varësi të realizimit të treguesit të performancës nga vetë qendrat shëndetësore. Kjo do të thotë që për vitin 2014 treguesi i performancës që është numri i vizitave të planifikuara është realizuar mesatarisht në masën 97.4 për qind, aq sa është bërë financimi i tyre.
- Për bonusin, qendrat shëndetësore janë financuar në masën 65.8 për qind e programimit ose në shumën 449,187 mijë lekë. Krahasuar me programimin qendrat shëndetësore janë financuar më pak me 34.2 për qind, pasi financimi i tyre është bërë në varësi të realizimit të treguesit të bonusit nga vetë qendrat shëndetësore. Kjo do të thotë që për vitin 2014 të gjithë treguesit e bonusit janë realizuar mesatarisht në masën 65.8 për qind, aq sa është bërë financimi i tyre.

Qendrat shëndetësore, buxhetin e financuar e kanë përdorur për të mbuluar shpenzimet e pagave, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për blerjen e barnave të paketës së urgjencës dhe të mallrave e shërbime që ndihmojnë në aktivitetin e tyre për dhënien e shërbimit shëndetësor parësor.

Gjithashtu, qendrat shëndetësore janë financuar edhe për trajnimin e personelit të tyre në kryerjen e procesit të kontrollit bazë për popullatën e grupmoshave 40-65 vjeç, në zbatim të VKM nr. 185, datë 02.04.2014.

c. Shpenzimet Administrative

Për vitin 2014 shpenzimet administrative të FSDKSH janë realizuar në masën 97 për qind, me një kursim prej 3 për qind të programimit. Shpenzimet administrative në total janë realizuar në shumën 702,646 mijë lekë, nga të cilat: 483,255 mijë lekë për pagat, 2,320 mijë lekë për fond të veçantë, 77,698 mijë lekë për kontribute të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore të punonjësve dhe 139,373 mijë lekë për blerje mallra e shërbime.

d. Shpenzimet për Investime

Gjatë vitit 2014, për investime janë shpenzuar 106,730 mijë lekë, kundrejt 126,500 mijë lekë të programuara, pra 19,770 mijë lekë më pak ose me një kursim prej 15.6 për qind e programimit. Në fund të vitit 2014, shpenzimet për investime janë realizuar sipas zërave përkatës të planifikuar, konkretisht: për ndërtim-montime në shumën 2,777 mijë lekë, për pajisje orendi në shumën 4,307 mijë lekë, për software në shumën 88,853 mijë lekë dhe për autovetura në shumën 10,793 mijë lekë.

e. Shpenzimet për Spitalin Rajonal Durrës

Për vitin buxhetor 2014, Spitali Rajonal Durrës është financuar për 718,500 mijë lekë, aq sa ka qenë programimi. Shpenzimet janë realizuar në shumën 672,134 mijë lekë ose 94 për qind e shumës së financuar.

Spitali Rajonal Durrës ka respektuar planin e buxhetit edhe sipas zërave kryesorë, për: paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore dhe mallra e shërbime, realizimi i të cilave ka qenë:

- për paga në shumën 394,853 mijë lekë ose 97 për qind e programimit,
- për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore në shumën 66,400 mijë lekë ose 98 për qind e programimit,
- për mallra e shërbime në shumën 210,882 mijë lekë ose 87 për qind e programimit.

f. Shpenzimet për Shërbimin Spitalor nëpërmjet Thesarit

Buxheti i programuar për shërbimin spitalor nga ana e Fondit është përdorur në 3 drejtimet e planifikuara, konkretisht për:

- Financimin e spitaleve rajonale dhe bashkiake.
- Mbulimin e shpenzimeve për trajtime të veçanta spitalore për pacientë të ndryshëm, të miratuara rast pas rasti me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Mbulimin e shpenzimeve për paketat e shërbimeve spitalore të ofruara nga institucione private shëndetësore.

Në fund të vitit 2014, situata financiare në lidhje me realizimin e shpenzimeve krahasuar me programimin vjetor, paraqitet si më poshtë:

Tabela 26: Shpenzimet e shërbimit spitalor

Në mijë lekë

Shpenzimet e Shërbimit Spitalor	Programimi	Fakti	Realizimi në përqindje
1. Shpenzimet nga spitalet rajonale dhe bashkiake, totali	15,932,500	15,704,412	98.57%
- Për paga	6,970,023	6,852,810	98.32%
- Për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,142,365	1,134,351	99.30%
- Për mallra e shërbime	7,820,112	7,717,251	98.68%
2. FSDKSH për trajtime të veçanta spitalore	50,000	35,622	71.24%
3. FSDKSH për paketat e shërbimeve spitalore të ofruara nga institucionet private	33,300	19,226	57.74%
Totali i Shpenzimeve	16,015,800	15,759,260	98.40%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Për vitin 2014, spitalet rajonale dhe bashkiake janë financuar nëpërmjet thesarit për shumën e plotë të programuar. Nga ana e tyre janë shpenzuar 15,704,412 mijë lekë ose 98.57 për qind të fondeve të çelura pranë degëve të thesarit në rrethe.

Vihet re se nga spitalet rajonale dhe bashkiake është respektuar plani i shpenzimeve sipas zërave të financimit. FSDKSH, ka përdorur shumën 50,000 mijë lekë të programuar për mbulimin e trajtimeve të veçanta spitalore vetëm për rastet e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Bazuar në këto vendime, në muajt nëntor e dhjetor, nga ana e FSDKSH u tërhoqën në llogaritë bankare 42,200 mijë lekë, nga të cilat u shpenzuan 35,622 mijë lekë, për arsye të mosplotësimit të dokumentacionit nga ana e pacientëve apo mosparaqitjes së tyre.

Shpenzimet për trajtime të veçanta spitalore janë realizuar 71.2 për qind e programimit. Në këtë realizim kanë ndikuar numri i rasteve miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe sa prej atyre të miratura kanë paraqitur dokumentacionin e plotë justifikues të shpenzimeve të kryera.

Krahasuar me programimin vjetor, shpenzimet për paketat e shërbimeve spitalore janë realizuar 57.74 për qind. Nga ana e FSDKSH është tërhequr në llogaritë bankare e gjithë shuma e programuar për përballimin e shpenzimeve të paketave të shërbimeve spitalore të ofruara nga institucione private shëndetësore. Në fund të vitit 2014, për këtë qëllim, nga 33,300 mijë lekë janë shpenzuar vetëm 19,226 mijë lekë, kjo sipas dokumentacionit të paraqitur dhe të pranuar nga institucionet private shëndetësore të kontraktuara. Këto shpenzime janë realizuar kryesisht gjatë muajit dhjetor 2014.

g. Gjendja e likuiditeteve

Në datën 31.12.2014, gjendja e likuiditeteve ka qenë 4,210,435 mijë lekë, nga të cilat:

- Në bankat e nivelit të dytë 383,050 mijë lekë.
- Bono thesari 1 593 512 mijë lekë.
- Fond rezervë në bankën e Shqipërisë 1,697,468 mijë lekë.
- Llogari e unifikuar e thesarit në BSH (llogaria speciale e kontributeve, TSA) 536,405 mijë lekë.

Aktualisht janë të investuara në bono thesari mjete monetare në shumën prej 1,593 milionë lekë, me maturim 1-vjeçar, deri në datën 31.05.2015.

Në fund të vitit 2014 gjendja e likuidimeve në llogaritë bankare është shtuar me shumën + 269,220 mijë lekë, krahasuar me fillimin e vitit.

Diferenca midis të hyrave në mjete monetare dhe shpenzimeve të kryera gjatë vitit 2014 është në bilanc pozitiv ku të hyrat më shumë, janë 273,048 mijë lekë.

V. ANEKS: MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE PUBLIKE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS

5.1 MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

MISIONI

Përgatitja dhe aplikimi i politikave të qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë dhe sipërmarrjes, për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik. Ajo harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët prioritarë të ekonomisë, konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës dhe shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Kjo ministri, për vitin 2014, ka administruar fondet buxhetore për 3 programe:

- Planifikim, menaxhim, administrim;
- Mbështetje për Zhvillim Ekonomik;
- Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturë e Cilësi dhe Pronësi Industriale

Realizimi i Buxhetit 2014

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga MZHETTS-ja mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri në fund të vitit 2014, sipas zërave të shpenzimeve, paraqitet si më poshtë:

<i>Në mijë lekë</i>				
NR.	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Shpenzime personeli	446 848	420 175	94
2	Shpenzime të tjera korrente	400 263	353 452	88
3	Shpenzime kapitale	685 853	606 338	88
	3.1 Me financim të brendshëm	168 853	150 526	89
	3.2 Me financim të huaj	517 000	455 812	88
	SHUMA	1 532 964	1 379 965	90
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		16 775	
	TOTALI	1 532 964	1 396 740	91

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Ndërsa sipas programeve, realizimi i treguesve në total paraqitet si më poshtë:

<i>Në mijë lekë</i>				
NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim menaxhimi	371 789	347 845	93.5
2	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	881 192	765 806	87
3	Mbësht. për Mbikëq. e tregut Infrastr. e Cilës. dhe Pronësi Industriale	279 984	266 314	95
	TOTALI	1 532 965	1 379 965	90

	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		16 775	
GJITHSEJ		1 532 965	1 396 740	91

Burimi: Ministria e Financave

Realizimi i fondeve në total për çdo program në veçanti për shpenzimet korente dhe kapitale paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014		Fakti 2014		Në mijë lekë Përqindja e realizimit	
		Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime
1	Planifikim Menaxhimi	335 914	35 875	312 613	35 232	93	98
2	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	269 964	611 228	226 518	539 288	84	88
3	Mbësht. për Mbikëq. e tregut Infrastr. e Cilës. dhe Pronësi Industriale	241 234	38 750	234 497	31 817	97	82
	Totali	847 112	685 853	773 628	606 337	91	88
	Të ardhura jashtë limitit			16 775			
	Gjithsej			790 403			

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Plani i buxhetit i vitit 2014 në total për ministrinë është realizuar në rreth 91 për qind, nga i cili shpenzimet korente janë realizuar në rreth 91 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale në 88 për qind.

Investimet kapitale me financim nga buxheti i shtetit për vitin 2014 janë realizuar në rreth 89 për qind të planit vjetor ose rreth 18.3 milionë lekë më pak se sa plani.

Investimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në rreth 88 për qind të planit të buxhetit ose rreth 61.1 milionë lekë më pak se sa plani.

Arritjet, Problematikat

Nisur nga misioni i MZHETTS politikat buxhetore kanë synuar mbështetjen e reformave të ndërmarra në zhvillimin ekonomik të vendit për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, përputhjen e Financimeve Buxhetore me politikat ekonomike të zhvillimit dhe projekteve, me Strategjitë Sektoriale dhe Ndërsektoriale për fushat e tregtisë dhe të sipërmarrjes, mbështetur në përdorimin me efektivitet të fondeve, në funksion të garantimit të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, rritjes së profesionalizimit dhe të transparencës.

Disa nga treguesit e arritur nga financimi i projekteve për vitin 2014 janë:

- Reforma “Doing Business”, ka bërë që të përmirësohet renditja me 40 vende në Raportin “Të bësh biznes 2015”.
- Paketa mbështetëse për sektorin e Industrisë fason, ka sjellë këto impakte pozitive:
 - Rritje e eksportit me 26.1 për qind krahasuar me një vit më parë;
 - Rritje e punësimit të industrisë fason me mbi 5000 vende të reja;
 - Rritje e numrit të subjekteve të industrisë fason me 3.8 për qind krahasuar me vitin 2013;
 - Sporteli aktiv “One-Stop-Shop” për industrinë e fasonëve pranë AIDA.
- Mbështetja financiare për bizneset nëpërmjet:

- Fondit për ekonominë kreative;
- Fondit të konkurrueshmërisë;
- Fondit të inovacionit.

Gjatë vitit 2014, janë trajtuar dhe zgjidhur problematikat që lidhen me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, për të cilat u akordua fondi prej 144,051,217 lekë, për shpenzime korente, për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë kryer pagesa për punonjësit e dalë në listë pritje si pasojë e ristrukturimit. Kështu numri i punonjësve të paguar në listë pritje për vitin 2014 është 12 punonjës dhe fondi përkatës është 10 milionë lekë.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi: Mbështetje për zhvillim ekonomik

Misioni i këtij programi është hartimi dhe zbatimi i politikave ekonomike për mbrojtjen e biznesit vendas, ndjekja dhe monitorimi i të gjitha detyrimeve në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare me organizatat ku Shqipëria aderon, vlerësimi dhe monitorimi i investimeve të huaja në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Promovimi i vendit dhe identifikimi i mundësisë për investimet e huaja direkte në Shqipëri, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Ofrimi i shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të operatorëve ekonomikë që veprojnë në territorin e RSH-së.

Në këtë program, si edhe më parë, përfshihen 4 institucione: AIDA, ATRAKO, QKR dhe QKL. Për këtë program shpenzimet e buxhetit në total janë realizuar në masën 57 për qind nga ku shpenzimet korente 76 për qind, ndërsa shpenzimet për investime janë realizuar 48.97 për qind. Vërejmë një realizim prej 56 për qind në shpenzimet për “Mallra e Shërbime”, që lidhet me mosrealizimin e procedurave të prokurimit.

Nga monitorimi dhe vlerësimi i produkteve për këtë program vërejmë:

AIDA ka realizuar projektin “EXPO MILANO 2015” për shumën 17.3 milionë lekë nga 21.6 milionë lekë të planifikuara. Nuk është realizuar fondi i konkurrueshmërisë në masën e planifikuar për vitin. Kështu nga 20 SME të planifikuara për t’u financuar, janë miratuar 18 aplikime.

ATRAKO ka realizuar produktin “Koncesione të vlerësuara” në numër 3 nga 5 të planifikuara.

QKL ka realizuar produktet si aplikime për leje, licenca dhe shërbime të ndryshme, ku nga 3,500 leje e licenca të planifikuara janë realizuar 7,359 aplikime, licenca e leje.

Për QKR -në rezulton se është tejkaluar numri i bizneseve të planifikuara për t’u regjistruar. Janë regjistruar nga QKR-ja 16731 biznese nga 12 800 të planifikuara për vitin 2014. Gjithashtu edhe objekti “Krijimi i moduleve të reja” për aplikimet on-line nga QKR-ja janë realizuar 8 module nga 30 të planifikuara.

Projekti me financim të huaj “Programi Italo-shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe Sigurimin e Asistencës Teknike për to” nga 510 milionë lekë të planifikuara për vitin 2014 është realizuar në shumën e 414 milionë lekëve. Kompanitë e financuara operojnë në sektorët e prodhimit, agro-përpunimit, ndërtimit, përpunimit të drurit, këpucëve, teknologjisë së informacionit, etj.

Programi: Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturë e Cilësisë dhe Pronësi Industriale

Ky program përfaqëson fushat e përgjegjësisë shtetërore në ofrimin e shërbimit të akreditimit për organizmat e vlerësimit të konformitetit, përshtatjes së standardeve europiane dhe ndërkombëtare dhe ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit për përfitimet nga zbatimi i standardeve teknike në produkte dhe shërbimet e tyre; zhvillimi dhe mirëmbajtja e etaloneve kombëtarë të njësive të matjes, kalibrimi dhe verifikimi i mjeteve matëse, realizimi i inspektimit metrologjik, regjistrimi i objekteve në pronësi industriale si: patenta e shpikje, marka, dizenjo dhe tregues gjeografik; mbrojtja e pronësisë industriale.

Në këtë program përfshihen 4 institucione: DPA, DPPM, DPS dhe DPM.

Për këtë program plani i shpenzimeve buxhetore në Total është realizuar 96.2 për qind.

Ndërsa nga monitorimi dhe vlerësimi i produkteve për këtë program vërejmë:

- Produkti “Adaptimi i standardeve CEN/CENELEC”, është realizuar nga ana sasiore mbi parashikimin e periudhës, pra si numër 1,889 nga 1,100 i planifikuar.
- Produkti “Standarde të shfuqizuara CEN/CNL”, nga ana sasiore është tejkaluar si numër. Kështu nga 250 të parashikuara janë shfuqizuar 1,492 standarde, që lidhen edhe me procedurat e ndjekura nga organizatat ndërkombëtare.
- Produkti “Adoptimi i Standardeve IEC/ISO”, është realizuar në numër 381 nga 450 të parashikuara.
- Produkti “Standardet e shitura” është realizuar mbi parashikimin e periudhës, si numër 2,119 nga 2,060 të planifikuar.
- Produkti “Aplikime kombëtare për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale DPPM”, është realizuar mbi parashikimin e periudhës, pra si numër 4,216 nga 1,150 të planifikuara.
- Produkti “Kryerja e verifikimeve të instrumenteve matës në përdorim”, është realizuar në masën e planifikuar, pra është realizuar 41000.
- Produkti “Kryerja e inspektimeve për subjektet që përdorin ins.matës”, është realizuar mbi parashikimin, në masën 5586 nga 5000 të planifikuara.

Programi: Planifikim, menaxhim, administrim

Për këtë program monitorimi, vlerësimi i produkteve paraqitet si më poshtë:

- Në përputhje me programin e Qeverisë për forcimin e kapaciteteve në Administratën Publike, si një produkt i rëndësishëm i këtij programi është trajnimi i stafit të Aparatit të Ministrisë dhe institucioneve të sistemit të MZHETS mbi bazën e një programi pune të përcaktuar lidhur me: çështje të Integritetit Evropian”, ligjin e ri “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, Rregullat e Etikës në Administratën Publike, konflikti i interesit, si dhe tema specifike që kanë të bëjnë me rritjen e konkurrueshmërisë të SME dhe monitorimin e investimeve publike. Ky produkt është realizuar plotësisht.
- Produkti “Raporte financiare, buxhetore dhe statistikore”, është realizuar plotësisht.
- Produkti “Raporte Auditimi” është realizuar në numër 23 nga 18 të planifikuara. Nga raportet e Auditimit të realizuara 18 janë të plota, 5 janë në proces evadimi dhe miratimi.
- Produkti “Akte ligjore të përgatitura” është realizuar në numër 55 nga 24 të planifikuara, pra janë miratuar VKM mbi sasinë e planifikuar.

- Produkti “Marrëveshje, dokumente të marrëdhënieve me jashtë” është realizuar në numër 10 nga 15 të planifikuara.

5.2 MINISTERIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

MISIONI

Misioni i Ministrisë është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave. Elementët bazë të këtij misioni janë: Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit në fushën e bujqësisë, mbrojtja e shëndetit të kafshëve, bimëve dhe garantimi i shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej kafshëve dhe cilësia ushqimore, sigurimi i informacionit bujqësor, asistencë dhe informacion për fermerët mbështetur në skemat mbështetëse direkte të prodhimit bujqësor, politikat e resurseve peshkore, menaxhim i sistemit të ujitjes, kullimit, ujitjes dhe mbrojtja nga përmbytja e tokës.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fonde publike sipas shtatë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Buxheti vjetor 2014, i planifikuar për këto 7 programe, është realizuar në masën 97.9 për qind ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Buxheti vjetor është 6,651,275 mijë lekë dhe është realizuar 6,511,603 mijë lekë, të detajuar sipas programeve të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

				<i>Në mijë lekë</i>
NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	277.040	252.685	91,2
2	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1.836.736	1.598.051	87,0
3	Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	1.552.687	1.327.704	85,5
4	Zhvillimi rural	1.771.748	2.090.643	118,0
5	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	214.055	193.193	90,3
6	Menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore	20.060	19.623	97,8
7	Mbështetje për peshkimin	978.949	1.029.704	105,2
TOTALI		6.651.275	6.511.603	97,9

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shënim: Realizimi prej 118 për qind i programit të zhvillimit rural dhe 105.2 për qind i programit të mbështetjes për peshkimin lidhen me tejkalimin e planit të financimit të huaj.

Rreth 112 për qind e totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë vitit 2014 e zënë shpenzimet për programin “Mbështetje për peshkimin” me 105,2 për qind dhe “Zhvillimi rural” me 118 për qind ndaj totalit të faktit.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të 2014 dhe realizimit faktik për vitin 2014, jepet në tabelën e mëposhtme:

Në përqindje

NR.	Emërtimi i Programit	Struktura e shpenzimeve sipas PBA-së Viti 2014 (në %)	Struktura e shpenzimeve sipas Buxhetit Viti 2014 (në %)	Struktura e shpenzimeve faktike për 12-mujorin Viti 2014 (në %)
1	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	4,0	4,2	3,9
2	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	25,2	27,6	24,5
3	Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	28,4	23,3	20,4
4	Zhvillimi rural	35,9	26,6	32,1
5	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	3,3	3,2	3,0
6	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	0,3	0,3	0,3
7	Administrimi i ujërave	2,8	14,7	15,8
TOTALI		100,0	100,0	100,0

Burimi: Ministria e Financave (2015);

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

1. Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014 për këtë program, që përfaqëson rreth 4 për qind të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 91.1 për qind
- Shpenzimet kapitale 94 për qind
- Gjithsej 91.2 për qind

Shpenzimet e këtij programi për paga ndaj planit vjetor janë realizuar 94 për qind, sigurimet shoqërore 94 për qind, shpenzime operative 88 për qind. Ky program, kishte të planifikuar 2 objekte investimi: “Furnizim, vendosje çillera për sistemin ftohës qendror”, i cili u realizua me 98 për qind dhe “Blerje pajisje kompjuterike”, me realizim faktik 87 për qind ndaj planit.

2. Programi “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të urave e molusqeve bivale, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fito-sanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve

mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për vitin 2014 u punua për realizimin e aktiviteteve mbi masat profilaktike veterinarë e fito-sanitare, monitorimin e mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimin e ujërave e molusqeve bivalve, identifikimin e kafshëve dhe hedhjen e të dhënave në data-base, luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Produktet e përftuara për vitin 2014, parashikuar në PBA për vitin 2014, janë realizuar si më poshtë. Mbi kontrollin e situatës epizootike, ka përfunduar vaksinimi kundër sëmundjes së plasjes.

Ka përfunduar në bashkëpunim me projektin PAZA “Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike”, vaksinimi kundër sëmundjes së brucelozës në të imta që zë peshën më të madhe në masat profilaktike për vitin 2014.

- Nuk është parashikuar gjurmim brucelozë në të imta dhe këto produkte nuk pasqyrohen në buxhet.
- Është realizuar programi i monitorimit të mbetjeve dhe programi i monitorimit të molusqeve dhe ujërave të brendshme sipas programit, por nuk kanë kaluar ende shpenzimet e plota. Ka përfunduar prokurimi i reagentëve, kimikateve dhe ngjyruësve.
- Monitorimi i sëmundjeve ka përfunduar kryesisht për sëmundjen e Brucelozës, Tuberkulozit dhe “Gjuhës blu”.
- Në fushën e mbrojtjes së bimëve janë trajtuar vetëm 44,026 rrënjë kundër mizës.
- Ka përfunduar trajtimi kundër miut të arave dhe karkalecit dhe është trajtuar mbi 100 për qind e sipërfaqes së parashikuar.
- Ka përfunduar realizimi i programit të identifikimit të kafshëve, proces që vazhdon deri në identifikimin e plotë të remontit, gjedhë e të imta.
- Janë realizuar shpenzimet operative, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në buxhetin 2014 për DRB-së, ISUV dhe AKU.
- Janë realizuar sipas parashikimit, shpenzime të investimeve në zërat: TVSh dhe “Kosto lokale”, pasi kjo lidhet me zbatimin e projekteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, implementimi i të cilëve është në proces.

E veçantë për vitin 2014, ishte shfaqja dhe përhapja e sëmundjes së “Gjuhës blu” për herë të parë në Shqipëri, si rezultat i të cilës u dëmtuan dhe pastaj u dëmshpërblyen një numër i madh krerësh në të imta dhe gjedhësh.

3. Programi “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”

Ky është një nga programet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave që ofron shërbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, si një nga faktorët e rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e prodhimit bujqësor.

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014, për këtë program, që përfaqëson rreth 20.4 për qind të totalit të buxhetit faktik të kësaj ministrie, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet Korente 97.4 për qind

- Shpenzimet kapitale 69.5 për qind
- Gjithsej 85.5 për qind

Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore janë realizuar 97 për qind të fondit vjetor të planifikuar, shpenzimet operative 97.4 për qind, ndërsa investimet në masë 69.5 për qind.

Nga shqyrtimi i ecurisë së shpenzimeve dhe investimeve të aktiviteteve të produkteve të Programit “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”, për vitin 2014, rezulton sa vijon:

Shpenzimet operative:

Me rreth 892,000 mijë lekë janë financuar:

- Aktivitetet që kanë të bëjnë kryesisht me procesin e mirëmbajtjes së infrastrukturës kryesore të kullimit, ujitjes, si dhe mbajtjen në gadishmëri të 28 hidrovorëve, shoqëruar kjo me inspektimet e të gjithë infrastrukturës (diga, argjinatura, hidrovor, etj.).
- Të gjitha punimet e mirëmbajtjes në ujitje, madje është avancuar me pastrimin e kanaleve ujitës, si dhe gjatë muajit dhjetor 2014 janë realizuar punimet e mirëmbajtjes në kullim.
- Remonti i 28 hidrovorëve me përjashtim të hidrovorit të Çasit, pasi ky hidrovor është në proces rehabilitimi të plotë.

Me investimet:

- Për arsye të procesit gjyqësor u rrezikua realizimi i financimit të objektit Kaskada Vashtëmi, me vlerë prej 52 milionë lekë, financim i cili u pakësua nga plani nëpërmjet Aktit Normativ nr. 2, të dhjetorit 2014.
- Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes është realizuar në masën 51 për qind. Shkaku i mosrealizimit të investimit të planifikuar është mosrealizimi i dorëzimit të situacionit të punimeve në kohën e planifikuar. Të gjitha aktivitetet e tjera të planifikuara janë realizuar 100 për qind në kohën e përcaktuar.

4. Programi “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agro-industrinë dhe marketingun”

Në programin buxhetor të rishikuar të vitit 2014, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë blegtorisë, agro-industrisë dhe marketingut” i janë alokuar gjithsej 1,771,748 mijë lekë dhe përkatësisht:

- Shpenzime korente 1,459,410 mijë lekë
- Shpenzime kapitale 312,338 mijë lekë

Realizimi sipas produkteve:

a) Për “Ruajtjen e resurseve gjenetike në fermë”. Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për Buajt, Bagëtitë e Imta, si dhe shpenzimet për përmirësimin racor. Për vitin 2014, u alokuan fonde për buajt prej 3 milionë lekësh në tre qarqe të vendit atë të Lushnjes, Elbasanit dhe Tiranës. U plotësuan kartelat dhe certifikatat veterinare të kafshëve, si dhe u mundësua disbursimi i fondeve. Me mosrealizim u paraqitën qarqet e Elbasanit dhe Tiranës, pasi nuk përfunduan në kohë kartelat e kafshëve.

Gjithashtu, mbështetur në VKM nr. 1708, datë 29.12.2008, “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta”, shoqëruar me rregulloren përkatëse nr. 4, datë 18.08.2009, janë parashikuar 1.5 milionë lekë, për financimin e racave në rrezik zhdukje në Elbasan dhe Shkodër. Është ecur paralelisht me matrikullimin e bagëtive në këto qarqe, si dhe janë disbursuar fondet.

Është alokuar gjatë vitit 2014, një fond prej 2.8 milionë lekësh për përmirësimin racor në DRB-të e 6 qarqeve, me qëllim përmirësimin, regjistrimin dhe rritjen e cilësisë së mishit nga bagëtitë. Ky fond është realizuar në masën 78 për qind.

b) Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas në vitin 2014, është mbështetur organizimi i panairove kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër u mundësua pjesëmarrja në panairin “Green Week 2014”, Berlin, Gjermani, si dhe në panairin HORECA, organizuar në Tiranë për herë të parë.

Festivali i Verës, panairi i Agrobiznesit dhe Turizmit, si dhe panairot lokale, u realizuan si një paketë aktivitetesh në “Muajt e Bujqësisë Shqiptare”. Kjo paketë, përmbledhi një sërë aktivitetesh të organizuara sipas një kalendarit të mirë përcaktuar.

Panairot rajonale u asistuan dhe u mbështetën në organizimin e bizneseve dhe prezantimin e tyre, por pa kosto. Shpenzimet për to u mbuluan nga bashkitë përkatëse dhe donatorë të tjerë të fushës së bujqësisë. Fondi i parashikuar u realizua në masën 96 për qind.

c) “Përmirësimi i infrastrukturës rurale” nga Projekti MMP dhe SDRMA; konsiston në ndërtimin e rrugëve rurale, lerave të bagëtive, skemave ujitëse, si dhe dhënien e granteve konkurruese përmes një procedure seleksionimi. Kjo u realizua përmes disbursimit të fondeve të projektit, si dhe mbështetjes me kosto lokale e TVSh nga fondet buxhetore. Fondi është realizuar rreth 98 për qind.

ç) “Promovimi i teknologjive të reja për mbjelljen, mbledhjen dhe ruajtjen e duhanit”, përmes rritjes së sipërfaqes së kultivarëve të certifikuar, rritje e eksportit dhe e cilësisë, produkt ky i cili realizohet nga Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve. Këtë vit, është punuar në drejtim të përmirësimit të prodhimit përmes futjes së kultivarëve të mirë të farës së duhanit për monitorimin tërësor të prodhimit, grumbullim-përpunimit dhe eksportit, përmes promovimit të teknologjive të reja, demonstrimeve, testimeve, etj. Gjithashtu, është punuar dhe në drejtim të përditësimit të të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Prodhuesve të Duhanit. Janë grumbulluar mostrat dhe janë kryer degustime. Realizimi i fondit është në masën 93 për qind, pasi për zëra si: plehra kimike, materiale për mbrojtjen e tokës, etj, ka variuar çmimi i tregut. Nga AKDC, janë realizuar të ardhura në shumën rreth 8,099 mijë lekë, kryesisht nga analizat fiziko-kimike dhe degustimi cigareve, nga shitja e grurit të prodhuar në Stacionin e Duhanit Çërrik, nga licencat, etj.

d) “Rritja e sipërfaqes së mbjellë përmes skemave mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë”. Për vitin 2014, për skemat mbështetëse është planifikuar fondi prej 1,146 milionë lekësh, duke përfshirë këtu dhe fondin e planifikuar, si bashkëfinancim në kuadër të projektit IPA 2011.

Bazuar në VKM për zbatimin e skemave, si dhe udhëzimin përkatës, u bë e mundur promovimi dhe luftimi i Mizës së ullirit. Është parashikuar një ndryshim thelbësor në hartimin e skemave mbështetëse, duke i dhënë përparësi jo më mbjelljeve direkte, por finalizimit të produktit. Fondi është realizuar në masën 100 për qind. Numri i fermerëve përfitues në total është 8,770 persona.

Është punuar me grupet e interesit. Përmes mediave vizive, grupeve të punës, si dhe punonjësve të specializuar, është mundësuar njohja deri në detaje e skemave mbështetëse, duke rritur kështu numrin e aplikimeve krahasuar me një vit më parë. Financimi i skemave ka filluar në muajin korrik. Janë financuar 38 projekte me normë interes kredie; 95 projekte për serrat me ngrohje; 49 projekte me 50 për qind të financimit; 6,988 projekte për Mizën e ullirit; si dhe 1,600 projekte për skemat e tjera mbështetëse.

Lidhur me fondin e planifikuar si bashkëfinancim nga projekti IPARD-like, theksojmë se janë financuar 29 subjekte, në investime në fermat bujqësore dhe përpunim tregtim produktesh bujqësore.

dh) “Vrojtime statistikore”. Për këtë vit u parashikua fondi për kryerjen e vrojtimeve statistikore të Agro-industrisë, si dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit SITA. Ky fond u transferua me urdhër ministri, për arsye se vrojtimi statistikor u mbulua dhe për këtë vit nga INSTAT dhe printimet nga DB përkatëse. Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit do të kalojnë për vitin 2015.

e) “Rritje në masën 25 për qind e certifikimit të farërave të grurit, misrit, patates dhe perimeve, si dhe rritje prej 10 për qind të analizave dhe testimeve” realizohet përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve.

Realizimi i fondit për vitin 2014 është në masën 87 për qind. Gjatë kësaj periudhe është punuar në drejtim të zbatimit të standardeve shqiptare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, mbajtjen e dokumentacionit përkatës, marrjen e mostrave dhe analizave zyrtare dhe dërgimin në laborator, organizimin e punës në grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit për çdo rast në marketingun e farërave dhe fidanëve, marrjen e masave për etiketimin dhe kodifikimin e çdo loti fare të certifikuar, ndërtimin e “Buletinit të Certifikimit”, të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të prodhuar në vend, kryerjen e kontroleve dhe dhënien e asistencës, përgatitjen e materialeve dhe shpërndarjen e listës së varieteteve, etj. Janë certifikuar rreth 23.8 milionë rrënjë fidanësh dhe bimësh medicinale, duke tejkaluar kështu planin e parashikimeve. Janë kryer rreth 661 analiza laboratorike, etj. Gjithashtu, janë kryer teste në 60 hibride misri, 16 varietete patatesh, 8 varietetesh gruri, etj. Janë krijuar 11.6 milionë lekë të ardhura nga certifikimet, analizat, testimet, etj.

ë) “Mbështetje strukturore për zbatimin e të gjitha skemave në bujqësi” përfshihen fondet e planifikuara për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor Rural, e cila zbaton skemat mbështetëse në bujqësi. Realizimi i fondeve është 96 për qind. Diferencat kanë ardhur si rezultat i përzgjedhjes së ofertave më të ulëta gjatë procedurës së prokurimit.

f) “Regjistrimi i sipërfaqes me vreshta për 2000 njësi vreshti” (kadastra e vreshtarisë dhe verës). Fondi është realizuar në masën 95 për qind. Me përfundimin e projektit të BE-së për krijimin e kadastrës së vreshtarisë dhe verës, duhet të përfundojë dhe të vazhdojë puna për regjistrimin e gjithë sipërfaqes së mbetur dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngritur. Për këtë arsye me fondin e parashikuar prej 4 milionë lekësh për QTTB Fushë-Krujë, gjatë vitit 2014, janë mbyllur rrethet: Peqin, Gramsh, Librazhd dhe tre komuna në Elbasan.

g) “Shpenzime për hartimin dhe mirëmbajtjen e kadastrës së ullirit” nga QTTB Fushë-Krujë. Është realizuar 100 për qind e fondit të planifikuar. U regjistruan 2000 njësi në komunat e Elbasanit.

gj) “Shpenzime për serën e fidanëve të ullirit”. Fond që menaxhohet nga QTTB Vlorë, në të cilin përfshihen shpenzimet për serën e fidanëve, me qëllim prodhimin e fidanëve cilësorë. Realizimi i fondeve kryhet mbi bazën e situacioneve mujore të shpenzimeve. Fondi është realizuar në masën 80 për qind. Shpenzimet janë kryer për mbrojtjen e tokës, lidhëse fidanësh, kallama, karburant, mirëmbajtje e ullishtës në serë, etj. Nga planifikimi i bërë nga QTTB, ka diferenca në realizim për shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimeve të transportit, e mirëmbajtjes, të cilat janë mbuluar nga shpenzimet korente të QTTB.

h) “Fuqizimi i kapaciteteve të MBZHRAU-së”, përmes implementimit të projekteve të huaja që veprojnë në këtë fushë. Kështu për vitin 2014, janë planifikuar të veprojnë në këtë program: Projekti IPA 2011; IPA 2012, si dhe IPA Adriatica. Gjithashtu, janë çelur dhe fondet për tre projekte të reja në kuadër të Protokollit Italian: “Fuqizimi i AZHBR-së”, “Mbulimi i Rreziqeve në Bujqësi”, si dhe “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Sektorit të Ullinjve në Shqipëri”. Është kryer një shpenzim fondi nga projekti IPA Adriatica, për kryerje të aktiviteteve sipas një plani të miratuar. Nga Projekti Nobles-Ideas, kanë përfunduar të gjitha aktivitetet, si dhe është kryer disbursimi fondeve.

5. Programi “Këshillimi dhe informacioni bujqësor”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014, për këtë program, që përfaqëson rreth 3 për qind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet Korente	90.3 për qind
• Shpenzimet Kapitale	0 për qind
Gjithsej	90.3 për qind

Në programin “Këshillimi & Informacioni Bujqësor” përfshihet financimi i Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor, aktivitetet e të cilave ndiqen nga sektorët përkatës.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) gjatë vitit 2014 e kanë përqendruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave dhe programit të punës për këtë vit.

Realizimi sipas produkteve:

a) *Teknologji, paketa teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara.* Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, janë realizuar në masën 92 për qind krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2014, janë planifikuar dhe është duke u punuar për të realizuar 16 teknologji/paketa teknologjike (elemente të përmirësuar), si dhe 2 studime në fushën e tokave. Në fakt u realizuan 20 paketa teknologjike dhe studime në fushën e tokave bujqësore. Aktivitetet që i shërbejnë produktit janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë e blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farave dhe fidanëve, si dhe prodhimin e hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.

Gjatë vitit buxhetor, QTTB, në zbatim të programeve të miratuara realizuan gjithsej 54 eksperimente dhe 28 prova testimi të ndryshme (ku janë krahasuar dhe studiuar 154 varietete bimësh dhe 127 kultivarë) në bazat eksperimentale prodhuese; janë hartuar 20 karta teknologjike në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë; janë shkruar e publikuar 55 artikuj problemor sipas fushave, kulturave dhe specieve të kafshëve bujqësore.

b) Ofrim shërbimesh Ekstensionit: Shpenzimet për këtë produkt për këtë vit janë realizuar në masën 92 për qind. Aktivitetet që i shërbejnë këtij produkti janë: 28 kërkime në nivel ferme që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; si dhe përgatitja dhe shpërndarja e materialeve divulgative për fermerët dhe specialistët e bujqësisë (janë planifikuar dhe po punohet për përgatitjen e 7 tituj broshurash teknike sipas nevojave të fermerëve - të 7 titujt janë përfundim të procesit të shkrimit të tyre).

Gjatë këtij viti, strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në qarqe kanë qenë të pranishme dhe kanë zhvilluar aktivitete Ekstensionit si: demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panairë, tavolina të rrumbullakëta, etj. Këto aktivitete, kanë si synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohuritë e fermerëve. Nga strukturat e Shërbimit Këshillimor janë kontaktuar direkt dhe indirekt dhe kanë marrë informacion gjithsej rreth 75000 fermerë dhe agro-biznese, nga 70000 fermerë dhe agro-biznese të synuara.

Gjatë vitit 2014, janë realizuar 150 ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë, si dhe 14500 ditë trajnime me fermerë të interesuar kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike, etj.

Po kështu, janë shpërndarë për të interesuarit 38000 fletë-palosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, etj.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, janë në procesin e përgatitjes së 7 titujve të broshurave divulgative në funksion të kërkesave të fermerëve për informacion.

Janë realizuar deri tani 156 kronika dhe emisione televizive.

Të ardhura nga QTTB-të, të realizuara

Bazuar në plan-bizneset e QTTB-ve për vitin 2014 është punuar për realizimin e të ardhurave, të cilat vijnë kryesisht nga prodhimi i farërave dhe fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, nga realizimi i analizave laboratorike të ushqimit, tokës dhe hartografia, si dhe nga shpërndarja e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend, etj.

Përdorimi dhe realizimi i të ardhurave nga QTTB për këtë vit, është në masën 25,586 mijë lekë nga 32,651 mijë lekë që është limiti i përdorimit të këtyre të ardhurave, pra rreth 93 për qind. Gjatë kësaj periudhe, QTTB-të, kryejnë kryesisht shpenzime për kryerjen e punimeve bujqësore dhe vënien në punë të hapësirave dhe aseteve që zotërojnë dhe të ardhurat realizohen pas sezonit bujqësor me shitjen e farave të gjeneracioneve të larta (Super-elitë dhe Elitë) dhe fidanëve të pastër, të sigurt nga pikëpamja fitosanitare dhe të kontrolluar e certifikuar.

6. Programi “Menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore”

Për vitin 2014, për programin “Menaxhimi i Qendrueshëm i Tokës Bujqësore” nga buxheti i shtetit janë parashikuar 20 milionë lekë shpenzime operative dhe janë realizuar 20 milionë lekë ose 100 për qind për produktin:

- a) Krijimi i sistemit të informacionit për tokën LIS dhe integrimi i saj në GIS në 39.218 ha tokë që nga kjo 40.000 ha tokë bujqësore;
- b) Dixhitalizimi i Regjistrimit të Tokës Bujqësore në 41 komuna /bashki në shtatë qarqe të vendit. Realizimi i këtij produktit u krye nga QTTB-ja Fushë-Krujë në bashkëpunim me zyrtarët Vendorë të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe komunave/bashkive, sipas qarqeve sipas tabelave të mëposhtme:

7. Programi “Administrimi i ujërave”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2014 për këtë program, që përfaqëson 99 për qind të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 91 për qind
- Shpenzimet kapitale 100 për qind
- Gjithsej 99 për qind

Ky program, për vitin 2014 ka të planifikuar 900 milionë lekë fond investime, nga të cilat 672 milionë lekë janë financim i huaj dhe 228 milionë lekë financim i brendshëm. Realizimi financiar si vjetor është 100 për qind.

Emërtimi i Programit	Në përqindje	
	Shpenzime korente	Shpenzime kapitale
Planifikim, menaxhim administrim	91,1	94,0
Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit	96,0	62,7
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	97,4	69,5
Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agro-industrial dhe marketingun	98,6	208,5
Këshillimi dhe informacioni bujqësor	90,3	-
Menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore	97,8	-
Administrimi i Ujërave	88,6	106,6
TOTALI	96,4	100,5

Burimi: Ministria e Financave (2015);

5.3 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

MISIONI

Hartimi dhe zbatimi i politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e transportit dhe infrastrukturës në Shqipëri nëpërmjet hartimit, përmirësimit të strategjive, planeve të veprimit dhe të legjislacionit në këta sektorë, si dhe zbatimin e tyre.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Kjo ministri (MTI), për vitin 2014 ka administruar fondet buxhetore për 8 programe:

- Programi “Planifikim menaxhim administrim”
- Programi “Transporti rrugor”

- Programi “Mbështetje për studime në transport”
- Programi “Transporti Detar”
- Programi “Transporti Hekurudhor”
- Programi “Transporti Ajror”
- Programi “Ujësjiellës kanalizime”
- Programi “Menaxhimi i mbetjeve urbane”

Realizimi i Buxhetit 2014

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga MTI-ja mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri në fund të vitit 2014, sipas zërave të shpenzimeve, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Shpenzime personeli	414 242	376 836	90.7
2	Shpenzime të tjera korente	3 589 982	3 372 991	93.9
3	Shpenzime kapitale	42 712 204	36 583 044	85.6
	3.3 Me financim të brendshëm	26 544 202	25 125 574	94.6
	3.4 Me financim të huaj	16 168 002	11 457 470	70.8
	SHUMA	46 716 428	40 332 871	86.3
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		-	
	TOTALI	46 716 428	40 332 871	86.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Ndërsa sipas programeve, realizimi i treguesve në Total paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim menaxhimi	522 381	417 556	79.9
2	Transporti rrugor	31 859 375	29 181 270	91.5
3	Mbështetje për studime në transport	19 730	25 575	129.6
4	Transporti detar	959 479	390 159	40.6
5	Transporti hekurudhor	560 934	553 909	98.7
6	Transporti ajror	26 260	12 890	49
7	Furnizimi me ujë e kanalizime	12 308 286	9 608 113	78
8	Menaxhimi i mbetjeve urbane	459 983	143 399	31.1
	TOTALI	46 716 428	40 332 871	86.3
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit			
	GJITHSEJ	46 716 429	40 332 871	86.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i fondeve buxhetore, në veçanti për shpenzimet korente dhe kapitale, për çdo program paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014		Fakti 2014		Përqindja e realizimit	
		Korente	Investime	Korente	Investime	Koren	Investi

						te	me
1	Planifikim menaxhimi	438 381	84 000	407 677	9 879	93	11.7
2	Transporti rrugor	2 467 055	29 392 320	2 273 532	26 907 738	92.1	91.5
3	Mbështetje për studime në transport	19 730	0	18 209	7 366	92.2	
4	Transporti detar	84 479	875 000	82 656	307 503	97.8	35.1
5	Transporti hekurudhor	458 700	102 234	456 752	97 157	99.5	95
6.	Transporti ajror	23 000	3 260	11 976	914	52	28
7	Furnizimi me ujë e kanalizime	512 879	11 795 407	499 025	9 109 088	97.3	77
8	Menaxhimi i mbetjeve urbane		459 983		143 399		31.1
	TOTALI	4 004 224	42 712 204	3 749 827	36 583 045	93.6	85.6
	Shpenz. nga të ardhurat jashtë limitit			-	-		
	GJITHSEJ	4 004 224	42 712 204	3 749 827	36 583 044	93.6	85.6

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, buxheti i planifikuar për vitin 2014 për 8 programet buxhetore është realizuar në masën 86.3 për qind ndaj buxhetit vjetor. Ky nivel realizimi i buxhetit të MTI në total vjen si rezultat i realizimit të ulët në buxhetin e financimit të huaj.

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore për të gjithë programet, janë realizuar në përputhje me nevojat e institucioneve për vitin 2014. Në total shpenzimet operative janë realizuar në masën 93.6 për qind.

Gjithashtu, investimet e brendshme kanë një realizim 94.6 për qind kundrejt planit ose e shprehur në shifra është realizuar 25.1 miliardë lekë nga 26.5 miliardë lekë të buxhetit të rishikuar për vitin 2014. Ky mosrealizim (rreth 1.4 miliardë lekë) vjen kryesisht nga mosrealizimi prej 909 milionë lekësh në programin “Transporti rrugor”, 397 milionë lekë në programin “Furnizimi me ujë e kanalizime”, 22 milionë lekë në programin “Transporti detar”, rreth 80 milionë lekë në programin “Menaxhimi i mbetjeve urbane”.

Investimet me financim të huaj janë realizuar 70.8 për qind kundrejt planit ose 11.4 miliardë lekë nga 16.1 miliardë lekë të programuara për vitin 2014.

Çështje të veçanta

- Për këtë ministri nga **Fondi për likuidimin e Detyrimeve të Prapambetura** gjatë vitit 2014 janë akorduar gjithsej **9 025 062 405** lekë, nga të cilat:
 - Për shpenzime **operative 822 934 105** lekë, nga të cilat:
 - Vendime gjyqësore 649 387 867 lekë
 - Shpenzime operative 173 546 238 lekë
 - Për **Investime 8 202 128 300** lekë, nga të cilat:
 - Investime 7 790 479 912 lekë
 - VKM Shpronësime 411 648 388 lekë
- Numri i punonjësve të paguar në listë pritje për vitin 2014 është 28 punonjës dhe fondi përkatës është 21.5 milionë lekë.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Rrjeti i rrugëve nacionale”

Ky program mbulon zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, përfshirë korridoret dhe rrugët për në destinacionet kufitare dhe turistike, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm, që nënkupton uljen e kostos, rritjen e shpejtësisë së lëvizjes, sigurinë rrugore e atë fizike të mjetit, pasagjerit dhe ngarkesës, si dhe parametra të pranueshëm mjedisorë.

Për këtë program, realizimi i planit të buxhetit paraqitet:

Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2014	Fakt 2014	Përqindja e realizimit
1. Shpenzimet e personelit	138 500	137 169	99
2. Shpenzime të tjera korente	2 328 555	2 136 363	91.7
3. Shpenzime kapitale	29 392 320	26 907 738	91.5
- Financim i brendshëm	22 751 123	21 842 082	96
- Financim i huaj	6 641 197	5 065 656	76.3
Gjithsej shpenzimet	31 859 375	29 181 270	91.5

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Ky program mban peshën më të madhe të investimeve të MTI-së, rreth 69 për qind të planit të shpenzimeve kapitale. Fondet për investime në këtë program janë realizuar në masën 91.5 për qind, në një kohë që financimi i huaj ka një realizim plani 76.3 për qind, ndërsa financimi i brendshëm është realizuar në masën 96 për qind.

Realizimi i produkteve për këtë program për vitin 2014 në krahasim me planin vjetor paraqitet në grup produkte më poshtë:

- Grupi i produktit “Ndërtim rruge” i shprehur në sasi (km) është realizuar ndaj planit vjetor 93.5 për qind me 83.33 km dhe shpenzimet faktike 92 për qind të planit vjetor. Nga këto janë realizuar për grupin “Ndërtim rruge me financim të brendshëm” 55.95 km ose rreth 99 për qind e planit vjetor, ndërsa shpenzimet faktike rreth 99 për qind Me financim të huaj janë realizuar 22.38 km nga 32.59 km të planifikuara si vjetor.
 - Me financim të brendshëm objekti “Ndërtim rruge tip A2 me katër kors (2x2)”, është realizuar në sasi 12.59 km ose 99 për qind e planit vjetor, ndërsa shpenzimet janë realizuar 2758 milionë lekë nga 2815 milionë lekë të planifikuara. Në këtë grup janë përfshirë kryesisht rrugë me katër kors dhe gjerësi që varion 20-25 m, me disa objekte të rëndësishëm të përfunduar si: 3 lotet e para Ndërtim by pass Plepa-Kavajë-Rrogzhinë, ndërsa janë në proces dhe po punohet për zbatimin e projekteve në 7 lotet e tjera. Njëkohësisht janë në proces: Përmirësimi i sigurisë dhe sinjalistikës rrugore në superstradën Tiranë-Durrës dhe segmentin Kashar-Rinas, menaxhimi funksionimi e mirembajtja e pajisjeve dhe operimi i tunelit të Thirrës dhe të Krrabës, si dhe ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti 1 (vepra arti të mëdha) dublimi
 - Ndërtim rruge tip A me katër kors (2x2 me financim të huaj): Për këtë grup produkt janë planifikuar për vitin 2014 fonde në vlerë 5.8 miliardë lekë (ose 87 për qind ndaj planit vjetor të financimit të huaj gjithsej) dhe në sasi 17.04 km, ndërsa janë realizuar 4.9 miliardë lekë me 14.52 km. Përfshihen në këtë grup rrugë me katër kors dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishme në proces si: Tiranë-Elbasan (janë përfunduar dy tunelet dhe segmenti dalje e tunelit Krrabë-Elbasan dhe janë në proces

- segmentet Mullet-Hyrje tunelit Krrabë,Elbasan, By Pass-it Shkozet dhe Durrës, si dhe ndërtimi i By Pass-it Fier.
- Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi me trotuare dhe ndriçim: Për këtë grup produkti shpenzimet e planifikuara për vitin 2014 janë 3.8 miliardë lekë (30.7 për qind ndaj planit vjetor të financimit të brendshëm për grupin ndërtim rruge) dhe në sasi 6.85 km, ndërsa janë realizuar 3.8 miliardë lekë me 6.39 km. Në këtë grup janë përfshirë kryesisht rrugë me katër korsi dhe gjerësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si: Ndërtim Rruga e Elbasanit, segmenti Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe Tiranë, Ndërtim Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit- Rruga e Kavajës, Ndërtim Unaza e Re e Tiranës, Komuna e Parisit –Shkolla Teknologjike pjesa e mbetur, ndërtim nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë-Rrëshen, Thumanë, ndërtim rruga e Porto Romanos, Durrës Loti 1.
 - Ndërtim rruge tip B1 me dy korsi: Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 4.5 miliardë lekë dhe në sasi 11.17 km, ndërsa janë realizuar 4.6 miliardë lekë me 22.98 km. Në këtë produkt janë përfshirë tip rruge me dy korsi dhe gjerësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara si ndërtim rruga Milot–Fushë Krujë (dublimi i superstradës) loti 3, loti 4, ndërtim rruga Lushnje-Berat, loti 1,2,3. Në tremujorin e dytë 2014 janë financuar përveç objekteve të mësipërme edhe objekte për të cilat janë akorduar fonde buxhetore për likuidimin e detyrimeve të prapambetura: Ndërtim i Rrugës së Arbërit (seg.Ura e Brarit-hyrje tuneli Qafë Murrizë loti 1, (Dalja e Urës së Vashës Bulqizë) loti 2, loti 3, ndërtim rruga Kardhiq–Delvinë loti 2.
 - Ndërtim rruge tip C2 dhe C2’ me dy korsi: Për këtë grup janë planifikuar fonde në vlerë 1.1 miliardë lekë dhe në sasi 14.6 km, ndërsa janë realizuar 1.1 miliardë lekë me 13.57 km. Po punohet normalisht në objektet që janë në proces si: Plotësimi Dragobi-Valbonë, plotësim–rifreskim i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore, ndërtim i rrugëve sekondare Vidhas-Kombinati Metalurgjik (shtesë). Janë financuar objekte nga fondi për likuidimin e detyrimeve të prapambetura si: rikonstrukcion i rrugës dhe zgjerim i tunelit në zonën e Ujit të Ftohtë Vlorë dhe rRëshqitje në aksin Rubik-Rrëshen-Gjegjan.
 - Në produktin “Rikonstrukcion rruge tip C2 me dy korsi” janë planifikuar fonde në vlerë 4.1 miliardë lekë dhe në sasi 64.42 km, ndërsa janë realizuar 4 miliardë lekë me 60.75 km. Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si: (Sistemim asfaltim Rruga e Gjinarit, Elbasan, s/asfaltim rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara- Sarandë) loti 1 + shtesë punimesh, s/asfaltim rruga Tri Urat- Leskovik. Janë financuar edhe objekte nga fondi për likuidimin e detyrimeve të prapambetura si s/asfaltim Rruga Zemblak-kryqëzim Liqenas Loti 1, rruga e Voskopojës, Korçë, Librazhd –Qafë Stude Loti 3 , Kuçovë- Belsh- Cërrik, Pajovë-Shezë-Pekisht –Belsh, etj.
 - Për grupin e shpenzimeve “Shpronësime dhe Vendime gjyqësore”, garanci objekti dhe leje mjedisore, janë planifikuar fonde në vlerë 2.1 miliardë lekë nga të cilat janë realizuar rreth 2 miliardë lekë.
 - Shpenzimet kapitale për TVSH dhe Kosto Lokale për vitin 2014 janë 3.7 miliardë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën e 3.1 miliardë lekëve (ose 85 për qind ndaj planit vjetor të shpenzimeve të këtij grupi).

Programi “Ujësjellës kanalizime”. Me anë të këtij programi synohet hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve dhe për të ecur në mënyrë të qendrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me objektivin e Zhvillimit të Mijë-vjeçarit për qendrueshmërinë e mjedisit.

Për këtë program, realizimi i planit të buxhetit paraqitet:

Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2014	Fakt 2014	Përqindja e realizimit
1. Shpenzimet e personelit	48 000	39 029	81.3
2. Shpenzime të tjera korente	464 879	459 996	98.9
3. Shpenzime kapitale	11 795 408	9 109 088	77.2
- Financim i brendshëm	3 437 603	3 040 457	88.4
- Financim i huaj	8 357 805	6 068 631	72.6
TOTALI	12 308 286	9 608 113	78

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Siç shihet, realizimi i shpenzimeve të personelit është në masën 81.3 për qind, shpenzimet e tjera korente janë realizuar 98.9 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 77.2 për qind. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në rreth 88.4 për qind, ndërsa ato me financim të huaj janë realizuar në 72.6 për qind.

Performanca e realizimit të produkteve me financim të brendshëm paraqitet si më poshtë:

- Produkti “Dokumente të hartuara për rritjen e standardeve të shërbimit për DPUK”, ku përfshihen paga, sigurime, si dhe mallra e shërbime për funksionimin normal të administratës së DPUK për vitin 2014 është realizuar në masën 79 për qind.
- Produkti “Subjekte/operatore të UK të subvencionuar”, me plan vjetor 450 milionë lekë, është realizuar 449 milionë lekë. Gjithashtu është akorduar dhe realizuar fondi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore në vlerën 2.3 milionë lekë në artikullin 602 “Mallra e shërbime”.
- Produkti “Lidhje të reja të furnizimit me ujë”, për vitin 2014 është realizuar në vlerë për 157 milionë lekë nga 195 milionë të planifikuara, ndërsa në sasi është realizuar 6342 lidhje nga 8557 lidhje të planifikuara.
- Produkti “Linje e re e furnizimit me ujë” në vlerë është realizuar për 564 milionë lekë nga 603 milionë lekë, ndërsa në sasi është realizuar 27 658 milionë nga 32 430 milionë lekë të planifikuara.
- Produkti “Rrjet kanalizimesh të ujërave të zeza i shtruar” është realizuar 30 006 milionë nga 34 231 milionë lekë, ndërsa në vlerë për shumën 233 milionë lekë sa shuma e planifikuara.

Produktet e parashikuara me financim të huaj janë realizuar si më poshtë:

- Produkti “Linje e re e furnizimit me ujë”, është realizuar 34 287 milionë lekë nga 54 417 milionë lekë të planifikuara.
- Produkti “Rrjet kanalizimesh të ujërave të zeza i shtruar” është realizuar 33 144 milionë lekë nga 45 160 milionë lekë të planifikuara.

- Produkti “Impiant i trajtimit të ujërave të zeza” është realizuar 1.4 copë nga 4 copë të planifikuar. Një impiant është realizuar plotësisht, ndërsa impianti i Velipojës është realizuar 40 për qind.

Programi “Transporti Detar”

Për këtë program realizimi i planit të buxhetit paraqitet:

Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2014	Fakt 2014	Përqindja e realizimit
1. Shpenzimet e personelit	58 825	58 602	99.6
2. Shpenzime të tjera korente	25 654	24 054	93.8
3. Shpenzime kapitale	875 000	307 503	35.1
- Financim i brendshëm	125 000	102 227	81.8
- Financim i huaj	750 000	205 276	27.4
Gjithsej Shpenzimet	959 479	390 159	40.6

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Për këtë program, shpenzimet e personelit janë realizuar në masën 99.6 për qind, shpenzimet e tjera korente janë realizuar 93.8 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale në masën 35.1 për qind, nga ku financimi i brendshëm në masën 81.8 dhe financimi i huaj 27.4 për qind.

Investimet e brendshme kanë një mosrealizim prej 22 milionë lekësh për TVSH e Taksë Doganore për projektin për ndërtimin e terminalit të pasagjerëve dhe rehabilitimi i kalateve 7 dhe 8, në Portin e Durrësit.

Niveli i ulët i investimeve me financim të huaj ka ardhur si rezultat i disa prolemeve ende të pazgjidhura në implementimin e projekteve dhe konkretisht:

Për projektin “Ndërtimi i terminalit të pasagjerëve në Portin e Durrësit dhe rehabilitimi i kalatave 7 dhe 8”, me vlerë 450 milionë lekë, aktualisht ka përfunduar marrja e miratimit nga palët për vijimin e procedurave të prokurimit për Fazën e Dytë-Rehabilitimi i kalatave 7 dhe 8 dhe po përgatiten dokumentet e tenderimit. Ky projekt vazhdon edhe për vitin 2015.

Ndërsa projekti “Ndërtimi i fazës së I & II dhe pjesërisht të III të Portit të Vlorës” me vlerë 300 milionë lekë është realizuar në masën 204 milionë lekë duke patur një ecuri normale.

Produktet e këtij programi janë realizuar si më poshtë:

Produkti Kalata 7 dhe 8 në Portin e Durrësit e rehabilituar, nuk ka realizim pasi gjatë vitit 2014 ka përfunduar marrja e miratimit nga palët për vijimin e procedurave të prokurimit për Fazën e Dytë-Rehabilitimi i kalatave 7&8 dhe po përgatiten dokumentet e tenderimit. Ky projekt vazhdon edhe për vitin 2015.

Produkti Porti i Shëngjinit i rehabilituar është realizuar në masën 100 për qind.

Realizimi i Produktit *Kalata e Portit të Vlorës e rehabilituar* dhe *Moli i pasagjerëve në Portin e Vlorës i ndërtuar* është realizuar pjesërisht dhe ka një ecuri normale.

Programi “Transporti Hekurudhor”

Shpenzimet korente për këtë program janë realizuar 99.6 për qind, shpenzimet kapitale janë realizuar 95 për qind.

Realizimi i produktit “Inspektime të kryera në linjat dhe mjetet hekurudhore”, është realizuar 100 për qind, ndërsa produkti “Politika të hartuara për transportin hekurudhor” është realizuar në masën 67 për qind.

Produkti “**Bileta të udhëtarëve në transportin hekurudhor të subvencionuara**” është realizuar 100 për qind për vitin 2014.

Investimet me financim të brendshëm për këtë program për vitin 2014 janë realizuar në masën 95 për qind.

Programi “Transporti Ajror”

Në këtë program përfshihen shpenzimet për funksionimin normal të administratës së Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore (OKKIA), si dhe mallra dhe shërbime për funksionimin dhe mbarëvajtjen e kësaj strukture, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve.

Për sa i përket performancës së produkteve dhe shpenzimeve për programin e Transportit Ajror, produktet të cilat u synuan të arrihen gjatë këtij dymbëdhjetë-mujori janë:

“Investigimet e kryera nga OKKIA”, ky produkt është realizuar në 80 numër investigimesh nga 100 të planifikuar. Produkti “Dokumente të hartuara nga sektori i politikave të transportit ajror në MTI është realizuar në 100 numër dokumente nga 150 të planifikuar.

Në këtë program kanë qenë parashikuar fondet për investime për ruajtjen fizike të Aeroportit të Kukësit. Këto shpenzime nuk u realizuan pasi me VKM, këto shpenzime do të përballohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Për projektet e OKKIA, “Riparim rrjeti elektrik dhe hidraulik” dhe “Rikonstruksion i godinës”, nuk i bë i mundur realizimi i procedurave të prokurimit.

Programi “Menaxhimi i mbetjeve urbane”. Në këtë program gjatë vitit 2014 janë planifikuar fonde për shpenzime kapitale gjithsej 460 milionë lekë, të cilat janë realizuar për 143 milionë lekë ose 31.1 për qind.

Projekti “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë”, me vlerë financimi i huaj 209 milionë lekë për vitin 2014 është realizuar 80 milionë lekë ose 38 për qind, kjo për shkak të vështirësive në shpronësimin e tokave që do t’i paraprijnë punimeve për ndërtimin e landfillit të Korçës. Nuk ka filluar procedura e tenderimit për punimet e ndërtimit. Për shkak të mosrealizimit të punimeve të projektit nuk janë realizuar edhe fondet për TVSH e Taksë Doganore.

Projektet “Studim projektim për mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese” në Durrës, Sarandë, Vlorë me vlerë totale 8 milionë lekë nuk kanë realizim për vitin 2014, pasi nuk janë realizuar procedurat e prokurimit.

Projekti “Rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të Çorovodës”, është realizuar në masën 100 për qind.

Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”. Shpenzimet korente për këtë program janë realizuar në masën 93 për qind, ku mosrealizime ka patur në shpenzimet për “Paga”, “Transferta korente të huaja” dhe “Mallra e Shërbime”.

Ndërsa shpenzimet për investime janë realizuar në masën 11.7 për qind.

Realizimi i **produkteve** për këtë program paraqitet si më poshtë:

Produkti “Familje të subvencionuara për transportin e trupave të sjella në Shqipëri”, planifikimi vjetor në vlerën 46.7 milionë lekë është realizuar në masën 100 për qind.

Kontribute për Organizatat Ndërkombëtare janë planifikuar në vlerën 12 milionë lekë dhe janë realizuar në vlerën 9.4 milionë lekë.

“Sistemi i kamerave në hyrjen kryesore dhe hyrjen e mbrapme të godinës së MPPT” është planifikuar në vlerën 0.2 milionë lekë dhe është realizuar në vlerën 0.15 milionë lekë, sipas vlerës së kontratës të tenderuar.

Janë shlyer detyrime të prapambetura për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe shpenzime operative për 166.7 milionë lekë.

Investimet e brendshme nga 5 milionë lekë janë realizuar 2.9 milionë lekë. Ky mosrealizim vjen kryesisht për shkak të mosrealizimit të fondeve të TVSh-së për projektet e IPA-s.

5.4 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

MISIONI

Misioni i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është të sigurojë edukimin e vlerave demokratike e kombëtare dhe zotërimin e njohurive e shprehive për ekonominë moderne të tregut, edukim të mbështetur në të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti, edukim cilësor, sipas nevojave dhe interesave të individit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi, sipas standardeve evropiane, barazi të shanseve për arsimim për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë, arsimim bazë për të gjithë.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Arsimit dhe Sportit, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas shtatë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

Realizimi i Buxhetit 2014

Realizimi i buxhetit vjetor për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në total, për vitin 2014, është rreth 96 për qind.

<i>Në mijë lekë</i>				
NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim, administrim	812.449	696.620	85.7
2	Arsimi Bazë	26.136.710	25.135.837	96.2
3	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	6.559.846	6.148.499	93.7
4	Arsimi i Mesëm Profesional	2.392.828	2.259.029	94.4
5	Arsimi i Lartë	5.647.099	5.616.332	99.5
6	Kërkimi Shkencor	181.457	172.771	95.2
7	Zhvillimi i Sportit	818.827	811.221	99.0
TOTALI		42.549.216	40.840.309	96.0

Burimi: Ministria e Financave(2015);

- a) **Shpenzimet për personelin** janë planifikuar në rreth 34 miliardë lekë ose rreth 80 për qind e buxhetit të vitit 2014. Fondet e miratuara për shpenzime personeli mbulojnë pagat dhe sigurimet shoqërore të 38,953 punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, si dhe punonjësve të institucioneve të sistemit të kësaj ministrie. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen edhe fondet që marrin institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe që pas vendimmarrjes në organet e tyre kolegjiale detajohen në shpenzime të personelit.

- b) **Shpenzimet e tjera korente** janë planifikuar 3.8 miliardë lekë ose rreth 9.1 për qind e buxhetit për vitin 2014. Zërat kryesorë në shpenzimet e tjera korente janë shpenzime për transportin e nxënësve dhe të mësuesve në zonat rurale; shpenzime për blerje mjetesh didaktike, shpenzime për transfertat tek individët për blerjen e teksteve shkollore, shpenzime për krijimin e kushteve të punës (shpenzime për energji elektrike, ujë, internet, telefon, materiale zyre kancelari, etj), bursat e nxënësve dhe studentëve që zënë edhe pjesën më të madhe të kësaj kategorie të shpenzimeve. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen edhe fondet që marrin IAL në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe që pas vendimmarrjes në organet e tyre kolegjiale, detajohen në shpenzime të tjera korente për blerje materiale dhe shërbime funksionale.
- c) **Shpenzimet kapitale** për investime janë planifikuar në rreth 4.6 miliardë lekë, duke përfaqësuar rreth 10.9 për qind të buxhetit të vitit 2014. Sipas burimit të financimit shpenzimet kapitale paraqiten si më poshtë:
- Rreth 4.5 miliardë lekë ose rreth 97.3 për qind e totalit të investimeve financohen nga buxheti i shtetit,
 - Rreth 125 milionë lekë ose rreth 2.7 për qind e totalit të investimeve janë me financim të huaj, nga Projekti IPA BE, KE Projekti CARDS, Qeveria Zviceriane e Italiane.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014, për çdo program dhe i ndarë për shpenzimet korente dhe shpenzimet kapitale, paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korente

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Buxheti fillestar 2014	Buxheti i ndryshuar 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
		1	2	3	$4((3/2 \times 100))$
1	Planifikim, menaxhim, administrim	738.000	768.985	696.139	90.5
2	Arsimi Bazë	23.150.000	23.696.198	23.033.581	97.2
3	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	5.226.450	5.288.717	5.118.254	96.7
4	Arsimi i Mesëm Profesional	2.076.000	2.090.240	1.982.678	94.8
5	Arsimi i Lartë	5.156.000	5.283.776	5.257.764	99.5
6	Kërkimi Shkencor	177.000	178.324	169.738	95.2
7	Zhvillimi i Sportit	148.000	613.686	606.256	98.8
TOTALI		36.671.450	37.919.926	36.864.410	97.2

Burimi: Ministria e Financave(2015);

Shpenzimet kapitale

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Buxheti fillestar 2014	Buxheti i ndryshuar 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
		1	2	3	$4((3/2 \times 100))$
1	Planifikim, menaxhim, administrim	49.500	43.464	481	1.1
2	Arsimi Bazë	1.800.000	2.440.512	2.102.256	86.1
3	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	771.738	1.271.129	1.030.245	81.1
4	Arsimi i Mesëm Profesional	408.262	302.588	276.351	91.3
5	Arsimi i Lartë	390.500	363.323	358.568	98.7
6	Kërkimi Shkencor	0	3.133	3.033	96.8

7	Zhvillimi i Sportit	20.000	205.141	204.965	99.9
TOTALI		3.440.000	4.629.290	3.975.899	85.9

Burimi: Ministria e Financave(2015);

Objektivat dhe reformat kryesore të realizuara nga MAS për vitin 2014

U realizua Korniza e re Kurrikulare e bazuar në kompetenca, konform rekomandimeve të Bashkimit Europian për arsimin, e cila e sjell arsimin shqiptar në shekullin e 21-të. Tashmë nuk ekziston asnjë vështirësi për të ndjekur shkollat europiane, pasi korniza kurrikulare që po unifikohet, është ajo zyrtare e BE-së.

U jetësua unifikimi i sistemit arsimor parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes për Unifikimin e Kurrikulës së Sistemit Arsimor Parauniversitar “Një shkollë shqiptare për të gjitha hapësirat shqipfolëse”. Tashmë, një nxënës/e i Shqipërisë nuk do të ketë më asnjë pengesë për të vijuar shkollimin e tij/të saj në Kosovë dhe anasjelltas.

Në Maturën Shtetërore 2014-të, u realizua kthesa e duhur në drejtim të meritokracisë, duke unifikuar standardin e cilësisë në gjithë vendin. Ndershmëri, meritokraci dhe standard në MAS 2014, duke administruar në mënyrë rigorozë dhe të unifikuar të gjithë procesin. U deklarua dhe u rrit paraprakisht në 20 për qind pragu i kalueshmërisë, u rrit në 26 për qind pesha e mesatares, nisur nga parimi që shkolla duhet të ofrojë dije të vlefshme dhe jo thjesht diploma.

U fillua sipërmarrja madhore e digjitalizimit të sistemit arsimor shqiptar, duke u rinegociuar dhe ratifikuar marrëveshjen për Projektin “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet e-Edukimit”, me Qeverinë Austriake, i cili do të pilotohet fillimisht në 30 shkolla të mesme të përgjithshme në vend.

U realizua projekti “Shkolla si qendra komunitare” për t’ia kthyer ato komunitetit. “Shkolla si qendra komunitare” vazhdon të mbetet projekti më i madh. Në 66 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme ka nisur zbatimin e projektit “Shkolla, Qendër Komunitare”, falë mbështetjes edhe të donatorëve europianë dhe SHBA-ve. Programi zhvillohet nga vetë shkollat në bazë të specifikës së tyre, duke promovuar bashkëpunimin mësues-prindër-nxënës. Për herë të parë, prindërit, mësuesit dhe nxënësit do të kenë në dorë një instrument të rëndësishëm për verifikimin e cilësisë në gjithë sistemin parauniversitar, sepse për herë të parë u realizua Karta e Performancës së Shkollës.

Është rishikuar katalogu i teksteve shkollore 2014, për cilësinë e teksteve. 120 tituj librash mësimorë problematikë u hoqën nga katalogu i vitit 2014, pas konsultimit me mësuesit, prindërit dhe shtëpitë botuese. Falë një komunikimi të ri, siguroam që çdo vërejtje e dhënë nga mësuesit, për tekste të veçanta, sado e vogël qoftë, të përmirësohet nga botuesit.

Reforma e Arsimit të Lartë është kryefjala e reformave në të gjithë sistemin tonë arsimor. U tregua një risi në politikëbërje përmes një procesi të veçantë që u ndoq për Reformën e Arsimit të Lartë. Kemi tashmë gati një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, e cila synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t’u arsimuar, nëpërmjet

ngritjes së një Komisioni të pavarur, i cili mundësoi një proces të zhvilluar në transparencë të plotë, duke garantuar gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit, e aktorëve të AL-së pa asnjë përjashtim. Raporti përfundimtar i komisionit përfshiu të gjitha vërejtjet konstruktive, ndaj u mirëprit edhe nga ata që reformën e panë në fillim me dyshim.

U nënshkruam marrëveshja “**Horizon 2020**”, Programi i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, i cili premtonte arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë së Europës në nivel global.

Në sport, u rrit numri i orëve të lëndës së edukimit fizik në shkollat e arsimit parauniversitar me nisjen e vitit shkollor 2014-2015.

U siguria shërbimi i internetit në 1,350 shkolla të sistemit parauniversitar, implementimi i platformës e-learning dhe pajisja me tableta për nxënësit e klasave të 10-11-12 të arsimit të mesëm të përgjithshëm, projekt i nisur dhe financiar në vitin 2014.

Vazhdimin e reformës së arsimit e lartë, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator, rishikimin e skemës së financimit të IAL-ve, përmirësimin e kushteve të infrastrukturës së IAL-ve publike, përmes sigurimit të mbështetjes buxhetore për projektet e nisura, monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë së IAL publike dhe private, si dhe rritjen e kontrollit për përmbushjen e standardeve të akreditimit të tyre.

Mbështetje financiare për studentët ekselentë që studiojnë në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “*Times Higher Education*”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitet më të mira të botës.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Ky program përfaqëson rreth 1.7 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara për gjithë ministrinë. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014 për këtë program, krahasuar me planin vjetor paraqitet si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korrente | 90.5 për qind |
| • Shpenzime kapitale | 1.1 për qind |
| Gjithsej | 85.7 për qind |

Objektivat kryesore:

- Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese me 20 për qind të punonjësve në MAS, DAR dhe ZA (për 100 punonjës). Përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor.
- Përmirësimi i kushteve të punës, për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë, nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë (materiale, energji, internet, telefon ngrohje, etj), si dhe rinovimit të pajisjeve e aseteve të qëndrueshme me 10 për qind në vit, pajisjeve të zyrave,

pajisje teknologjike, rikonstruksionin/zgjerimit e objekteve ekzistuese, si dhe ndërtimeve të reja.

- Zhvillimi i sistemit të informacionit EMIS në përputhje me standardet operationale në arsim, nëpërmjet shtrirjes dhe funksionimit të sistemit EMIS në të gjithë DAR/ZA. Publikimi për çdo vit shkollor i raportit të arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar
- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.
- Auditimi dhe inspektimi i 30 për qind të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Trajnimi i 80-100 drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkolles në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor, si dhe rritjes të autonomisë së shkollave duke fuqizuar kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese në shkollë.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2014:

- U realizua kthesa që garanton cilësinë në shërbimin arsimor dhe zbatimin e ligjit në institucionet arsimore;
- U rrit numri i inspektimeve duke ndikuar në arritjet në përfundime më të sakta në sistem. Gjithsej janë: 784 inspektime, monitorime shqyrtimi e ankimimi;
- Inspektimi u kthye në një realitet që vlerëson situatën dhe propozon masa përmirësimi për institucionet dhe punonjësit arsimorë;
- U reformua procedura e inspektimit duke ndryshuar mënyrën e mbledhjes së të dhënave në proces;
- U rrit cilësia e raportimit bazuar në prova të gjetura, shoqëruar me procesverbal inspektimi;
- Matura shtetërore u monitorua me korrektësi në kuadër të ekipit të ngritur nga MAS;
- U krijua sektori i Inspektimit të Ligjshmërisë në arsimin e lartë dhe filluan inspektimet në të gjitha IAL-të.

Në programin "Planifikim, administrim dhe menaxhim", janë parashikuar 10 produkte, ecuria e 4 prej të cilëve rezulton e kënaqshme, si në terma financiarë dhe në terma sasiorë. Këtu përmendim: Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese, Krijimi i kushteve të punës për punonjësit në MASH,DAR/ZA dhe Inspektorati Kombëtar i AP; Vlerësimi i punës së punonjësve në MASH,DAR/ZA; Auditimi dhe inspektimi i institucioneve të sistemit arsimorë.

Programi “Arsimi bazë”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014, në këtë program që përfaqëson rreth 61.5 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara, është në rreth 96.2 për qind. Krahasuar me planin vjetor realizimi sipas zërave kryesore rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korrente | 97.2 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 96.1 për qind |
| Gjithsej | 96.2 për qind |

Objektivi kryesor i këtij programi, që ka të bëjë me sigurimin e arsimit cilësor për të gjithë nxënësit, duke përmirësuar kushtet e mësim-dhënies dhe të mësim-nxënies, si dhe duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë për të gjithë fëmijët e grupmohës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar, zërthehet në disa objektiva, e konkretisht:

- Rritje e aksesit në arsimin parashkollor nga 76 për qind në 80 për qind në vitin 2017. Rritja e aksesit të fëmijëve 5-vjeçarë me 15 për qind të numrit aktual të regjistruar në klasat përgatitore (me 1300 fëmijë më shumë). Modernizimi i arsimit parashkollor, përmes trajnimit të mësuesve (15-20 për qind në vit), rikonstruksionit dhe ndërtimit (150-200 klasa në vit) të kopshteve dhe pajisjes me bazë materiale didaktike.
- Hartimi i kurrikulës lëndore (kl 0 - 5), përgatitja e 50 moduleve trajnuese për kurrikulën e rishikuar, të 10 moduleve për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK). Trajnimi i mësuesve të AB dhe të diasporës (70 mësues) për zbatimin cilësor të kurrikulës 25 për qind e mësuesve të AB.
- Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore dhe kompensimi 100 për qind për nxënësit romë, egjiptianë, fëmijëve të familjeve në nevojë 4 000 nxënësve.
- Sigurimi i një arsimit cilësor për fëmijët në nevojë, (rritja e treguesit të regjistrimit me 4 për qind ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2 për qind për nxënësit me AK. Rritja me 1.5 për qind e numrit të mësuesve asistent për nxënësit me AK. Sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e AB. Uljen e braktisjes shkollore në AB në 0.3 për qind. Trajtimi i diferencuar i mësuesve (20-25 për qind) që, do të punojnë me fëmijët që kanë braktisur shkollën për ri-integrimin e tyre.
- Konsolidimi i shërbimit psikolo-social nëpërmjet ngritjes së njësisë së shërbimit psiko-social në njësitë arsimore. Trajnimi i vazhdueshëm i psikologëve (150) dhe punonjësve socialë (150). Ngritja e mekanizmit të supervizimit të shërbimit psiko-social dhe e kapaciteteve të tyre. Modernizimi i kabineteve përkatëse dhe pajisja me instrumente pune.
- Arsimit cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Evropiane: ndërtime të reja e rehabilitim të objekteve arsimore 450 - 500 klasa e sigurimi i pajisjes së tyre. Pajisja e 20-25 për qind të shkollave të AB me laborator shkencorë, IT synimi një kompjuter për dy nxënës në orë mësimi, laboratorë virtual e biblioteka digjitale në AB (të paktën 1 set laptop-projektor për çdo shkollë).

Arritjet kryesore gjatë vitit 2014:

- Arsimimi në fëmijërinë e hershme. Në Shqipëri, 76 për qind e fëmijëve të grup moshës 3-5 vjeç (treguesi NER) dhe 83 për qind fëmijëve 3-6-vjeçarë (treguesi GER), ndjekin institucionet parashkollore (INSTAT 2012-2013). Në vitin shkollor 2013-2014 numri total i fëmijëve 3-6-vjeçarë në kopshte ishte 81 448, nga të cilët 76 416 ose 94 për qind frekuentonin kopshtet publike dhe 5 032 ose 6 për qind fëmijë ato private. 610 fëmijë romë kanë ndjekur arsimin parashkollor; ndërsa 195 720 nxënës ndoqën arsimin fillor, nga të cilët 94 për qind arsimin publik. Pranë shkollave të arsimit bazë u ngritën dhe funksionuan rreth 448 klasa përgatitore me 11 047 nxënës 5-vjeçarë, pra 63 klasa (ose 14 për qind) më shumë se një vit më parë, ku u punësuan 63 mësues dhe 1 547 (ose 14 për qind) nxënës më shumë dhe se një vit më parë. Klasat përgatitore u ndoqën nga 136 fëmijë romë ose 66 për qind më shumë se një vit më parë.
- Është planifikuar dhe po përgatitet përfshirja graduale e klasës përgatitore në arsimin e detyruar. Është hartuar dhe filloi pilotimi i paketës së re kurrikulare për klasën përgatitore dhe klasën e parë të arsimit fillor. Paketa e re kurrikulare, e cila përshin kornizën, kurrikulën

bërthamë, programet dhe fushat e të nxënës do të pilotohet në 26 klasa përgatitore dhe të para, nga ku do të përfitojnë rreth 780 nxënës.

- Gjatë vitit shkollor 2013-2014 e ndoqën arsimin parauniversitar 4 219 fëmijë romë, 134 më shumë në krahasim me vitin shkollor 2012-2013. Për herë të parë, u identifikuan 93 mësues romë dhe egjiptianë të diplomuar për mësuesi, prej të cilëve janë punësuar në sistem 86 për qind e tyre (80 mësues): 10 në arsimin parashkollor, 21 në klasat I-V; 35 në klasat VI-IX (1 egjiptian drejtor shkolle në Dibër) dhe 14 në arsimin e mesëm të lartë. Të 35 mësuesit romë janë të punësuar sipas profilit të diplomës që zotërojnë.
- Në vitin 2014 është nënshkruar marrëveshje me MMSR, MPB dhe MSH për të regjistruar në klasë të parë çdo fëmijë pa përjashtim, përmes projektit të mbështetur nga UNICEF “Çdo fëmijë në shkollë”.
- Në vijim të synimeve dhe objektivave të MAS, si dhe me mbështetjen e UNICEF, u prezantua dhe do të mbështet zbatimi i kësaj nisme “Çdo fëmijë rom në kopsht”.
- Për herë të parë në muajin mars të vitit 2014, si rezultat i bashkëpunimit të MAS me QSUT-në “Nënë Tereza”, filloi ofrimi i shërbimit arsimor, nga dy mësuese të caktuara prej DAR-së së Qytetit Tiranë, për fëmijët e shtruar në repartet e ndryshme të Pediatriisë, në mënyrë që këta fëmijë të ndjekin mësimet e klasës që i përkasin dhe të mos kenë prapambetje kur të kthehen në shkollë pas daljes nga spitali.
- Për herë të parë, u realizua tërheqja masive e mendimit të mësuesve, komunitetit të prindërve dhe grupeve të tjera të interesit lidhur me vlerat dhe problematikat që ka e gjithë gama e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar në përdorim. Në përfundim, u administruan vërejtjet të detajuara të natyrës shkencore, gjuhësore dhe metodike. MAS u kërkoi botuesve përkatës të ndreqin vërejtjet dhe t’i reflektojnë ato në ri-shtypjet për vitin shkollor 2014–2015. Si rezultat i punës së bërë u arrit që numri i titujve që do të përdoren në vitin shkollor 2014–2015, të ulet me 120, krahasuar me numrin e titujve që përmbante katalogu i vitit shkollor 2013–2014. Procesi i mësipërm zbuloi dhe shtroi si domosdoshmëri reformimin e krejt sistemit të deritanishëm të sigurimit të teksteve të arsimit parauniversitar.
- Në kuadër të rishikimit të kurrikulës së arsimit parauniversitar u hartua korniza kurrikulare dhe Kurrikula përkatëse. Kurrikula e re pilotohet në 26 shkolla 9-vjeçare pranë DAR-ve. Në vitin shkollor 2014-2015 filloi zbatimi i kurrikulës së re në çdo DAR. Janë përfshirë një shkollë në qytet dhe një në fshat. Në pilotim janë përfshirë 500 mësues, të cilët janë trajnuar për kurrikulën e re në korrik dhe shtator 2014. Këta mësues do të shërbejnë si bërthamë për trajnimin e mësuesve të tjerë që priten të përfshihen në pilotim. Pilotimi realizohet për klasën përgatitore, klasën e parë dhe klasën e gjashtë. DAP koordinon dhe monitoron këtë proces. Hartimi i kornizës së re kurrikulare të arsimit parauniversitar (K-9) dhe unifikimi i kësaj kornize me KK të Kosovës.
- Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara realizohet në disa forma: Në institucione të veçanta siç janë institutet kombëtare. Në klasa të veçanta brenda shkollave 9-vjeçare. Në “Qendra ditore”, të specializuara; Në kopshte dhe klasa normale të arsimit bazë, ku ka të integruar përkatësisht 320 dhe 2000 fëmijë më AK.

Në programin “Arsimi Bazë” janë parashikuar 14 produkte, ecuria e 11 prej të cilëve në përgjithësi rezulton e kënaqshme, në terma vlerore dhe sasiore. Kështu përmendim furnizimin me pajisje të shkollave dhe kopshteve të reja dhe të rehabilituara; rehabilitimi i kopshteve dhe shkollave për rritjen e aksesit të fëmijëve 5-vjeçar me 10 për qind dhe fëmijëve 3-4-vjeçar; ndërtimi i shkollave/kopshteve të reja për fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor; shpenzimet e

transportit të mësuesve dhe nxënësve; trajnimi i mësuesve të arsimit bazë, për përdorimin e laboratorëve shkencore, për zhvillimin e kompetencave profesionale, si dhe implementimin e kurrikulave të reja apo ngritjen profesionale të tyre.

Programi “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014 në këtë program që përfaqëson rreth 15.1 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara është rreth 93.7 për qind. Krahasuar me planin vjetor realizimi sipas zërave kryesore rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korrente | 96.7 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 81.1 për qind |
| Gjithsej | 93.7 për qind |

Objektivat kryesore të këtij programi zërthehen si më poshtë:

- Rritja e mëtejshme e cilësisë së mësimdhënies, me qëllim që, deri në vitin 2018 të përafrohemi me standardet e vendeve të BE. Përmirësimi i standardeve të infrastrukturës në gjimnaze, 8-10 për qind e klasave ndaj totalit ekzistues që do të rehabilitohen, 5-8 për qind e klasave ndërtohen të reja, 8-10 për qind e shkollave do të pajisen me laborator shkencorë.
- AMP ta ndjekin 75 për qind e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, ndërsa 25 për qind të ndjekin arsimin profesional. Shtim të laboratorëve TIK, si dhe shtrirje e internetit. Përmirësim i standardeve të infrastrukturës në gjimnaze, 8-10 për qind e klasave do të rehabilitohen, 5-8 për qind e klasave do të ndërtohen të reja, 8-10 për qind do të pajisen me laborator shkencor (CBA), si dhe do të bëhet pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.
- Trajnimi i 10-15 për qind e punonjësve mësimorë, për zbatimin e kurrikulës së gjimnazit.
- Krijimi i kushteve për realizimin e maturës shtetërore për afro 40-42 mijë maturantë, hartimi i testeve për provime, procesi i dhënies së provimeve, vlerësimeve të provimeve, deri në shpalljen e rezultateve.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2014

- Në vitin shkollor 2014/15, rreth 92 për qind e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar u regjistruan në arsimin e mesëm, çka tregon se objektivi i kësaj qeverie, sipas të cilit çdo nxënës që përfundon arsimin e detyruar duhet të ketë mundësi reale për të vijuar arsimin e mesëm është realist dhe në rrugë të mbarë të realizimit të tij.
- Në arsimin e mesëm të përgjithshëm, vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 4 provime për rreth 42-45 mijë maturantë (2 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje).
- Në kurrikulën e arsimit të mesëm të përgjithshëm është shtuar si lëndë me zgjedhje këtë vit, lënda “Financat Personale”, e cila realizohet në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Shqipërisë që ofron ekspertizën dhe trajnon mësuesit përkatës në shkollat e mesme. Është aktualisht në proces përgatitja e programit modular për lëndën e Sipërmarrjes përfshirë në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm, në funksion të përgatitjes për tregun e punës.
- Shkolla Qendër Komunitare “Shkolla qendër komunitare - një shkollë miqësore për të gjithë” është nismë që synon përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës në shkollë duke e kthyer atë në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet, përtej orëve të mësimin. Nisma, në vitin shkollor 2013-2014 u shtri në 66 shkolla në shkallë vendi – 35 në arsimin bazë dhe 31 në arsimin e mesëm dhe atë profesional. Nisma mbështetet mbi standarde të

miratuara nga MAS. Ajo është e koordinuar në të gjitha nivelet. Nisma mbështetet nga institucione dhe organizata, partnerë të MAS në këtë nismë si: Këshilli Evropës, UNICEF, “Korpusi i Paqes”, “World Vision”, Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, “Save the Children”, “Këshilli Britanik”, “Terre Des Homme”, etj. DAR/ZA dhe shkollat pjesë të kësaj nisme për vitin shkollor 2013-2014 realizuan: Veprimtari në kuadrin e gjithëpërfshirjes në arsim, me komunitetin rom, fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbim psikologjik.

- Veprimtari sportive të gjitha llojeve të sporteve në mjediset aktuale, por dhe në veprimtari rajonale apo të pushtetit vendor; Veprimtari kulturore, artistike; Bibliotekat në funksion të të gjithëve; Veprimtari për mbrojtjen e mjedisit.
- Mbështetje rajonale për arsimin gjithëpërfshirës, në muajin shtator 2014 shkollave iu shpërnda udhëzuesi i përgatitur për këtë qëllim nga ekspertë të IZHA-s. 7 shkolla pjesë e projektit rajonal “Mbështetje rajonale për arsimin gjithëpërfshirës” tashmë edhe pjesë e këtij projekti kanë përfituar grante shkollore nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës për projekte të hartuara në këtë fushë. Përmes këtij projekti një rëndësi parësore do t’i jepet arsimit të mesëm dhe atij profesional. U realizua financimi i mësuesve, të cilët do të japin kontribut në këtë nisme.
- Për vitin 2014 në programin e arsimit të mesëm, u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 300 praktikantë konform VKM nr.231, datë 23.4.2014 “Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhat 1 janar -15 qershor 2014 dhe 15 shtator-31 dhjetor 2014, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”.
- Për herë të parë në vitin 2014, janë dhënë shpërblim për 886 nxënës me 5 000 lekë duke përfituar rreth 4.4 milionë lekë.
- Sfida kryesore në arsimin e mesëm të përgjithshëm vazhdon të mbetet cilësia me standarde bashkëkohore dhe përafrimi i kurrikulës së klasës 10-12 në përputhje me tregun e punës.

Në programin “Arsimi i mesëm i Përgjithshëm” janë parashikuar 12 produkte, ecuria e 10 prej të cilëve në përgjithësi rezulton e kënaqshme, në terma vlerore dhe sasiore. Kështu përmendim shkolla/klasa të pajisura me mobileri; ndërtimi i shkollave të reja sipas standardeve evropiane; shkolla në arsimin e mesëm të rehabilituara/ zgjeruara; sigurimi i internetit për nxënësit AMP.

Programi “Arsimi i mesëm profesional”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014 në këtë program që përfaqëson rreth 5.5 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara, është në masën 94.4 për qind. Krahasuar me planin vjetor, realizimi paraqitet si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korente | 94.8 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 91.3 për qind |
| Gjithsej | 94.4 për qind |

Objektivat kryesore të këtij programi zbërthehen si më poshtë:

- Të regjistrohen 25 për qind nga totali i nxënësve që regjistrohen në arsimin e mesëm. Rritja e regjistrimeve në klasën e X-të me 8-10 për qind ndaj vitit paraardhës.
- Oferta e profesioneve të përputhet me kërkesat e tregut, vlerësuar me rritje 5 për qind e nxënësve të punësuar, (mbas 6 muajsh të përfundimit të shkollës) për çdo vit të PBA. Kjo bëhet e mundur edhe me përfundimin e pilotimit dhe masivizimit të modulit “Moodle” (pjesë e portalit të AP), ku nxënësit dhe mësuesit shkëmbejnë eksperiencë, materiale mësimore, etj.

- Rritja e numrit të nxënësve edhe nga zonat rurale të vendit duke i mbështetur me politika favorizuese e sociale. Favorizimi i nxënësve në nevojë dhe sidomos për ato në degët: Bujqësi, Blegtori e ndërtim, Gjeologji dhe teknik përmes dhënies së 1600-1650 bursave të reja për çdo vit të PBA.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies, nxënies dhe kushteve të shkollave e konvikteve (përfitues afro 20 000 nxënës), përmes pajisjes së 3 shkollave me laboratorë dixhitalë të gjuhëve të huaja, 5 shkollave me laboratorë virtual, instalimit të 5 laboratorë për lëndët: Kimi-Biologji, Fizikë dhe Informatikë, krijimit të 4 kabineteve të reja të Elektro-teknikës, Mekanikës; pajisjes së 4 shkollave artistike me mjete pune, etj; si dhe tërheqjes e kualifikimit të mësuesve e specialistëve të kualifikuar.
- Akreditimi i 5 shkollave dhe përputhja e kurrikulave me Kornizën evropiane të kualifikimeve, përmes rishikimit të 50 skelet-kurrikulave profesionale për klasat: 2, 3, 4 dhe i skelet-kurrikulave të reja profesionale e social-kulturore për klasat: 2, 3, 4; Hartimi i 10 programeve për lëndët profesionale e social kulturore.
- Mbështetje financiare për nxënësit (rreth 2 260), që kryejnë praktika profesionale në biznes.
- Mbështetje financiare për kompletimin e nxënësve me tekste e manualëve të praktikave me kurrikula në përputhje me nivelin e pestë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2014 konsistojnë në:

- Rritja në përqindje e numrit të nxënësve të regjistruar në vitin e parë të arsimit të mesëm profesional në krahasim me një vit më parë, si rrjedhojë e hapjes së degëve dhe profileve të reja si ato të IT, agro-përpunimit, bujqësisë e ushqimit, turizmit dhe shërbimeve;
- Përfundimi i ndërtimit të 4 shkollave të reja me kapacitet 700-800 nxënës secila, si dhe pajisja e tyre me laboratorë;
- Ngritja e një sistemi modern të informimit të nxënësve të arsimit të detyruar dhe prindërve të tyre.
- Transformi i shkollave profesionale në qendra të hapura gjatë gjithë ditës, ku do të mësojnë jo vetëm nxënësit e rregullt, por edhe të rinj, të cilët për shkaqe të ndryshme kanë filluar të punojnë, si dhe të rriturit që dëshirojnë të formohen në një profesion. Reformimi i arsimit profesional do të jetë prioriteti kryesor i ministrisë në kuadër të programit IPA të BE-së.
- Rritja e ofertave të kurrikulave dhe profileve në shkollat profesionale që reflektojnë kërkesat në tregun e punës, investimet në arsimin profesional kryesisht në rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin drejtimin tekniko-profesional, rritjen e cilësisë dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe laboratorike (punishtet për mësim praktik) në shkollat profesionale.
- Përfundimi i rindërtimit të 2 shkollave profesionale me fondet e Bashkimit Europian (IPA), ndërkohë vijojnë procedurat për pajisjen e 8 shkollave profesionale me fondet e Bashkimit Europian (IPA), si dhe fonde të buxhetit të shtetit.
- Vijon mbështetja me bursa për rreth 3500- 4000 nxënësve që ndjekin shkollat profesionale në degët bujqësi, ndërtim dhe pyje, si dhe mbështetja me prioritet për të gjithë nxënësit konviktorë të vijnë nga 16 rrethe të zonave veri-lindore dhe jug-lindore të vendit dhe ndjekin shkollat profesionale.
- Tekste shkolllore falas për të gjithë nxënësit e komunitetit romë dhe rimbursim 100 për qind për nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale, për vitin 2013 kanë përfituar kompesim financiar rreth 1500 nxënës dhe për vitin 2014 kanë përfituar tekste falas 1376 nxënës me vlerë 4.3 milionë lekë.

- Mbështetjen financiare nga projekti i Qeverisë së Konfederatës të Zvicrës, faza e tretë e projektit “Mbështetje për Arsim dhe Formim Profesional Shqiptar me fokus profilin e Termo-hidraulikës dhe IT”.
- Janë hartuar 3 skelet-kurrikula të nivelit II, janë hartuar 2 skelet-kurrikula të nivelit III, janë rishikuar 2 skelet-kurrikula që janë në zbatim, është hartuar Moduli pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike”, është hartuar Materiali mësimor për Modulin pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike”, janë përgatitur 3 paketa mësimore mbështetëse për zbatimin e lëndëve dhe moduleve profesionale të AP.

Në programin “Arsimi i Mesëm Profesional” janë parashikuar 12 produkte, të cilat janë realizuar plotësisht. Ndër produktet e realizuara gjatë vitit 2014, përmendim blerje pajisjesh për fuqizimin e bazave didaktike mësimore të zhvillimit të praktikës profesionale të shkollave të mesme në APT, ndërtime të reja për shtimin e kapaciteteve në arsimin profesional, trajnimi çdo vit i 15-20 për qind të punonjësve mësimore, për kurrikulat e reja në AFP dhe zhvillimin profesional, blerje pajisjesh dhe përmirësimi i infrastrukturës së konvikteve për shkollat e mesme profesionale.

Programi “Arsimi i lartë”

Ky program përfaqëson rreth 15.3 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara të kësaj ministrie. Krahasuar me planin vjetor, realizimi paraqitet si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|--------------------|
| • Shpenzimet korente | 99 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 79 për qind |
| Gjithsej | 98 për qind |

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve me 300, rritjen e numrit të laboratorëve shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre, duke rikonstruktuar e ngritur godina të reja për 15 000 studentë;
- Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit dhe implementimi i sistemit të krediteve për studentët e IAL-ve, bazuar në kualifikimin standard të sistemit të Bolonjës. Sigurimi i cilësisë në shërbimet që ofrojnë IAL përmes vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm të cilësisë;
- Zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë (AL) përmes: hapjes së rreth 30 kurrikulave të reja të MP/Msc dhe 10 programeve studimi me profile përkatëse të studimeve të Doktoratës, shtimit të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë me 13 për qind; shtimin me 5 për qind të numrit të studentëve në ciklin e dytë;
- Rritja e autonomisë së IAL përmes sigurimit të autonomisë akademike, strukturore, administrative dhe financiare. Diversifikim të burimeve të financimit, me qëllim optimizimin e investimit publik dhe privat në AL, në funksion të arritjes së objektivave të përgjithshme të AL. (Vlerësuar me rritje të ardhurave në përqindje ndaj PBB ose GDP për AL) ;
- Përgatitja e kuadrit ligjor dhe institucional për implementimin e reformës financiare në AL (formula e financimit, kredia studentore 2013-2015). Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjerë në AL nëpërmjet skemës së kredi-dhënies studentore dhe mbështetjes financiare për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e studentëve.

Arritjet kryesore për vitin 2014 konsistojnë në:

Për vitin akademik, 2013-2014, numri i pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ka shënuar një rritje të pranimeve, ndaj studentëve që janë regjistruar dhe ndjekur studimet për vitin akademik 2013-2014.

- Gjatë vitit ka një risi në politikëbërje përmes një procesi të veçantë që u ndoq për Reformën e Arsimit të Lartë. Kemi tashmë gati një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, e cila synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t'u arsimuar, nëpërmjet ngritjes së një Komisioni të pavarur, i cili mundësoi një proces të zhvilluar në transparencë të plotë, duke garantuar gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit, e aktorëve të AL-së pa asnjë përjashtim. Raporti përfundimtar i komisionit përfshiu të gjitha vëretjet konstruktive, ndaj u mirëprit edhe nga ata që reformën e panë në fillim me dyshim.
- Janë ndërmarrë hapat e duhur në rrugën e kthimit të autoritetit të ligjit në institucionet e arsimit të lartë dhe në drejtim të frenimit të rënimit të arsimit të lartë, si çelës i kthimit të besimit të publikut në IAL-të shqiptare, duke iniciuar procesin e Verifikimit të Kushteve të Ligjshmërisë në të gjitha IAL-të shqiptare, publike dhe private.
- Është realizuar vlerësimi paraprak dhe ka filluar puna për akreditimin e të gjitha IAL-ve me një agjenci britanike anëtare e ENQAS, brenda muajit dhjetor të këtij viti.
- Janë mbështetur studentë praktikantë dhe personel akademik për të studiuar jashtë vendit.
- Sistemi i sigurimit të cilësisë në AL është fuqizuar dukshëm.
- Angazhimi i ekspertëve të huaj si vlerësues në terren dhe si anëtarë të Këshillit të Akreditimit ishte një hap shumë i rëndësishëm për fuqizimin e Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit dhe njohjen e tyre të plotë nga Strukturat internacionale të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu janë fuqizuar njësitë e mbikëqyrjes së cilësisë dhe inspektimit brenda MAS dhe në APAAL. IKAP, në vitin e dytë të veprimtarisë së tij, shënoi hapa të rëndësishme të konsolidimit të tij.
- Gjatë vitit 2014, në kuadër të marrëveshjeve bilaterale e shkëmbimit të studentëve e kërkuesve të rinj është realizuar regjistrimi i 6 studentëve kinezë pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës dhe trajtimit të tyre me bursë, viti akademik 2013-2014.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin Histori-Filologji, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe me shtete të ndryshme organizojë kursin e verës të gjuhës dhe kulturës shqipe, ku morën pjesë studentë dhe pedagogë të huaj.
- Gjatë vitit 2014 janë proceduar rreth 990 diploma universitare të lëshuar jashtë vendit, ka përfunduar procedura e njohjes dhe njësimit. Ndërsa rreth 200 të tjera janë në proces njohjeje.

Në programin “Arsimi i Lartë ” janë parashikuar 11 produkte, ecuria e 8 prej të cilëve në përgjithësi rezulton e kënaqshme, në terma vlerore dhe sasiore. Kështu përmendim: përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve; krijimi i Laboratoreve IT, si dhe bibliotekave dixhitale për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në IAL, pajisje laboratorit, etj.; përmirësim i infrastrukturës ekzistuese të IAL dhe ngritja e godinave të reja; përgatitja e regjistrimit elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH.

Programi “Kërkimi Fundamental dhe Ekselencës”

Ky program përfaqëson rreth 0.4 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara për gjithë ministrinë. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014 për këtë program, krahasuar me planin vjetor paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet korente 95.2 për qind
- Gjithsej 95.2 për qind**

Objektivat kryesorë të këtij programi konsistojnë në:

- Rritje dhe zgjerim të kërkimit shkencor në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD; ku pjesa e shpenzimeve publike në vitin 2014 të arrijë 0,50 për qind të GDP (e përlllogaritur për IAL publike e private, ministritë e linjës, institucione të tjera kërkimore shtetërore, Akademia e Shkencave, si dhe nga bizneset), Përgatitja e Strategjisë së re për Kërkimin Shkencor 2015-2020.
- Nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3200 kërkuesve, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit, mbështetje financiare për funksionimin e mirëmbajtjen e laboratorëve didaktiko-kërkimorë në IAL publike. Aplikime dhe propozime projektesh për ngritjen e Qendrave të Ekselencës (përfshi të ardhurat e IAL publike dhe private).
- Vlerësim të Kërkimit Shkencor në Shqipëri, si dhe akreditimit të institucioneve dhe programeve të kërkimit (numri i programeve të vlerësuara do të rritet me 40 për qind në 2020 krahasuar me 2013).
- Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
- Pjesëmarrja në programin “Horizon 2020”, program për Kërkimin dhe Inovacionin (2014 - 2020). “Horizon 2020” do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet. “Horizon 2020” do të ketë tri shtylla kryesore: i) Shkencë -Ekselence, ii) Lidërsip industrial, iii) Sfidat shoqërore. Finalizimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e kërkimit dhe teknologjisë.
- Reformim i konceptit të Fondit të Ekselencës, me qëllim rritjen e efektivitetit të financimit dhe rikthimin e shpejtë të përfitimit të Shqipërisë dhe të “*Brain Gain*” duke ndryshuar konceptin në “*Brain Circulation*” për të mundësuar kontributin e një kategorie më të gjerë profesionistësh për vendin. Mbështetja financiare për 50 studentët në 15 universitetet më të mira të botës (Lista Shangai ose FT) dhe doktorantë ekselentë, si dhe ekselentë apo të punësuar në kuadër të programit “*Brain Gain*”.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2014 janë:

- Promovimi i Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet Konferencave dhe Seminareve të organizuara nga MAS si dhe IAL publike. Për vitin akademik 2014-2015, aplikuan pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 7 aplikantë të ndërmjetëm (të cilët janë shpallur fitues në vitet akademike paraardhëse), për vazhdimin e mbështetjes financiare për kryerjen e studimeve. Në përfundim të fazave përzgjedhëse, u kualifikuan si fitues 4 aplikantë dhe u nënshkruan akt-marrëveshjet.

Për vitin 2013-2014 janë përfituar nëntë projekte TEMPUS me vlerë 3.8 milionë Euro, të cilët po zbatohen nga universitetet shqiptarë ose në partneritet me universitete të tjerë. Përsa i përket projekteve TEMPUS aktualisht janë duke u zhvilluar projektet TEMPUS 2012 dhe TEMPUS 2013.

Programi për Zhvillimin e Sportit

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2014 në këtë program që përfaqëson rreth 2 për qind të totalit të shpenzimeve të realizuara është rreth 99 për qind. Krahasuar me planin vjetor realizimi sipas zërave kryesore rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korente | 98.8 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 99.9 për qind |
| Gjithsej | 99.0 për qind |

Objektivat kryesorë të këtij programi konsistojnë në:

- Rishikimi i formës së financimit në sistemin sportiv kombëtar në përputhje me ligjin e Sportit, me synim respektimin e pavarësisë së tyre funksionale si organizata jofitimprurëse, në kuadër të mirëmenaxhimit të fondeve publike që do të kenë në dispozicion këto organizata sportive duke respektuar mirëadministrimin, disiplinimin dhe përdorimin me eficiencë të fondeve.
- Rritja e mbështetjes financiare për aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive për të gjitha disiplinat sportive, sipas kalendareve të aktivitetet në 38 Kampionate Kombëtare dhe 38 Kupa të Shqipërisë, 38 Kampionate Evropiane, si dhe 38 Kampionate Botërore.
- Rishikimi i Statusit dhe rritja e mbështetjes financiare të sportistëve elitare, duke përcaktuar standardet e arritjeve/titujve/rekordeve dhe medaljeve, si dhe masën e shpërblimit të sportistëve që do të arrijnë rezultate në aktivitetet ndërkombëtare.
- Reformimi i këshillave konsultative të Sportit, Mbështetja e Agjencisë së Shërbimit të Sportit në përmirësimin e infrastrukturës së objekteve që ajo ka në administrim.
- Krijimi i kushteve për rishikimin e formës dhe funksionimit të Klubeve Sportive.
- Mbështetje financiare e aktivitetet të ekipeveve sportive përfaqesues të shkollave në disiplina të ndryshme, me synim hedhjen e bazës për krijimin e shoqatave sportive shkollore.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2014 janë:

- Është realizuar ndryshimi në skemën e financimit të sportit referuar nenit 10/1 të ligjit nr.9376, datë 21.04.2005, i ndryshuar, me Udhëzimin e Përbashkët nr.4 datë 11/3/2014 të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave “Për mënyrën e përdorimit të fondit grand/ transfertë korente e brendshme për federatat dhe Komitetin Olimpik shqiptar”.
- Është realizuar shpërblimi për 3 sportistë Elitar gjatë vitit 2014 për medaljet e fituara në aktivitetet ndërkombëtare.
- Është realizuar mbështetje e veçantë e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes për grumbullimin dhe pjesëmarrjen e Ekipit Kombëtar Meshkuj +Femra në kampionatin botëror.
- Është realizuar mbështetja financiare për 20 federatave sportive me fond për zhvillimin e aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Është realizuar me VKM, riorganizimi i Agjencisë së Shërbimit të Sportit, si në aspektin teknik, ashtu dhe atë administrativë.
- Është realizuar financimi për ristrukturimin e Parkut Olimpik të Tiranës me vlerë 600 milionë lekë.
- Gjithashtu është realizuar bashkëfinancimi për ristrukturimin e Stadiumit “Elbasan Arena”, së bashku me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe Bashkinë Elbasan, një investim ky i rëndësishëm i ndërtuar brenda standardeve të përcaktuara nga UEFA-FIFA për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

5.5 MINISTRIA E SHËNDETËSISË

MISIONI

Ministria e Shëndetësisë ka si mision realizimin e politikës shëndetësore të programit të Qeverisë. Ministria e Shëndetësisë harton politikën shëndetësore në shkallë vendi, përcakton zhvillimin dhe planifikimin e shërbimit shëndetësor në nivel kombëtar dhe sipas zonave. Harton legjislacionin që përcakton marrëdhëniet në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së shëndetit dhe zbaton me rigorozitet legjislacionin në fushën e shëndetësisë. Harton strategjinë e zhvillimit shëndetësor dhe taktikat e vënies në jetë të programit të Qeverisë. Studion dhe harton programin e investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së shërbimit shëndetësor. Kryen drejtimin operativ të shërbimit shëndetësor në shkallë kombëtare dhe sipas zonave.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Shëndetësisë për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas katër programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

Realizimi i Buxhetit 2014

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2014 për çdo program dhe në total, për gjithë Ministrinë e Shëndetësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<i>Ne mijë lekë</i>				
NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	240.428	209.966	87.3
2	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8.760.078	8.742.672	99.8
3	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	22.979.513	22.544.302	98.1
4	Shërbime të Shëndetit Publik	2.652.260	2.474.479	93.3
TOTALI		34.632.279	33.971.419	98.1

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Nga sa më sipër rezulton se rreth 98.5 për qind të totalit të shpenzimeve faktike të vitit 2014, janë përdorur në programet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Arritja 100 për qind e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Plotësimi 100 për qind i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë sipas matricës së projekt-akteve për vitin 2014.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program, që përfaqëson vetëm rreth 0.6 për qind të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie, krahasuar me planin vjetor, sipas zërave kryesore rezulton si më poshtë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| • Shpenzime korente | 87.3 për qind |
| • Shpenzime kapitale | 91.1 për qind |
| Gjithsej | 87.3 për qind |

Në programin e “Planifikim, administrim dhe menaxhim” janë parashikuar 3 produkte, të cilat kanë performancë të mirë realizimi, në sasi dhe në vlerë.

Programi “Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor”

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Përmirësimin e ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 435 që ishin në 2013, në 477 barna në vitin 2014,
- Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2014 me 0.4/1000 krahasuar me vitin 2013,
- Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100.000 në vitin 2013 krahasuar me 19 për 100.000 që është në vitin 2013,
- Trajtimi i personelit për ofrimin e programit të Kontrollit Mjekësor periodik 40-65 vjeç (1700 mjekë dhe 6600 infermierë).
- Plotësimi i qendrave shëndetësore në masën 100 për qind me pajisje mjekësore standarde për kontrollin bazë.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program që përfaqëson rreth 25.7 për qind të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie, krahasuar me planin vjetor sipas zërave kryesore rezulton, si më poshtë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| • Shpenzime korente | 99.8 për qind |
| • Shpenzime kapitale | 96.3 për qind |
| Gjithsej | 99.8 për qind |

Në programin e kujdesit shëndetësor parësor janë parashikuar 9 produkte, 8 nga të cilat janë realizuar plotësisht dhe 1 produkt është realizuar pjesërisht. Ndër produktet e realizuara përmendim pacientët e trajtuar me HIV/AIDS, ndërtime e konstruksione për godinat e kujdesit shëndetësor parësor, sigurimi i mbulimit me barna për popullsinë.

Niveli i realizimit të investimeve për këtë program është rreth 96.3 për qind në total, nga i cili investimet me financim të brendshëm janë realizuar në rreth 92.5 për qind, ndërsa ato me

financim të huaj në rreth 86 për qind. Në këtë nivel të realizimit të investimeve me financim të brendshëm të këtij programi ka ndikuar mosrealizimi i vlerës së akorduar për ndërtimin e qendrës shëndetësore Divjakë, ndërsa në atë me financim të huaj mosrealizimi i vlerës për ndërtimin e qendrave shëndetësore nga fondacioni “Mirësia”.

Programi “Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor”

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Mbulim 88 për qind i nevojës për shërbim spitalor në vitin 2014 krahasuar me 85 për qind që janë plotësuar në vitin 2013.
- Plotësim 80 për qind i nevojave të spitaleve me pajisjet e domosdoshme për shërbimin e imazherisë, në vitin 2014, referuar 75 për qind që plotësohen në vitin 2013.
- Plotësim në masën 74 për qind të nevojave të spitaleve me infrastrukturë ndërtimore në vitin 2014 krahasuar me 72 për qind në vitin 2013.
- Financim i 5 (pesë) paketave të shërbimeve.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program që përfaqëson rreth 66.4 për qind të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie, krahasuar me planin vjetor, sipas zërave kryesore, rezulton si më poshtë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| • Shpenzime korente | 98.1 për qind |
| • Shpenzime kapitale | 97.8 për qind |
| Gjithsej | 98.1 për qind |

Në programin e kujdesit shëndetësor dytësor janë parashikuar 11 produkte, 9 prej të cilave janë realizuar sipas planifikimit në terma sasiorë dhe vetëm 2 produkte janë realizuar pjesërisht. Këtu përmendim realizimin e trajtimit të rreth 260 mijë pacientëve të shtruar në spitale, mbulimin financiar të 1400 vizitave në Spitalin Psikiatrik. Në lidhje me produktin për furnizimin me pajisje mjekësore për Spitalin Onkologjik konstatojmë se gjatë vitit 2014, nuk janë blerë pajisjet e planifikuara për këtë qëllim.

Niveli i realizimit të investimeve në total për këtë program është rreth 97.8 për qind, rrjedhojë kjo e realizimit prej rreth 97.6 për qind të investimeve me financim të brendshëm dhe rreth 98.9 për qind të investimeve me financim të huaj.

Programi “Shërbime të shëndetit publik”

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Sigurimi i qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinale për vaksinat e kalendarit të vaksinimit, në masën 95 për qind.
- Reduktimi i numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit në jo më shumë se 3 në vit, në vitin 2014, krahasuar me mesatarisht 4 në periudhën 2007-2009.
- Monitorimi i agjentëve mjedisorë në vitin 2014 me 350 ekspertiza krahasuar me 300 inspektime në vitin 2013.
- Sigurimi i kryerjes së 2400 inspektimeve shëndetësore në vitin 2014 krahasuar me 2200 inspektime në vitin 2013.
- Reduktimi me 50 për qind i qarkullimit të vektorëve (mushkonjave) në fazën larvare të zhvillimit në zonat ligatinore të vendit.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program që përfaqëson rreth 7.3 për qind të totalit të shpenzimeve faktike të kësaj ministrie, krahasuar me planin vjetor sipas zërave kryesore rezulton si më poshtë:

- Shpenzime korentë 95.1 për qind
- Shpenzime kapitale 35.7 për qind
- Gjithsej 93.3 për qind**

Në programin e shëndetit publik janë parashikuar 5 produkte, nga të cilat 4 produkte janë realizuar plotësisht sipas planifikimit në terma sasiorë. Janë realizuar produktet, blerje dhe monitorim të vaksinave, është realizuar monitorimi i situatave epidemiologjike, blerje pajisje mjekësore për laboratorët e shëndetit publik, si dhe ndërtime e rikonstruksione të ambienteve, ndërsa blerja e pajisjeve kompjuterike të reja për laboratorët e shëndetit publik.

Niveli i mosrealizimit të investimeve në total për këtë program është rreth 35.7 për qind, rrjedhojë kjo e mosrealizimit të blerjes së pajisjeve mjekësore të veçanta për gatishmërinë dhe përballimin e rrezikut nga virusi Ebola.

Shpenzimet kapitale me burim financimin e huaj, që për vitin 2014 ishin parashikuar në rreth 376 milionë lekë dhe realizuar në rreth 374 milionë lekë, sipas programeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor	33.720	35.328	104.7
2	Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor	342.221	338.367	98.9
	Totali	375941	373695	99.4

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në programin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor theksojmë se:

- Për projektin ndërtime, rikonstruksione dhe pajisje të qendrave shëndetësore dhe ambulancave, (Gjysmë Hëna e Kuqe) gjatë vitit 2014 disbursimi ishte në rreth 17.3 milionë lekë. Janë kryer investime për ngritjen e 9 ambulancave, ku krahas përfundimit të punimeve, investimi është shoqëruar edhe me furnizim pajisjesh mjekësore.
- Për projektin “Fuqizimi i përgjigjes kombëtare ndaj HIV/AIDS” (Global Fund) disbursimi gjatë vitit 2014 arriti në rreth 16,1 milionë lekë, nga 9.7 milionë i parashikuar, me një realizim prej rreth 165 për qind. Është mundësuar sigurimi me terapi mbajtëse për 474 përdorues droge, duke realizuar kështu edhe objektivin e këtij projekti.

Në programin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor theksojmë se:

- Për projektin e informatizimit të sistemit shëndetësor E-HEALTH (kredia austriake), ratifikuar nga Parlamenti në korrik 2014, është investimi më i madh i teknologjisë së informacionit në sektorin shëndetësor. Gjatë vitit 2014 është kryer pagesa e parapagimit të 15 për qind të kontratës, në rreth 294 milionë lekë.
- Për projektin e furnizimit me pajisje mjekësore komplekse të Spitalit Onkologjik, QSUT “Nënë Tereza”, kredia austriake, tashmë është ratifikuar nga parlamenti dhe paguar paradhënia prej 15 për qind e vlerës së kontratës. Por instalimi i Akseleratorit Linear është i

lidhur me ndërtimin e bunkerit respektiv, i cili përfundon në muajin Gusht 2015 dhe brenda këtij muaji do të bëhet edhe instalimi i pajisjes.

5.6 MINISTRIA E DREJTËSISË

MISIONI

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Drejtësisë, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas tetë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Deri në fund të vitit 2014 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve faktike të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Programit	Përqindja e realizimit të shpenzimeve kundrejt planit të vitit 2014 (%)
Planifikim, menaxhim dhe administrim	80.2
Publikimet Zyrtare	88.1
Mjekësia Ligjore	99.6
Sistemi i Burgjeve	98.3
Shërbimi i Përmbartimit gjyqësor	86.7
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	82.7
Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	81.6
Shërbimi i Provës	99.8
TOTALI	90.8

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i treguesve buxhetorë, është në shifra relativisht të mira. Duke iu referuar shifrave vihet re një realizim optimal i shpenzimeve të fondeve buxhetorë, pothuajse në të gjithë programet. Përjashtim bën programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, situata në fund të vitit 2014 paraqitet e tillë:

Emërtimi i Programit	Shpenzime korrente (në %)	Shpenzime kapitale (në %)
----------------------	---------------------------	---------------------------

Planifikim, menaxhim dhe administrim	92.0	77.7
Publikimet Zyrtare	88.1	97.1
Mjekësia Ligjore	99.5	99.9
Sistemi i Burgjeve	98.3	84.0
Shërbimi i Përmbartimit gjyqësor	91.8	17.0
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	82.8	73.3
Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	81.7	32.8
Shërbimi i Provës	99.8	100.0
95.8	TOTALI	77.6

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Lidhur me shpenzimet korente, vërejmë që përveç programit të “Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” dhe “Shërbimi për Çështjet e Birësimit”, për të gjithë programet e tjera përqindja e realizimit paraqitet në vlerat shumë të larta 88-100 për qind.

Po ashtu realizimi i shpenzimeve kapitale për 5 nga 8 programet e Ministrisë së Drejtësisë është në masën rreth 78-100 për qind, që konfirmon një realizim të kënaqshëm.

Problematika e Buxhetit 2014

Për vitin 2013 për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet në varësi, për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore, janë mbartur detyrimeve të prapambetura në vlerë totale rreth 229.4 milionë lekë. Programi buxhetor më i prekur nga mungesa e theksuar e fondeve ka qenë sistemi i burgjeve, me një vlerë totale detyrimesh financiare të mbartura prej rreth 106.8 milionë lekë, nga të cilat investime 6.6 milionë lekë dhe shpenzime operative 100.2 milionë lekë te cilat konsistojnë në detyrime për energjinë elektrike. Në vitin 2014, të gjitha detyrimet për energji elektrike janë shlyer.

Ministria e Drejtësisë (për tre-mujorin e katërt të vitit 2014) deklaroi lindjen e detyrimeve në vlerën totale prej 24.5 milionë lekë të cilat janë detyrime të lindura nga vendimet gjyqësore: (i) në aparatit e Ministrisë së Drejtësisë në vlerën rreth 11 milion lekë, (ii) Agjensinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në vlerën 13.5 milionë lekë. Këto detyrime do të trajtohen sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1 datë 4.06.2014 dhe nuk konsideron sipas konceptit të detyrimeve të krijuara rishtazi.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Në programin “Planifikim, menaxhim, administrim janë parashikuar **16 produkte**, të cilat për periudhën vjetore janë realizuar plotësisht 14, 1 produkt është realizuar pjesërisht, ndërsa 1 produkt nuk është realizuar fare. Kështu, u realizuan plotësisht sipas parashikimit të periudhës, produktet “personeli i Aparatit të Ministrisë”, “Inspektime në Prokurori, inspektime në Gjyqësor, Administrativ dhe në Pronësi”, nga rreth 32 inspektime të parashikuara, u realizuan 125 inspektime, vlen për t’u theksuar se për inspektimet në institucionet e varësisë dhe në profesionet e lira, janë kryer inspektime me shtrirje në zyra përmbartimore, noterie dhe institucione vartëse; produkti “Akte ligjore e nënligjore të hartuara”, janë përgatitur 77 akte ligjore e nënligjore, nga rreth 42 të parashikuara. Nga 4500 raste të parashikuara për përfaqësim të avokatëve të shtetit në

çështjet gjyqësore, janë realizuar 5 882 përfaqësime, si edhe është dhënë “asistencë juridike dhe këshillim” nga avokatët e shtetit.

Produkti “Ndihmë juridike për individët përfitues” është realizuar në terma financiarë dhe sasiorë, nga Komisioni i Ndihmës Juridike. Është parashikuar ofrimi i ndihmës juridike, këshillimit dhe mbrojtjes në proceset penale aferisht për 60 raste për vitin 2014, janë realizuar 93.

Për Agjensinë e Mbikqyrjes së Falimentit, janë parashikuar 2 produkte për vitin 2014, “Licencimi i administratorëve të falimentit” dhe “Mbikqyrja e administratorëve. Gjatë vitit ka vazhduar puna për liçensimin e specialistëve të ofruar, janë trajnuar sipas legjislacionit të përcaktuar dhe janë mbikqyrur 6 administratorë, nga 10 të planifikuar.

Në programin “Publikimet Zyrtare” janë parashikuar pesë produkte. Për periudhën vjetore, produkti “Publikimi i fletores zyrtare”, është tejkualuar nga 220 fletore zyrtare të planifikuara janë realizuar 289. Produkti “Përditësimi i legjislacionit”, u realizua plotësisht, nga 200 ligje u përditësuan 200. Produktet “Publikimi i Buletinit të njoftimeve” dhe “Botime të tjera” nuk janë realizuar fare. Produkti “Publikimi në internet” është realizuar pjesërisht, pasi plani ishte 420 botime dhe janë publikuar në internet 289 botime.

Në programin “Mjekësia Ligjore” janë parashikuar 8 produkte, “Aktet e ekspertimit mjeko – ligjor”, “Aktet Dëshmi-Ligjore”, “Aktet ekspertimi Toksikologjiko–Ligjor”, “Aktet ekspertimi Psikiatriko-Ligjor”, “Aktet ekspertimi Mjeko-Ligjor” (autopsi), “Aktet ekspertimi Biologjiko-Ligjor”, “Aktet ekspertimi Histopatologjiko-Ligjor” dhe “Menaxhimi i punës në institut”, i cili është realizuar plotësisht, me rreth 12 000 akte të planifikuara dhe me rreth 12 870 akte të përfunduara. Për vetë natyrën e punës së Institutit të Mjekësisë Ligjore, nuk mund të parashikohet me saktësi sa do të jetë nr. i akteve të ekspertimit, ku përfshihen aktet Mjeko-Ligjore, Biologo-Ligjore, Psikiatriko-Ligjore, Toksikologo-Ligjore dhe Autopsitë. Pra nuk është e mundur që të bëhet një parashikim i saktë në lidhje me numrin e autopsive, vizitave ambulatorë të personave të dëmtuar nga ushtrimi i dhunës mbi ta, nga traumat automobilistike etj. Produkti “Menaxhimi i punës në institut”, është realizuar plotësisht.

Në programin “Sistemi i burgjeve janë parashikuar 9 produkte, për aktivitetin kryesor të burgjeve. Të gjitha produktet “mbajtja e të burgosurve dhe p/burgosurve në kushte sigurie nga trupa policore”, “të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor”, “trajtimi me normë ushqimore i të dënuarve dhe p/burgosurve”, “ marrja e informacionit dhe të dhënave statistikore në kohë reale nga të gjitha I EVP”, “etj., janë realizuar plotësisht.

Në programin “Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor” janë parashikuar 2 produkte për vitin 2014, “Ekzekutimi i titujve ekzekutivë” dhe “Menaxhimi i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”. Janë ekzekutuar 8 555 tituj ekzekutivë, nga 9 680 të planifikuara në fillim të vitit. Produkti i dytë është realizuar plotësisht sipas parashikimit.

Në programin “Shërbimi për Çështjet e Birësimit” është parashikuar një produkt “Birësime të realizuara”, i cili është tejkualuar, nga 50 birësime të planifikuara për t’u kryer gjatë vitit 2014, janë realizuar 67 birësime. Theksojmë se, përfundimi i procedurës së birësimit, varet nga shumë faktorë, si gjykata, monitorimi i periudhës etj.

Në programin “Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” janë parashikuar 8 produkte, 7 nga të cilat janë me fondet buxhetore dhe 1 produkt i parashikuar me fondet jashtë buxhetore. Në lidhje me produktin “Vendime të marra nga shqyrtimi i kërkesave të subjekteve të shpronësuar, për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthim apo kompesim të pronës”, ministria raporton nje mosrealizim për këtë produkt, pra nga 550 vendime të parashikuara, nuk është realizuar asnjë vendim. Produkti “Vendime të trajtuara sipas procedurave të oborreve në përdorim dhe tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçantë, sipas kërkesave të subjekteve”, është realizuar pjesërisht (nga 250 vendime të parashikuara, janë realizuar 66). Ndërsa produkti “Subjekte të shpronësuara që përfitojnë nga shpërndarja e fondit të kompesimit në të holla (financiar) nga fondet buxhetore” nuk është realizuar aspak, pasi VKM-ja që përcakton mënyrën e shpërndarjes së fondit për vitin 2014 u miratua në Dhjetor dhe ky fond u kalua në fondin special të kompensimit për tu shpërndarë në vitin 2015. Produkti “Subjekte të shpronësuara që përfitojnë nga shpërndarja e fondit të kompesimit nga të ardhurat e ALUIZNI-t”, parashikuar me fonde jashtë buxhetore, është realizuar pjesërisht, janë kompesuar 648 pronarë, nga 800 të parashikuar për vitin.

Në programin “Shërbimi i Provës” janë parashikuar 2 produkte: “Mbikqyrja e të dënuarve”, i cili është realizuar plotësisht, nga 4 206 të dënuar të planifikuar për t’u mbikqyruar, janë mbikqyruar të 4 206 të dënuar me dënim alternativ, po kështu edhe produkti “Mirëfunksionimi i shërbimit të Provës”, është realizuar plotësisht sipas planifikimit. Për sa i përket zërit të investimeve janë realizuar dhe është bërë likuidimimi i detyrimit përkatës.

Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit

Për të 8 programet e kësaj Ministrie situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin e rishikuar sipas Aktiteve Normative dhe planin përfundimtar, të ndarë për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale, paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Shpenzime korrente 2014		
		Plani fillestar	Plani përfundimtar	Diferenca
1	Planifikim Menaxhim Administrim	333 700	405 923	72 223
2	Publikimet Zyrtare	49 750	44 813	-4 937
3	Mjekësia Ligjore	50 500	50 500	0
4	Sistemi i Burgjeve	3 777 240	3 946 113	168 873
5	Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor	104 480	101 530	-2 950
6	Shërbimi për Çështjet e Birësimeve	13 000	11 000	-2 000
7	Shërbimi i Kthimit e Kompensimit të Pronave	430 600	570 293	139 693
8	Shërbimi i Provës	116 200	100 650	-10 000
	TOTALI	4 875 470	5 236 372	360 902

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Shpenzime kapitale 2014		
		Plani fillestar	Plani përfundimtar	Diferenca
1	Planifikim Menaxhim Administrim	1 904 070	1 939 557	35 487
2	Publikimet Zyrtare	100	100	0
3	Mjekësia Ligjore	12 000	11 417	-583
4	Sistemi i Burgjeve	768 000	19 306	-748 694
5	Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor	1 000	7 500	6 500
6	Shërbimi për Çështjet e Birësimeve	200	200	0
8	Shërbimi i Kthimit e Kompensimit të Pronave	500	1.161	661
9	Shërbimi i Provës	100	88	-12
10	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1 904 070	1 939 557	35 487
	TOTALI	2 685 970	1 979 329	-706 641

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Totali		
		Plani fillestar	Plani përfundimtar	Diferenca
1	Planifikim Menaxhim Administrim	2 237 770	2 345 480	107 710
2	Publikimet Zyrtare	49 850	44 913	-4 937
3	Mjekësia Ligjore	62 500	61 917	-583
4	Sistemi i Burgjeve	4 545 240	3 965 419	-579 821
5	Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor	105 480	109 030	3 550
6	Shërbimi për Çështjet e Birësimeve	13 200	11 200	-2 000
8	Shërbimi i Kthimit e Kompensimit të Pronave	431 100	571 454	140 354
9	Shërbimi i Provës	116 300	106 288	-10 012
10	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	2 237 770	2 345 480	107 710
	TOTALI	7 561 440	7 215 701	-345 739

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Diferencat që rezultojnë në planin përfundimtar kundrejt buxhetit sipas planit fillestar, kanë ardhur si rezultat i disa vendimeve të Këshillit të Ministrave, zbatimit të Aktit Normativ nr. 1, datë 17.09.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014””, si dhe në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 29.12.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014””, të ndryshuar, shtesa fondesh të ardhura nga akordimi i fondit të veçantë për vitin 2014 apo kontigjenca e pagave.

5.7 MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

MISIONI

Forcimi dhe garantimi i rendit e sigurisë publike, individuale e komunitare do të përbëjë angazhimin parësor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili është: "Tolerancë zero ndaj krimit". Lufta kundër krimit të organizuar e trafikeve. Angazhimi në luftën kundër terrorizmit. Siguria rrugore. Decentralizimi dhe autonomia vendore nëpërmjet angazhimit maksimalisht në funksion të zgjerimit dhe thellimit të procesit të decentralizimit në dobi të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës së komuniteteve. Reformimi i ekzekutivit qendror dhe administrata publike. Administrata publike do të forcohet e konsolidohet sipas principeve të shërbimit publik, mbi bazën e meritës dhe të performancës. Statusi i nëpunësit civil do të shtrihet në pjesën më të madhe të organeve të administratës publike.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Punëve të Brendshme, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, e më konkretisht:

- Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”
- Programi “Policia e Shtetit”
- Programi “Garda e Republikës”
- Programi “Prefekturat dhe funksionet e deleguaratë Pushtetit Vendor”
- Programi “Shërbimi i Gjendjes Civile”
- Programi “Menaxhimi i Rezervave të Shtetit”
- Programi “Emergjencat Civile”

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri paraqitet si më poshtë:

Në milion lekë

	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	17,766	17,346	92.7%	92.2%	97.6%
1.1	<i>Personeli</i>	12,979	12,776	67.7%	67.9%	98.4%
1.2	<i>Operative</i>	4,787	4,570	25.0%	24.3%	95.5%
2	Shpenzime kapitale	1,397	1,381	7.3%	7.3%	98.8%
2.1	<i>Financim i brendshem</i>	1,205	1,197	6.3%	6.4%	99.3%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	192	184	1.0%	1.0%	95.8%
3	SHUMA	19,163	18,727	100.0%	99.6%	97.7%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		80	0.0%	0.4%	
4	TOTALI	19,163	18,807	100.0%	100.0%	98.1%

Burimi: Ministria e Financave(2015);

Sikurse mund të konstatohet nga tabela e mësipërme, masa e realizimit të buxhetit të vitit 2014, kundrejt buxhetit vjetor të miratuar është 97.7 për qind. Realizimi i shpenzimeve të korente renditet në rreth 97.6 për qind, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve paraqitet në nivelin 98.8 për qind, të planit vjetor. Nëse konsiderojmë edhe shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit, niveli i realizimit të buxhetit vjetor shkon në 98.1 për qind. *Në ecurinë e shpenzimeve korente ka ndikuar mosrealizimi i transfertave korente të huaja, të parashikuara në buxhetin e vitit 2014.*


Ndarja e fondeve buxhetore sipas programeve, dhe realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për çdo program buxhetor, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			% e realizimit total
	PLAN	FAKT	% F/P	PLAN	FAKT	% F/P	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,095	947	86.5	25	23	94.6	86.7
Policia e Shtetit	13,116	13,009	99.2	1,201	1,201	100.0	99.2
Garda e Republikës	1,221	1,218	99.7	84	83	99.4	99.7
Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara	713	641	90.0	10	13	133.3	90.5
Shërbimi i Gjendjes Civile	707	661	93.5	36	31	84.7	93.0
Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	116	96	82.4	6	6	100.0	83.3
Emergjencat Civile	799	774	97.0	36	24	66.4	95.7
TOTALI	17,767	17,346	97.6	1,398	1,381	98.8	97.7

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Shpenzimet faktike totale, për secilin program paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Të dhënat paraqiten në milionë lekë. Sipas të dhënave për realizimin e shpenzimeve për vitin 2014, konstatohet një realizim i mirë në terma relativë të shpenzimeve korente, që varion nga 82.4 për qind për programin e Menaxhimit të Rezervave të Shtetit, deri në 99.7 për qind për programin e Gardës së Republikës.



Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime dhe fakti i realizimit për vitin 2014, paraqiten në tabelën mëposhtme:

Kodi	Emërtimi i Programit	Struktura e Shpenzimeve në %		
		Buxheti Fillestar	Plani me ndryshime	Shpenz. Faktike
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4.9	5.8	5.2
03140	Policia e Shtetit	74.8	74.7	75.9
03150	Garda e Republikës	7.1	6.8	6.9
01160	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara	3.3	3.8	3.5
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	4.3	3.9	3.7
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	0.6	0.6	0.5
10910	Emergjencat Civile	4.9	4.4	4.3
	TOTALI	100	100	100

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Programi “Policia e Shtetit”, është programi më i madh buxhetor i MPB-së dhe zë 76 për qind të totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë vitit 2014. Më pas vjen programi “Garda e Republikës”, me rreth 7 për qind, “Planifikim Menaxhimi” me 5.2 për qind, “Emergjencat Civile” me 4.3 për qind, “Gjendja Civile” me 3.7 për qind, “Pushteti Vendor” me 3.5 për qind.

dhe në fund “Rezervat e Shtetit”, të cilat përbëjnë vetëm 0.5 për qind të shpenzimeve totale të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve në parashikimet sipas buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, ka ndryshuar lehtësisht në thuajse të gjitha programet, me një shmangie të vogël nga vlera sipas planit fillestar vjetor.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Në vijim paraqitet një përshkrim i politikës së programeve buxhetore, objektivave dhe produkteve të tyre për vitin buxhetor 2014.

Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin shpenzimet për aparatën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe fondet e alokuara për këtë program buxhetor, përbëjnë rreth 4.9 për qind të shpenzimeve totale të miratuara për MPB-në për vitin 2014. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se për tremujorin e katërt, shpenzimet për aparatën e MPB përbëjnë rreth 5.2 për qind të shpenzimeve totale .

Për vitin 2014, objektivat e këtij programi buxhetor janë:

- Sigurimi i menaxhimit eficient dhe efektiv i burimeve financiare.
- Përmirësimi i shërbimeve funksionale të teknologjisë informacionit dhe komunikimit.
- Krijimi i standardeve për kuadrin ligjor, marrëveshje dhe projekte.
- Hartimi i Regjistrit të Riskut dhe i strategjisë së minimizimit të tij.
- Përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit.

Për realizimin e këtyre objektivave, MPB ka alokuar rreth 1.1 miliardë lekë në terma vjetorë, përfshirë dhe fondet e çelura për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Në tremujorin e katërt të vitit 2014, **realizimi i planit të buxhetit** paraqitet në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	1,094,540	947,240	97.8%	91.9%	86.5%
1.1	<i>Personeli</i>	478,843	405,937	42.8%	39.4%	84.8%
1.2	<i>Operative</i>	615,697	541,303	55.0%	52.5%	87.9%
2	Shpenzime kapitale	24,779	23,440	2.2%	2.3%	94.6%
2.1	<i>Financim i brendshem</i>	24,779	23,440	2.2%	2.3%	94.6%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	1,119,319	970,680	100.0%	94.2%	86.7%
	<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</i>	0	59,945	0.0%	5.8%	
4	TOTALI	1,119,319	1,030,625	100.0%	100.0%	92.1%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse evidentohet edhe më sipër, shpenzimet korente përbëjnë rreth 98 për qind të shpenzimeve të parashikuara në këtë program buxhetor dhe brenda tyre vërehet se rreth 43 për qind e fondeve të këtij programi shpenzohen për pagat e personelit të aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërkohë që pjesa tjetër shkon për shpenzimet e tjera operative. Shpenzimet kapitale apo investimet publike zënë vetëm 2.2 për qind të totalit të shpenzimeve të planifikuara të këtij programi, dhe 2.3 për qind të shpenzimeve faktike.

Më tej, për realizimin e objektivave buxhetore të sipërcituar, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), ka parashikuar 11 produkte buxhetore, të cilat janë realizuar plotësisht për periudhën 1-vjeçare. Në raportin e hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme jepet informacion i hollësishëm mbi ndryshimin në planin e buxhetit të produkteve të parashikuara në këtë program, si pasojë e shtesave të fondeve gjatë vitit, konform kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, në këtë program buxhetor janë prezente edhe shpenzime nga ardhura jashtë limitit në vlerën 59.9 milionë lekë.

Policia e Shtetit

Programi “Policia e Shtetit”, përbën programin më të madh buxhetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 76 për qind të buxhetit të miratuar për këtë institucion në vitin 2014.

Programi i Policisë së Shtetit përmban disa nën-programe ku përmendim **hetimi i krimeve, siguria publike, sigurimi i kufirit dhe migracionit dhe trajnimi policor**. Për secilin nga këto drejtime, Ministria e Punëve të Brendshme, parashikon objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

- Në drejtimin e hetimit të krimeve, programi synon të sigurojë një shërbim investigativ që realizon parandalimin, hetimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale nëpërmjet aplikimit të masave, metodave, teknikave speciale të hetimit, si dhe zbatimin e kërkesave ligjore që kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë në vend, për paqe e një jetë më të mirë për qytetarët.
- Në drejtimin e sigurisë publike, programi synon të sigurojë rendin dhe qetësinë publike, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi, si dhe të garantojë një mjedis të sigurtë për komunitetin e në partneritet me të, nëpërmjet policimit me standardet më të larta të performancës.
- Në drejtimin e sigurimit të kufirit dhe migracionit, programi synon hartimin dhe zbatimin e politikave për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror duke bashkëpunuar me institucionet shqiptare dhe ato homologe të vendeve të tjera, në kuadër të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale.
- Në drejtimin e trajnimit policor, programi synon përfshirjen në trajnim në forma të ndryshme të gjithë personelit të policisë në përputhje me nevojat profesionale të organizatës, të njësisë ku bën pjesë punonjësi i policisë, funksionin, gradën, specialitetin dhe vlerësimin individual.

Për realizimin e këtyre qëllimeve, për vitin 2014, Ministria e Punëve të Brendshme ka alokuar në programin “Policia e Shtetit”, rreth 14.3 miliardë lekë, në terma vjetorë, dhe në tremujorin e katërt të këtij viti, realizimi i planit të buxhetit paraqitet në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

03140	Policia e Shtetit	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	13,116,095	13,008,583	91.6%	91.4%	99.2%
1.1	Personeli	10,030,226	9,984,714	70.1%	70.2%	99.5%
1.2	Operative	3,085,869	3,023,869	21.6%	21.3%	98.0%
2	Shpenzime kapitale	1,200,536	1,200,512	8.4%	8.4%	100.0%
2.1	Financim i brendshem	1,032,148	1,032,124	7.2%	7.3%	100.0%
2.2	Financim i huaj	168,388	168,388	1.2%	1.2%	100.0%
3	SHUMA	14,316,631	14,209,095	100.0%	99.9%	99.2%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	20,245	0.0%	0.1%	
4	TOTALI	14,316,631	14,229,340	100.0%	100.0%	99.4%

Burimi: Ministria e Financave(2015);

Sikurse evidentohet edhe nga tabela, shpenzimet korente përbëjnë rreth 91.6 për qind të totalit të fondeve të planifikuara, ndërkohë që investimet janë në nivelin 8.4 për qind të buxhetit. Më tej evidentohet se rreth 70 për qind e fondeve buxhetore të alokuara për MPB-në në vitin 2014, planifikohet të shpenzohen për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të Policisë së Shtetit. Nëse konsiderojmë shpenzimet faktike, kjo panoramikë nuk paraqet ndryshime substanciale. Këto fonde buxhetore shpenzohen për realizimin e qëllimeve të sipërcituara, nëpërmjet 75 produkteve buxhetore. Më specifikisht, në tremujorin e katërt të vitit, evidentohet se 72 prej tyre janë realizuar plotësisht dhe 3 nuk janë realizuar si pasojë e pakësimit të fondeve gjatë vitit 2014. Në tërësi, konstatohet një performancë e mirë realizimi për produktet të evidentuara në këtë program, ndërkohë MPB duhet të marrë masa për përmirësimin e emërtimit të produkteve buxhetore, në mënyrë që të mundësohet lidhja me objektivat e politikës së programit. Në raportin e hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme jepet informacion i hollësishëm mbi ndryshimin në planin e buxhetit të produkteve të parashikuara në këtë program, si pasojë e shtesave të fondeve gjatë vitit, konform kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, në këtë program buxhetor janë prezente edhe shpenzime nga ardhura jashtë limitit në vlerën 20.3 milionë lekë.

Garda e Republikës

Programi “Garda e Republikës”, përbën programin e dytë më të madh të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 6.8 për qind të buxhetit të miratuar për MPB-në në vitin 2014. Nëpërmjet fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj, si dhe rritja e shkallës së sigurisë për objektet e rëndësishme të veçantë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese, duke siguruar përputhje me standardet më të larta evropiane në fushën e sigurisë së personaliteteve të larta shtetërore. Për vitin 2014, MPB ka alokuar rreth 1.3 miliardë lekë në këtë program buxhetor dhe realizimi i planit të buxhetit, për tremujorin e katërt të vitit 2014, paraqitet në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

03150	Garda e Republikës	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
-------	--------------------	-------	-------	-------------------	-------------------	----------------

1.	Shpenzime Korente	1,221,265	1,217,651	93.6%	93.6%	99.7%
1.1	Personeli	1,007,786	1,007,231	77.2%	77.4%	99.9%
1.2	Operative	213,479	210,420	16.4%	16.2%	98.6%
2	Shpenzime kapitale	83,782	83,297	6.4%	6.4%	99.4%
2.1	Financim i brendshem	83,782	83,297	6.4%	6.4%	99.4%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	1,305,047	1,300,948	100.0%	100.0%	99.7%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	1,305,047	1,300,948	100.0%	100.0%	99.7%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse evidentojmë nga tabela, edhe për këtë program buxhetor, shpenzimet e personelit planifikohet të zënë rreth 77 për qind të fondeve totale të alokuara në terma të planit vjetor. Një element që duhet të theksohet është fakti se shpenzimet kapitale janë në nivelin e vetëm 6.4 për qind e totalit të shpenzimeve të planifikuara, vjetore, ndërkohë që në tremujorin e katërt të vitit realizimi i tyre është në nivelin 99 për qind.

Në programin “Garda e Republikës”, janë parashikuar 2 produkte buxhetore dhe më specifikisht “Ruajtja e personaliteteve të larta shtetërore, vendas dhe të huaj”, si dhe produkti “Rikonstruksioni i Komandës së Gardës”, të cilët rezultojnë plotësisht të realizuar për periudhën e raportimit.

Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara të Pushtetit Vendor

Fondet e alokuara për këtë program buxhetor, synojnë forcimin e rendit kushtetues, koordinimin e veprimtarive dhe kontributeve të institucioneve qendrore me ato vendore për një zhvillim lokal dhe rajonal të qendrueshëm. Më tej, synohet zbatimi i programit të qeverisë nga institucionet qendrore në nivel lokal, përdorimin me eficiencë të fondeve buxhetore dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetareve. Gjithashtu, nëpërmjet Strukturave të Administrimit të Tokës në Qarqe, kryhet azhurnimi i sipërfaqeve të tokës, përgatitja e dokumentacionit dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e tokës në përputhje me strategjitë dhe planet e zhvillimit.

Për vitin 2014, fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 3.8 për qind të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe 3.5 për qind të shpenzimeve faktike për tremujorin e katërt të vitit. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të buxhetit.

Në mijë lekë

01160	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara të P. Vendor	Plani	Fakti	Plani/Totalin	Fakti/Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	712,761	641,211	98.7%	98.0%	90.0%
1.1	Personeli	454,134	403,903	62.9%	61.7%	88.9%
1.2	Operative	258,627	237,308	35.8%	36.3%	91.8%
2	Shpenzime kapitale	9,741	12,987	1.3%	2.0%	133.3%
2.1	Financim i brendshem	9,448	8,692	1.3%	1.3%	92.0%
2.2	Financim i huaj	293	4,295	0.0%	0.7%	1466.7%
3	SHUMA	722,502	654,198	100.0%	100.0%	90.5%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	722,502	654,199	100.0%	100.0%	90.5%

Burimi: Ministria e Financave, (2015);

Sikurse evidentohet nga tabela, shpenzimet korente zënë 98.7 për qind të fondeve totale të planifikuara për vitin 2014, për këtë program, ku shpenzimet e personelit zënë pjesën kryesore, me 63 për qind të shpenzimeve të planifikuara dhe 62 për qind të shpenzimeve faktike. Shpenzimet kapitale zënë vetëm 1.3 për qind të fondit të alokuar për këtë program dhe për periudhën 12-mujore, paraqesin një nivel realizimi mjaft të lartë.

Në programin “Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara të Pushtetit Vendor”, për vitin 2014, janë parashikuar 5 produkte, të cilët, sipas informacionit të përcjellë nga MPB, janë realizuar plotësisht në raport me planin e periudhës.

Shërbimi i Gjendjes Civile

Programi buxhetor “Shërbimi i Gjendjes Civile”, siguron shërbimin e regjistrimit dhe përditësimit të të dhënave të shtetasve në Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave. Informacioni i shërbimit të gjendjes civile është tërësia e të dhënave personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin e shtetasve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Këto të dhëna shërbejnë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në marrëdhëniet me shoqërinë e shtetit shqiptar, si dhe për ushtrimin e funksioneve të organeve dhe institucioneve shtetërore.

Për vitin 2014, objektivat e politikës së këtij programi janë:

- Mbajtja në mënyrë efektive dhe eficiente e përditësimit të ngjarjeve në Regjistrin Civil.
- Mirëfunksionimi eficient dhe i sigurtë i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, zhvillimi dhe përmirësimi i moduleve të këtij sistemi dhe Sistemit Kombëtar të Adresave.
- Shfrytëzimi dhe garantimi i një sistemi eficient dhe të sigurtë për autorizimin dhe certifikimin e aplikimeve për lëshimin e dokumenteve të identitetit, letërnjoftimit dhe pasaportës.

Për vitin 2014, fondet e dedikuara për këtë program, prej 740 milionë lek, përbëjnë rreth 3.9 për qind të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe 3.7 për qind të shpenzimeve faktike të MPB për tremujorin e katërt të vitit 2014. Realizimi i planit të buxhetit për këtë periudhë raportimi, paraqitet në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	707,259	660,944	95.1%	95.6%	93.5%
1.1	<i>Personeli</i>	380,100	358,511	51.1%	51.8%	94.3%
1.2	<i>Operative</i>	327,159	302,433	44.0%	43.7%	92.4%
2	Shpenzime kapitale	36,183	30,663	4.9%	4.4%	84.7%
2.1	<i>Financim i brendshem</i>	36,183	30,663	4.9%	4.4%	84.7%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	743,443	691,607	100.0%	100.0%	93.0%
	<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</i>	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	743,443	691,607	100.0%	100.0%	93.0%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse mund të konstatohet edhe nga tabela e mësipërme, ky program buxhetor paraqet një nivel realizimi të shpenzimeve prej 93 për qind të planit vjetor, kryesisht prej nivelit të realizimit të shpenzimeve korente, ndërkohë që investimet rezultojnë të realizuar në masën 85 për qind për periudhën referuese. Në këtë program, janë parashikuar 4 produkte, të cilët janë realizuar plotësisht.

Menaxhimi i Rezervave të Shtetit

Qëllimi i këtij programi është administrimi i stokut të mallrave rezervë materiale shtetërore, për t'u përdorur për të ndërhyrë në situatat në nevojë. Më tej, programi administron edhe mallrat e sekuestruara, konfiskuara, mallra të lëna në ruajtje, etj., nëpërmjet Drejtorive Rajonale të shtrira në të gjithë territorin e vendit.

Për vitin 2014, fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 0.6 për qind të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të buxhetit, për këtë program deri në tremujorin e katërt të këtij viti.

Në mijë lekë

01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	116,025	95,604	95.1%	94.1%	82.4%
1.1	<i>Personeli</i>	70,847	66,866	58.1%	65.8%	94.4%
1.2	<i>Operative</i>	45,178	28,738	37.0%	28.3%	63.6%
2	Shpenzime kapitale	6,000	5,999	4.9%	5.9%	100.0%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	6,000	5,999	4.9%	5.9%	100.0%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	122,025	101,603	100.0%	100.0%	83.3%
	<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</i>	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	122,025	101,603	100.0%	100.0%	83.3%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse evidentohet më sipër, shpenzimet korente përbëjnë 95 për qind të fondeve të planifikuara në këtë program buxhetor dhe 94.1 për qind të shpenzimeve faktike për periudhën e 12-mujorit dhe paraqesin një nivel realizimi prej 82.4 për qind. Shpenzimet kapitale, të cilat përbëjnë vetëm 6 për qind shpenzimeve faktike, janë realizuar 100 për qind të planit vjetor. Në total, niveli i realizimit të shpenzimeve buxhetore për këtë program është rreth 83.3 për qind të planit vjetor.

Me fondet buxhetore të vëna në dispozicion nga Ministria e Punëve të Brendshme, për programin “Menaxhimi i Rezervave të Shtetit”, janë planifikuar 6 produkte buxhetore, të cilat rezultojnë të realizuara në terma vlere dhe sasive, për periudhën 12-mujore.

Emergjencat Civile

Programi buxhetor “Emergjencat Civile”, zhvillon politika dhe strategji në fushën e menaxhimit të situatave të emergjencave civile”, duke bashkërenduar veprimet e të gjitha strukturave shtetërore, në mënyrë që të reduktojë në mënyrë substanciale humbjet në njerëz, asete sociale, në

ekonomi dhe mjedis. Institucionet e këtij programi buxhetor, vlerësojnë rreziqet dhe dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme, si dhe programojnë e kontrollojnë masa paraprake, parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese.

Për vitin 2014, fondet e alokuara për këtë program, prej rreth 834.7 milionë lek, përbëjnë 4 për qind të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2014. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të buxhetit, për këtë program deri në tremujorin e katërt të këtij viti.

Në mijë lekë

10910	Emergjencat Civile	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	798,578	774,403	95.7%	97.0%	97.0%
1.1	Personeli	557,416	548,392	66.8%	68.7%	98.4%
1.2	Operative	241,162	226,011	28.9%	28.3%	93.7%
2	Shpenzime kapitale	36,126	24,000	4.3%	3.0%	66.4%
2.1	Financim i brendshem	13,126	13,124	1.6%	1.6%	100.0%
2.2	Financim i huaj	23,000	10,876	2.8%	1.4%	47.3%
3	SHUMA	834,704	798,403	100.0%	100.0%	95.7%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	834,704	798,403	100.0%	100.0%	95.7%

Burimi: Ministria e Financave(2015);

Sikurse evidentohet më sipër, shpenzimet korente përbëjnë 96 për qind të fondeve totale të alokuara për këtë program buxhetor dhe mes tyre, 67 për qind janë shpenzime për personelin dhe vetëm 29 për qind janë shpenzimet operative për vitin 2014. Shpenzimet kapitale përbëjnë 4.3 për qind të fondeve të alokuara dhe vetem 3 për qind të shpenzimeve faktike në tremujorin e katërt. Në total, niveli i realizimit të buxhetit është 95.7 për qind.

Për këtë program buxhetor në vitin 2014, janë parashikuar 8 produkte buxhetore, nga të cilat 5 rezultojnë të realizuara plotësisht për planin e periudhës dhe 3 produkte janë realizuar pjesërisht.

NDRYSHIMET E BUXHETIT

Për programet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, situata në lidhje me ndryshimet në planin e buxhetit të vitit 2014, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në miliard lekë

Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Struktura e Shpenzimeve		
		Buxheti Fillestar	Plani me ndryshime	Ndryshimi i planit
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	842,375	1,119,319	276,944
03140	Policia e Shtetit	12,726,879	14,316,631	1,589,752
03150	Garda e Republikës	1,212,800	1,305,047	92,247
01160	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara	565,200	722,501	157,301
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	733,000	743,443	10,443
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	102,700	122,025	19,325

10910	Emergjencat Civile	839,926	834,704	-5,222
	TOTALI	17,022,880	19,163,670	2,140,790

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në fund të vitit 2014, plani vjetor i buxhetit rezulton 2.1 miliardë lekë më shumë se plani fillestar prej 17 miliardë lekë gjithsej, të parashikuara për të gjitha programet buxhetore të ministrisë. Gjithsej këto ndryshime paraqiten më poshtë:

- Shtesa nëpërmjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave, 1.146 milionë lekë;
- Çelje të fondeve nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura, 836 milionë lekë;
- Çelje të fondeve nga akordimi i fondit të veçantë, 24.6 milionë lekë;
- Shtesa të fondeve nëpërmjet Akteve Normative, 132.6 milionë lekë;
- Çelje të fondeve për pagesa suplementare, 831 mijë lekë.

Në raportin e monitorimit të hartuar nga MPB, paraqiten të dhënat e detajuara mbi ndryshimet në planin e buxhetit për secilin program buxhetor.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE FAKTIKE

Tabela në vijim, paraqet krahasimin e të dhënave faktike, të përmbajtura në raportin e monitorimit të hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me të dhënat mbi shpenzimet faktike të sistemit të Thesarit, për periudhën raportuese të 12-mujorit.

Në mijë lekë

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	MPB	MF	Dif	MPB	MF	Dif	MPB	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	947,240	947,240	0	23,440	23,440	0	970,680	970,680	0
Policia e Shtetit	13,008,583	13,008,583	0	1,200,512	1,200,512	0	14,209,095	14,209,095	0
Garda e Republikës	1,217,652	1,217,652	0	83,297	83,297	0	1,300,948	1,300,948	0
Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara	641,212	641,212	0	12,988	12,988	0	654,199	654,199	0
Shërbimi i Gjendjes Civile	660,943	660,943	0	30,663	30,663	0	691,607	691,607	0
Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	95,604	95,604	0	5,999	5,999	0	101,603	101,603	0
Emergjencat Civile	774,403	774,403	0	24,000	24,000	0	798,403	798,403	0
Totali i Shpenzimeve	17,345,637	17,345,637	0	1,380,899	1,380,899	0	18,726,535	18,726,535	0
<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</i>							80,191	80,191	
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë							18,806,726	18,806,726	0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme (2015);

Ashtu sikurse paraqitur në tabelën e mësipërme, të dhënat faktike e përdorura nga Ministria e Punëve të Brendshme për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për tremujorin e katërt të vitit 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.

5.8 MINISTERIA E MBROJTJES

MISIONI

Ministria e Mbrojtjes ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Strategjinë Ushtarake dhe legjislacionin në fuqi në Republikës së Shqipërisë. Ajo përbëhet nga administrata e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Mbrojtjes, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas pesë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Deri në fund të vitit 2014 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve faktike të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Programit	Përqindja e realizimit të shpenzimeve kundrejt planit të vitit 2014
Planifikim, menaxhim dhe administrim	93.2
Forcat e Luftimit	96.3
Arsimi Ushtarak	88.2
Mbështetja e Luftimit	94.2
Bashkëpunimi Civilo Ushtarak	69.7
TOTALI	93.9

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i treguesve buxhetorë është në shifra shumë të larta. Duke i'u referuar shifrave vihet re një realizim maksimal i shpenzimeve të fondeve buxhetore, pothuajse në të gjithë programet. Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, situata në fund të vitit 2014 paraqitet e tillë:

Emërtimi i Programit	Shpenzime korente (në përqindje)	Shpenzime kapitale (në përqindje)
Planifikim, menaxhim dhe administrim	93.2	98.6
Forcat e Luftimit	93.9	100
Arsimi Ushtarak	88.2	82.5
Mbështetja e Luftimit	94.1	98.3
Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak	72.1	18.0
TOTALI	92.6	99.1

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë,

realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri në mijë lekë dhe në përqindje për sipas programeve buxhetorë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	1,162,924	1,083,716	93.2
2	Forcat e Luftimit	7,826,499	7,535,459	96.3
3	Arsimi Ushtarak	858,325	757,013	88.2
4	Mbështetja e Luftimit	5,116,353	4,817,154	94.2
5	Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak	578,305	403,184	69.7
TOTALI		15,542,406	14,596,526	93.9

Burimi: Ministria e Financave (2015);

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Në programin “Planifikim, administrim dhe menaxhim” që përfaqëson rreth 7.5 për qind të totalit të shpenzimeve të gjithë ministrisë, janë parashikuar pesë produkte, katër nga të cilët janë realizuar plotësisht në sasi dhe në vlerë, ndërsa produkti “Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara” është realizuar pjesërisht në sasi pasi vazhdon procesi i realizimit.

Në programin “Forcat e luftimit” që përfaqëson rreth 50.4 për qind të totalit të shpenzimeve të gjithë ministrisë, janë parashikuar 5 produkte, 4 nga të cilët janë realizuar tërësisht si në vlerë dhe në sasi në masën 95-100 për qind, ndërsa produkti “Bashkëshorte ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie” është realizuar 64 për qind.

Në programin “Arsimi Ushtarak” që përfaqëson rreth 5.5 për qind të totalit të shpenzimeve të gjithë ministrisë janë parashikuar tre produkte, të cilat janë realizuar në vlerë në masën 73-89 për qind.

Në programin “Mbështetja e Luftimit” që përfaqëson rreth 32.9 për qind të totalit të shpenzimeve të gjithë ministrisë, janë parashikuar 17 produkte, të cilat janë realizuar tërësisht në vlerë, në masën 85-100 për qind.

Në programin Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak që përfaqëson rreth 3.7 për qind të totalit të shpenzimeve të gjithë ministrisë, janë planifikuar 3 produkte, dy nga të cilët janë realizuar pjesërisht në vlerë në masën 18 dhe 32 për qind duke sjellë dhe një realizim të ulët të këtij programi krahasuar me programet e tjerë.

5.9 MINISTRIA E KULTURËS

MISIONI

Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të

dialogut kulturor dhe integritit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Kulturës gjatë vitit 2014 ka administruar fondet buxhetore për 3 programe:

- Planifikim, menaxhim dhe administrim;
- Trashëgimia Kulturore dhe muzetë;
- Arti dhe kultura.

Realizimi i Buxhetit 2014

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Kulturës mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri në fund të vitit 2014, sipas zërave të shpenzimeve, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Shpenzime personeli	857 457	828 088	96.6
2	Shpenzime të tjera korente	613 531	555 859	90.6
3	Shpenzime kapitale	551 898	368 233	66.7
	Me financim të brendshëm	551 898	360 489	65.3
	Me financim të huaj		7744	
	SHUMA	2 022 886	1 752 180	86.6
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		34 728	
	TOTALI	2 022 886	1 786 908	

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Ndërsa sipas programeve, realizimi i treguesve në Total paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	268 262	239 279	89.2
2	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	795 158	591 011	74.3
3	Arti dhe Kultura	959 466	921 890	96.08
	TOTALI	2 022 886	1 752 180	86.6
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		34 728	
	GJITHSEJ	2 022 886	1 786 908	

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i fondeve në total për çdo program në veçanti për shpenzimet korente dhe kapitale paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2014		Fakti 2014		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korre	Investime

						nte	
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	261 947	6 315	233 724	5 555	89.2	87.97
2	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	408 947	386 211	389 149	201 862	95.2	52.3
3	Arti dhe Kultura	800 094	159 372	761 074	160 816	95.1	101
Totali		1 470 988	551 898	1 383 947	368 233	94.08	66.7
	Shpenzime nga të ardhura jashtë limitit			33 626	1 102		
Gjithsej		1 470 988	551 898	1 417 573	369 335		

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Plani i buxhetit i vitit 2014 në total për Ministrinë është realizuar 86.6 për qind nga i cili, shpenzimet korente janë realizuar në rreth 94.1 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 66.7 për qind të planit, nga të cilat ato me financim të brendshëm janë realizuar 65.3 për qind.

Duke parë strukturën e realizimit të shpenzimeve në fakt për vitin 2014, vërejmë që pjesën më të madhe të shpenzimeve faktike të kësaj ministrie e zënë shpenzimet e realizuara në programin “Arti dhe Kultura” me rreth 53 për qind të totalit të shpenzimeve, më pas me 33.9 për qind në programin “Trashëgimia kulturore” dhe me 13.7 për qind të totalit të shpenzimeve në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Çështje të veçanta

- Për këtë ministri nga Fondi për likuidimin e Detyrimeve të Prapambetura gjatë vitit 2014 janë akorduar gjithsej **165,531,000** lekë,
 - a. Për shpenzime **operative 88,094,000** lekë,
 - b. Për **Investime 77,437,000** lekë,
- Numri i punonjësve të paguar në listë pritje për vitin 2014 është 12 punonjës dhe fondi përkatës është 10 milionë lekë.
- **Me Vendimet e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve** nga fondet e buxhetit për vitin 2014 për këtë ministri janë akorduar **70 milionë** lekë, për programin “Arti dhe Kultura”.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”

Për këtë program fondet në total janë realizuar në masën 74.3 për qind, nga të cilat shpenzimet korente janë realizuar 95.2 për qind, ndërsa shpenzimet për investime në masën 52.3 për qind. Mosrealizimet në shpenzimet për investime lidhen kryesisht me mosrealizimin e fondit të planifikuar të shpronësimeve për 180 milionë lekë.

Realizimi i produkteve për këtë program për vitin 2014 në krahasim me planin vjetor paraqitet si më poshtë:

- Produkti “Monumente kulture të konservuara dhe restauruara”. Ky produkt konsiston në mirëmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, mbrojtjen, monitorimin dhe hartimin e projekteve të restaurimit në objekte monument kulture, që për vitin 2014 janë planifikuar 100 banesa dhe në të gjitha janë bërë ndërhyrje. Ndër më kryesoret përmendim:
 - Restaurimi dhe Mirëmbajtja e Monumenteve të Kulturës në Qendrën Historike të Qytetit të Beratit.
 - Restaurimi dhe mirëmbajtja e Kalasë së Durrësit, Krujës, Elbasanit, Tiranës dhe Gjirokastrës.
 - Mirëmbajtje dhe pastrim i monumenteve: Kisha e Marmiroit, Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Mavrovës.
 - Mirëmbajtje dhe ndërhyrje restauruese në fasadën e Muzeut Arkeologjik Korçë.
 - Mirëmbajtje, konservim dhe restaurim në banesën Oso Kuka në Kalanë Rozafa, Shkodër.
 - Rikonstruksioni i Sheshit “Nënë Tereza”.
- Produkti “Muze të rikonstruara dhe përmirësuar në infrastrukture”. Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar punime për përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e shërbimit ndaj publikut në 7 muze nga 7 të planifikuara, si më poshtë vijon:
 - Në Muzeun Arkeologjik Durrës, pas rikonstruksionit të tij po punohet për muzealizimin e tij. Është punuar dhe sistemuar pjesa e oborrit të muzeut dhe objekteve në pjesën e jashtme të tij.
 - Pranë Muzeut Historik Kombëtar po punohet për hapjen e Pavionit Etnografik, punimet janë në fazën e mbylljes.
 - Është bërë vlerësimi i objekteve muzeale, si dhe regjistrimi i tyre pranë QKIPK.
 - Fototeka Marubi në bashkëpunim me FZSHH ka realizuar konkursin për hartimin e projektit të zbatimit për vënien në funksionim të godinës së re të fototekës Marubi.
- Produkti “Infrastrukturë e përmirësuar në parqet Arkeologjike”, është realizuar në numër, 8 nga 8 të planifikuarr për periudhën.
 - Parqet arkeologjike kryejnë në vazhdimësi mirëmbajtjen e territorit si pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët, konsolidim të mureve, pajisjen e ambienteve me tabela informuese, etj.
 - Projekti me financim të huaj në sitin arkeologjik të Apolonisë “Restaurimi i Manastirit të Shën Marisë dhe hartimi i Master Planit”, i cili do të realizohet në dy vite 2015-2016.
 - Gjatë kësaj periudhe ZAK Butrint është përfshirë në disa programe që kanë synuar mirëmbajtjen e monumenteve, kontrollin e vegjetacionit, rritjen e shërbimeve turistike dhe është bërë përgatitja e sitit për sezonin turistik.
- Produkti “Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale e jo materiale” për vitin është realizuar plotësisht (10 000 katalogje) për periudhën. Në kuadër të krijimit të Fondit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore vazhdon procesi i katalogimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në fushat e Arkeologjisë, Artit Pamor, Etnografisë, Arkitekturës, etj. Kështu për vitin 2014, janë rregjistruar kartela të reja në Katalogun “Onufri”, “Maro Kondi”, “Sotiri”.
- Është realizuar produkti “Aktivitete të trashëgimisë jo materiale dhe diversitetit kulturor” në nr. 50 aktivitete nga 50 të planifikuara. Janë realizuar një sërë aktivitete të planifikuara si dhe aktivitete në kuadër të vizitës në muajin shtator të Papa Françeskut në Tiranë.

Programi “Arti dhe Kultura”

Në këtë program janë parashikuar 3 produkte. Realizimi i produkteve për këtë program për vitin 2014 në krahasim me sasinë e planifikuar paraqitet si më poshtë:

- Produkti “Veprimtari të realizuara në institucionet e artit e kulturës”, janë realizuar 11 aktivitete nga 12 të planifikuara. Në secilin nga 6 institucionet, programet artistike shfaqen me cilësi dhe integritet të lartë me prurjet e reja dhe krijimtaritë artistike.
- Produkti “ Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë. Janë realizuar 78 veprimtari nga 80 të planifikuara. Kështu janë realizuar 29 festivale, 4 evente multi-kulturore, 6 arte bashkëkohore, 2 konferenca, 1 reportazh, 5 shfaqje teatrale, 1 program televiziv, 1 workshop, 6 botime, 1 dokumentar, etj. Në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri më datë 21 shtator 2014, Ministria e Kulturës organizoi aktivitetet si koncerte e lexime të materialeve poetike nga autorët me profil religjioz TKOB dhe TK. Janë organizuar shfaqje në Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, në Galerinë e Arteve u hap ekspozita e piktorit Lin Delija” Historia e tij është takimi i Artit me Kishën”
- Produkti “Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare” është realizuar plotësisht sipas planifikimit. Promovimi i imazhit dhe artit shqiptar në arenën ndërkombëtare është arritur plotësisht, nëpërmjet përfaqësimit me sukses në Bienalen e Arkitekturës, Venecia, Itali, përfaqësimi i Shqipërisë në ekspozitën ndërkombëtare “Çmimi Muslim Mulliqi 2014 Edicioni i X, Prishtinë Kosovë, përfaqësimi i Shqipërisë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Karlovy Vary 2014, Çeki, me filmin Bota, etj.

Programi “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”. Fondet në total për këtë program janë realizuar në masën 89.2 për qind, nga të cilat shpenzimet korrente në masën 89.2 për qind, ndërsa shpenzimet për investime 88 për qind.

Ndërsa lidhur me realizimin e produkteve konstatojmë se të gjitha produktet e parashikuar për këtë program janë realizuar si më poshtë:

- Produkti “Pajisje elektronike dhe pajisje zyrash” është realizuar sipas parashikimit vjetor, plotësisht.
- Janë miratuar 8 akte ligjore dhe nënligjore, nga 10 të parashikuara për këtë produkt.
- Likuidimi i detyrimeve të vendimeve gjyqësore nga 17 të planifikuara janë realizuar 13.
 - Ndërsa në realizimin e produktit “Nënshkrim marrëveshesh”, për vitin 2014 nuk është realizuar asnjë nga 3 të parashikuara.

5.10 MINISTRIA E FINANCAVE

MISIONI

Misioni i Ministrisë së Financave është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Financave, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas gjashtë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Deri në fund të vitit 2014 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve faktike të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, për financimin e brendshëm, paraqitet si më poshtë:

Në përqindje

Emërtimi i Programit	Përqindja e realizimit të shpenzimeve kundrejt planit të vitit 2014
Planifikim, menaxhim dhe administrim	65.1
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	91.5
Ekzekutimi i Pagesave të ndryshme	93.2
Menaxhimi i të ardhurave tatimore	97.7
Menaxhimi i të ardhurave doganore	98.8
Lufta kundër transaksioneve financiare jologjore	86.1
Totali	94.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i treguesve buxhetorë për pesë programe buxhetorë është në shifra të larta dhe për programin e planifikimit, menaxhimit dhe administrimit është 65.1 për qind.

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Financave mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri (pa përfshirë financimin e huaj dhe të ardhurat jashtë limitit) paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	520,014	338,743	65.1
2	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	479,048	438,565	91.5
3	Ekzekutimi i Pagesave të ndryshme	1,595,562	1,486,271	93.2
4	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,656,015	2,595,992	97.7
5	Menaxhimi i të ardhurave doganore	2,154,566	2,129,649	98.8
6	Lufta kundër transaksioneve financiare jologjore	68,871	59,294	86.1
TOTALI		7,474,076	7,048,514	94.3

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Sipas të dhënave të sistemit financiar informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje sipas programeve të Ministrisë së Financave, për financimin e huaj paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	40,000	148,988	372.5
2	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	30,334	0	0
3	Ekzekutimi i Pagesave të ndryshme	0	0	
4	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	0	650,162	
5	Menaxhimi i të ardhurave doganore	165,687	166,780	100.7

6	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	0	0	0
TOTALI		236,021	965,930	409.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të sistemit financiar informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet korrente**, sipas programeve të Ministrisë së Financave, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	362,420	324,981	89.7
2	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	468,540	438,061	93.5
3	Ekzekutimi i Pagesave të ndryshme	1,595,562	1,486,271	93.2
4	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,271,578	2,224,331	97.9
5	Menaxhimi i të ardhurave doganore	2,014,730	1,994,197	99.0
6	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	66,908	57,648	86.2
TOTALI		6,779,738	6,525,489	96.2

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të sistemit financiar informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet kapitale (financimi i brendshëm)**, sipas programeve të Ministrisë së Financave, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Fakti 2014
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	157,594	13,762	8.7
2	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	10,508	504	4.8
3	Ekzekutimi i Pagesave të ndryshme	0	0	
4	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	384,437	371,661	96.7
5	Menaxhimi i të ardhurave doganore	139,836	135,451	96.9
6	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	1,963	1,646	83.9
TOTALI		694,338	523,024	75.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Lidhur me shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale në programet “Planifikim, menaxhim dhe administrim” dhe “Menaxhimi i Shpenzimeve Publike” vërejmë që ka një realizim relativisht të ulët.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Në programin “Planifikim, menaxhim, administrim” janë parashikuar **17 produkte**, 3 nga të cilat nuk janë realizuar, vetëm 6 nga produktet për periudhën vjetore janë realizuar plotësisht dhe pjesa tjetër e produkteve janë realizuar pjesërisht.

Në programin “Menaxhimi i të ardhurave doganore” janë parashikuar 16 produkte, 11 nga të cilat për periudhën vjetore raportohet se janë realizuar plotësisht, si për shembull “Sistem informatik i mirëmbajtur dhe i modernizuar”, “Makina të shërbimit doganor funksionale”, etj. një nga produktet është realizuar pjesërisht dhe 4 produkte raportohen të parealizuar.

Në programin “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” janë parashikuar 9 produkte për vitin 2014, 8 nga të cilat raportohet se janë realizuar plotësisht në sasi dhe në vlerë, ndërsa produkti “Projekti i rikonstruksionit të dhomës së serverave” nuk është realizuar.

5.10 MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Misioni

Ministria e Punëve të Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të Shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. Në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtarë, MPJ pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbrojnë interesat kombëtare, si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Shërbimi i jashtëm i Republikës së Shqipërisë synon rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në aktet ndërkombëtare.

Vështrim i përgjithshëm

Në respekt të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Ministria e Punëve të Jashtme, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas tre programeve të miratuara buxhetore, e konkretisht:

- Programi “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”
- Programi “Mbështetje diplomatike jashtë vendit”
- Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Punëve të Jashtme mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi i Thesarit, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	2,274,949	2,266,378	97%	97%	99.6%
1.1	Personeli	799,000	791,477	34%	34%	99.1%
1.2	Operative	1,475,949	1,474,901	63%	63%	99.9%
2	Shpenzime kapitale	68,759	66,020	3%	3%	96.0%
2.1	Financim i brendshëm	68,759	66,020	3%	3%	96.0%
2.2	Financim i huaj	0	0	0%	0%	
3	SHUMA	2,343,708	2,332,398	100%	100%	99.5%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		224	0%	0%	
4	TOTALI	2,343,708	2,332,622	100%	100%	99.5%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse evidentohet nga tabela, shpenzimet korente përbëjnë 97 për qind të fondeve të planifikuara vjetore, por edhe të shpenzimeve faktike të regjistruara për periudhën 12-mujore. Investimet, përbëjnë vetëm 3 për qind të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2014.

Masa e realizimit 12-mujor të buxhetit të vitit 2014 kundrejt buxhetit vjetor të miratuar është 99.5 për qind. Në total, realizimi i shpenzimeve korente renditet në rreth 99.6 për qind, ndërkohë që shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 96 për qind, në harmoni me pritshmërinë e periudhës së raportimit.

Ndërkohë, të dhënat sipas programeve buxhetore jepen në tabelën e mëposhtme. Sipas të dhënave, konstatohet se programi i aparatit të MPJ, rezulton me një realizim të shpenzimeve në nivelin 91.3 për qind. Ndërkohë, dy programet e tjera shfaqin një performancë shumë të mirë, në raport me planin e shpenzimeve të periudhës, me realizim plani prej 100 për qind respektivisht.

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			TOTALI I SHPENZIMEVE		% realizimi
	PLAN	FAKT	% Realiz.	PLAN	FAKT	% Realiz.	Plan	Fakt	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	120,449	111,878	92.9	9,759	7,020	71.9	130,208	118,899	91.3
Mbështetje Diplomatike Jashtë Vendit	1,936,500	1,936,500	100	59,000	59,000	100.0	1,995,500	1,995,500	100.0
Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MPJ-së	218,000	218,000	100	0	0		218,000	218,000	100.0
TOTALI	2,274,949	2,266,378	99.6	68,759	66,020	96.0	2,343,708	2,332,399	99.5

Burimi: Ministria e Financave, (2015);

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme për çdo program sipas buxhetit të vitit 2014, dhe realizimit faktik i tij jepet në tabelën e mëposhtme:

Në përqindje

Kodi	Emërtimi i Programit	Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4.9	5.6	5.1
01120	Mbështetje diplomatike jashtë vendit	83.2	85.1	85.6
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	11.9	9.3	9.3
	TOTALI	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Rreth 85.6 për qind e totalit të shpenzimeve faktike të kryera në vitin 2014, përbëhet nga shpenzimet për programin “Mbështetje diplomatike jashtë vendit”, ndjekur nga shpenzimet për programin “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ” me rreth 9.3 për qind dhe në fund shpenzimet për programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” me rreth 5 për qind.

MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin shpenzimet për aparatit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe synon mbështetjen financiare dhe njerëzore në realizimin e politikave në tërësi të drejtorive të MPJ duke siguruar një lidhje efektive ekonomike dhe financiare midis aparatit qendror dhe përfaqësive diplomatike. Më tej, synohet sigurimi i pasqyrit të aktivitetit diplomatik në të gjitha platformat mediatike; trajtimi zyrtar i delegacioneve të huaja brenda dhe

jashtë vendit nga protokollin e shtetit; si dhe administrimi i pasurive dokumentare arkivore për shfrytëzimin e saj nga strukturat e shërbimit të jashtëm dhe nga publiku.

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson 5 për qind të totalit të shpenzimeve të periudhës 12-mujore. Sipas zërave, krahasuar me planin vjetor, realizimi paraqitet më poshtë.

Në mijë lekë

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	120,449	111,878	92.5%	93.9%	92.9%
1.1	Personeli	48,500	40,977	37.2%	34.4%	84.5%
1.2	Operative	71,949	70,901	55.3%	59.5%	98.5%
2	Shpenzime kapitale	9,759	7,020	7.5%	5.9%	71.9%
2.1	Financim i brendshëm	9,759	7,020	7.5%	5.9%	71.9%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	130,208	118,898	100.0%	99.8%	91.3%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse evidentohet edhe në tabelën e mësipërme, shpenzimet e funksionimit të aparatit të MPJ-së, janë planifikuar në nivelin 130.2 milionë lekë, ndërkohë që për periudhën 12-mujore janë shpenzuar 91.3% e këtyre fondeve ose 118.9 milionë lekë. Shpenzimet e personelit paraqesin një nivel realizimi më të ulët, të lidhur kryesisht me transferimin e disa diplomatëve nga ministria në përfaqësitë diplomatike dhe anasjelltas, të cilat janë shoqëruar me efekte financiare të reduktuara për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Për vitin 2014, fondet prej 130.2 milionë lekësh të këtij programi, janë parashikuar për realizimin e 11 produkteve buxhetore, nga të cilat 10 rezultojnë plotësisht të realizuara dhe 1 është realizuar pjesërisht si pasojë e vazhimit të procesit të prokurimit. Në tërësi, niveli i performancës për këtë program është i kënaqshëm.

Programi “Mbështetje diplomatike jashtë vendit”

Ky program buxhetor përfshin të gjitha fondet e alokuara për sigurimin e tërësisë së funksioneve dhe shërbimeve që ofrojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit, në përputhje të plotë me normat e të drejtës ndërkombëtare, në zbatim të programit të politikës së jashtme të Qeverisë Shqiptare, si dhe në respekt të Kushtetutës së RSH. Më tej, programi synon nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm, mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare e shtetërore dhe përkujdesin për interesat e qytetarëve shqiptarë në shtetet dhe organizatat ndërkombëtare ku ato janë akredituar.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën e 12-mujorit të vitit 2014 në këtë program, sipas zërave kryesor krahasuar me planin vjetor paraqiten si më poshtë.

Në mijë lekë

01120	Mbështetje Diplommatike Jashtë Vendit	Plani	Fakti	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	1,936,500	1,936,500	97.0%	97.0%	100.0%
1.1	Personeli	608,500	608,500	30.5%	30.5%	100.0%
1.2	Operative	1,328,000	1,328,000	66.5%	66.5%	100.0%
2	Shpenzime kapitale	59,000	59,000	3.0%	3.0%	100.0%
2.1	Financim i brendshëm	59,000	59,000	3.0%	3.0%	100.0%

2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	1,995,500	1,995,500	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Ky program përfaqëson rreth 85 për qind të totalit të shpenzimeve 12-mujore të këtij institucioni ose rreth 2 miliardë lekë. Sikurse evidentohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente përbëjnë 97% të totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2014 për këtë program buxhetor, por edhe të shpenzimeve faktike. Shpenzimet për personelin përbëjnë 30.5 për qind të totalit të planit të programit, ndërkohë që shpenzimet e tjera operative përbjënë pjesën tjetër prej rreth 66.5 për qind. Shpenzimet kapitale, përbëjnë vetëm 3 për qind të buxhetit të miratuar dhe pavarësisht vlerës së ulët në krahasim me shpenzimet korente, ato paraqesin një nivel realizimi prej 100 për qind të planit vjetor. Në tërësi, programi paraqet një performancë të shumë të mirë prej 100 për qind në terma vjetore.

Për vitin 2014 në këtë program janë parashikuar 6 produkte buxhetore, të cilat janë realizuar plotësisht, në terma sasiore dhe në terma të vlerës.

Programi “Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ”

Ky program buxhetor, përmban fondet e dedikuara nga Ministria e Punëve të Jashtme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave kombëtare dhe të shtetasve shqiptar, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqënies së tyre, nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe ofrimit të shërbimit konsullor. Më specifikisht, ky program buxhetor ka për qëllim zgjerimin, intensifikimin, diversifikimin, thellimin dhe pasurimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, në rajon, Europë, dhe vende të tjera të botës.

Krahasuar me zërat e planit vjetor, realizimi i shpenzimeve në këtë program, i cili përfaqëson rreth 9.3 për qind të totalit të shpenzimeve 12-mujore të institucionit, rezulton si më poshtë:

Në mijë lekë

01130	Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MPJ-së	Plani	Fakti	Plani / Totali	Fakti / Totali	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	218,000	218,000	100.0%	100.0%	100.0%
1.1	<i>Personeli</i>	142,000	142,000	65.1%	65.1%	100.0%
1.2	<i>Operative</i>	76,000	76,000	34.9%	34.9%	100.0%
2	Shpenzime kapitale	0	0	0.0%	0.0%	
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	0	0	0.0%	0.0%	
2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	218,000	218,000	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Për vitin 2014 në këtë program janë parashikuar 15 produkte, të cilat janë realizuar plotësisht harmoni me planin vjetor të shpenzimeve, me gjithë ndryshimet që kanë pësuar fondet e parashikuar për këtë program.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË SHPENZIMEVE FAKTIKE

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e shpenzimeve faktike të raportit të hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, të krahasuara me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit në Ministrisë së Financave.

Në mijë lekë

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	MPJ	MF	Dif	MPJ	MF	Dif.	MPJ	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	111,878	111,878	0	7,020	7,020	0	118,899	118,899	0
Mbështetje Diplomatike Jashtë Vëndit	1,936,500	1,936,500	0	59,000	59,000	0	1,995,500	1,995,500	0
Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MPJ-së	218,000	218,000	0	0	0	0	218,000	218,000	0
TOTALI	2,266,378	2,266,378	0	66,020	66,020	0	2,332,398	2,332,398	0

Burimi: Ministria e Financave dhe MPJ (2015)

Ashtu sikurse paraqitur në tabelën e mësipërme, të dhënat e përdorura nga MPJ për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për tremujorin e katërt të vitit 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit.

VOLUMI DHE MADHËSIA E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për programet buxhetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në mijë lekë

Kodi	Emërtimi i Programit	Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Diferenca
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	105.600	130.208	24.608
01120	Mbështetje diplomatike jashtë vëndit	1.792.500	1.995.500	203.000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	256.000	218.000	-38.000
	TOTALI	2.154.100	2.343.708	189.608

Burimi: Ministria e Financave dhe MPJ (2015);

Ndryshimet prej 189.6 milionë lekë në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e MPJ-së si pasojë e zbatimit të:

- VKM nr. 174, datë 26.03.2014,
- VKM nr. 631, datë 17.09.2014,
- Urdhërit të Kryeministrit nr. 227, datë 2.12.2013,
- Akti Normativ nr. 1 dhe Akti normativ nr. 2
- Shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

Për më tepër detaje në lidhje me ndryshimet mund të konsultohet raporti i monitorimit të buxhetit vjetor për vitin 2014, të hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, i cili gjendet i publikuar në faqen e internetit.

5.11 MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

MISIONI

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka si mision garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje dhe përfshirje sociale, arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror, përkujdesje sociale dhe shanse të barabarta, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët sociale, garantimin e lirisë së besimit fetar, barazinë e bashkësive fetare, mbështet mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas tetë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Për vitin 2014 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve faktike të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Programit	Përqindja e realizimit të shpenzimeve kundrejt planit të vitit 2014
Planifikim, menaxhim dhe administrim	92.3
Sigurimi Shoqëror	100.0
Përkujdesi Social	95.7
Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional	89.2
Inspektimi në Punë	92.3
Përfshirja Sociale	22.1
Mbështetje për Kultet Fetare	99.4
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	82.3
TOTALI	98.1

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, realizimi faktik për vitin 2014 paraqitet i tillë:

Emërtimi i Programit	Shpenzime korente (në %)	Shpenzime kapitale (në %)
Planifikim, menaxhim dhe administrim	95.8	35.5
Sigurimi Shoqëror	100.0	
Përkujdesi Social	95.7	97.0
Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional	89.0	99.8
Inspektimi në Punë	92.3	99.1
Përfshirja Sociale	82.4	9.6
Mbështetje për Kultet Fetare	98.7	100.0
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	82.2	100.0
TOTALI	98.2	69.3

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Sipas të dhënave të sistemit financiar informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet korente**, sipas programeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	216,342	207,260	95.8
2	Sigurimi Shoqëror	47,715,000	47,715,000	100.0
3	Përkujdesi Social	26,538,103	25,399,701	95.7
4	Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional	1,715,367	1,527,107	89.0
5	Inspektimi në Punë	192,671	177,764	92.3
6	Përfshirja Sociale	26,500	21,839	82.4
7	Mbështetje për Kultet Fetare	126,705	125,009	98.7
8	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	30,000	24,674	82.2
TOTALI		76,560,688	75,198,354	98.2

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm**, sipas programeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	13,261	4,704	35.5
2	Sigurimi Shoqëror	0	0	
3	Përkujdesi Social	25,772	25,715	99.8
4	Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional	29,781	29,714	99.8
5	Inspektimi në Punë	2,000	1,982	99.1
6	Përfshirja Sociale	15,750	12,300	78.1
7	Mbështetje për Kultet Fetare	169,830	169,752	100.0
8	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	97	97	100.0
TOTALI		256,491	244,264	95.2

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet kapitale me financim të huaj**, sipas programeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
3	Përkujdesi Social	44,000	41,930	95.3
6	Përfshirja Sociale	112,350	0	0

TOTALI	156,350	41,930	26.8
---------------	----------------	---------------	-------------

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet kapitale në total**, sipas programeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	13,261	4,704	35.5
2	Sigurimi Shoqëror	0	0	
3	Përkuqdesi Social	69,772	67,645	97.0
4	Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional	29,781	29,714	99.8
5	Inspektimi në Punë	2,000	1,982	99.1
6	Përfshirja Sociale	128,100	12,300	9.6
7	Mbështetje për Kultet Fetare	169,830	169,752	100.0
8	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	97	97	100.0
TOTALI		412,841	286,194	69.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, në mijë lekë, realizimi faktik, në mijë lekë dhe realizimi në përqindje sipas programeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në total, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	229,603	211,964	92.3
2	Sigurimi Shoqëror	47,715,000	47,715,000	100.0
3	Përkuqdesi Social	26,607,875	25,467,346	95.7
4	Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional	1,745,148	1,556,821	89.2
5	Inspektimi në Punë	194,671	179,746	92.3
6	Përfshirja Sociale	154,600	34,139	22.1
7	Mbështetje për Kultet Fetare	296,535	294,761	99.4
8	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	30,097	24,771	82.3
TOTALI		76,973,529	75,484,548	98.1

Burimi: Ministria e Financave (2015);

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, janë parashikuar 11 produkte, 10 nga të cilët janë realizuar plotësisht në terma sasiorë dhe në terma vlerorë. Kështu janë përpiluar, dokumentuar raporte periodike financiare, është bërë përmirësimi i sistemeve të IT, “Përmirësimi i infrastrukturës së IT-së” janë nxjerrë raporte mujore nga takimet me KE për Raport progresin e MIE, janë përgatitur raporte për auditimin, etj.

Në programin “**Sigurimi Shoqëror**” janë parashikuar 5 produkte: “Sigurime suplementare e trajtime të veçanta”, “Transferata tek buxhetet familjare të fondeve të buxhetit për kompensimin e çmimeve për statusin e veteranit, invalidët e luftës dhe të punës”, “Transferata tek buxhetet familjare nga sigurimi i detyrueshëm”, “Menaxhimi i Sigurimeve Shoqërore” dhe “Sigurime suplementare”. Për këto produkte raportohet se realizimi i tyre si në vlerë edhe në sasi është në nivelin 100 për qind.

Në programin “**Përkujdesi Social**” janë parashikuar 15 produkte, të cilat janë realizuar plotësisht në terma vlerorë dhe sasiorë, ku përmendim “Familje përfituese të ndihmës ekonomike”, “Individë të verbër përfitues nga programi i AK”, “Personat me aftësi të kufizuara mendore, fizike përfitues nga programi i AK”, “Fëmijë që përfitojnë shërbime në institucionet e përkujdesit”, etj.

Theksojmë se risi e vitit 2014 për këtë program dhe MMSR në tërësi është fakti se nga buxheti i shtetit u likuiduan 100 për qind borxhet e akumuluar në vitet e mëparëshme për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Personave me aftësi të kufizuar.

Në programin “**Punësimi, Formimi dhe Arsimi Profesional**” janë parashikuar 6 produkte, 5 nga të cilët rezultojnë të plotësuar pjesërisht në sasi. Janë trajnuar dhe pajisur me certifikatë 13, 102 persona nga programet e nxitjes së punësimit, janë ofruar ndërmjetësime për 16,000 punëkërkues të papunë, janë trajtuar me pagesë papunësie 7,703 persona nga 10 mijë persona të planifikuar, pasi ka pasur dalje të një numri personash nga skema dhe kjo është arsyeja e realizimit 89 për qind të këtij programi.

Në programin “**Inspektimi në Punë**” janë parashikuar 4 produkte, 2 të cilat janë realizuar plotësisht ndërsa “Inspektime të kryera” dhe “Inspektorë të trajnuar” janë realizuar pjesërisht.

Në programin “**Përfshirja Sociale**” janë parashikuar 9 produkte, 8 prej të cilëve raportohet se janë realizuar tërësisht ndërsa produkti “Linja 24 orëshe” raportohet se është mbyllur si produkt.

Në këtë program raportohet të jetë realizuar projekti me financim të huaj “Mbështetja për përfshirjen sociale të komunitetit rom” në vlerën 108 442 mijë lekë e cila në SIFQ nuk rezulton me realizim faktik.

Ndërsa projekti me financim të huaj “Modernizimi i Asistencës Sociale”, në programin “Përkujdesi Social” është realizuar në vlerën 41 930 mijë lekë siç raportohet edhe në tabelat e mësipërme.

5.12 MINISTRIA E MJEDISIT

MISIONI

Ministria e Mjedisit ka për mision të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, pyjeve, ujërave në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Mjedisit për vitin 2014, administroi dhe menaxhon fondet publike sipas pesë programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Buxheti i vitit 2014 për këtë ministri, është realizuar në rreth 88.3 për qind, siç duket edhe nga tabela e mëposhtme.

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	400.526	377.522	94.3
2	Mbrojtja e mjedisit	630.016	582.622	92.5
3	Administrimi i ujrave	216.290	164.385	76.0
4	Administrim i pyjeve	1.174.717	1.013.448	86.3
TOTALI		2.421.549	2.137.977	88.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Realizimi i shpenzimeve korente përllëgaritet në rreth 91.1 për qind, ndërsa realizimi i investimeve kapitale për Ministrinë e Mjedisit paraqitet në rreth 84.3 për qind.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi planifikim, administrim dhe menaxhim

Realizimi i shpenzimeve për këtë program, që përfaqëson rreth 17.6 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 95.4 për qind
- Shpenzimet kapitale 13.2 për qind
- Gjithsej 94.3 për qind**

Në programin “Planifikim, administrim dhe menaxhim”, janë parashikuar 19 produkte, ecuria e të cilëve rezulton përgjithësisht e kënaqshme, si në terma vlerore dhe në terma sasiorë. Janë realizuar plotësisht 18 produkte, e konkretisht: janë realizuar 11 auditime të brendshme në njësitë e vartësisë nga 11 auditime të planifikuara, janë realizuar trajnime të punonjësve brenda dhe jashtë vendit, janë përgatitur një sërë raportesh në kuadër të MSA-së, etj.

Programi “Mbrojtjen e Mjedisit”, realizimi i shpenzimeve, për këtë program, që përfaqëson rreth 27.3 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 87.1 për qind
- Shpenzimet kapitale 99.7 për qind
- Gjithsej 92.5 për qind**

Në programin “Mbrojtja e mjedisit” janë parashikuar 25 produkte, 21 prej të cilëve kanë një performancë të mirë, si në terma sasiorë, ashtu edhe në terma vlerore dhe 4 produkte rezultojnë të realizuara pjesërisht. Sipas raportimit nga kjo ministri janë kryer 2720 inspektime për zbatimin e kushteve mjedisore ndaj aktiviteteve industriale, me qëllim detyrimin e subjekteve industriale të zbatojnë kushtet e lejes mjedisore dhe të kryejnë vetëm monitorimin e shkarkimeve në ajër, ujë dhe në tokë. Janë kryer rreth 1560 inspektime për operatorët e menaxhimit të

mbetjeve urbane dhe të rrezikshme me objektiv detyrimin e organeve të qeverisjes vendore për të menaxhuar mbetjet urbane në territoret e tyre për vitin 2014.

Programi “Administrimi i Pyjeve”

Realizimi i shpenzimeve, për këtë program, që përfaqëson rreth 47.4 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korente | 94.8 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 79.3 për qind |
| Gjithsej | 86.3 për qind |

Në programin e administrimit të pyjeve janë parashikuar 16 produkte, të cilat rezultojnë me një performancë të mirë për vitin 2014.

10 produkte janë realizuar. Është realizuar azhurnimi i kadastrës kombëtare të fondit pyjor dhe kulloror me ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit. Është përgatitur praktika për hartimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor, të cilat do të hartohen nga DSHP. Mbështetur në programin vjetor të trajnimeve për shërbimin pyjor, sektori i mbarështimit dhe trajtimit ka përgatitur modulet e trajnimit dhe janë trajnuar 50 specialistë. Janë realizuar pjesërisht vetëm 5 produkte.

Programi “Administrimi i Ujërave”

Realizimi i shpenzimeve, për këtë program, që përfaqëson rreth 7.7 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| • Shpenzimet korente | 73.8 për qind |
| • Shpenzimet kapitale | 79.3 për qind |
| Gjithsej | 76.0 për qind |

Në programin administrimi i ujërave, janë parashikuar 14 produkte, ecuria e të cilëve rezulton e kënaqshme, si në terma vlerore dhe në terma sasiorë. Janë realizuar plotësisht 10 produkte, si raport për gjendjen e shtretërve të lumenjve dhe propozimi për masa, janë kryer raporte vlerësimi lidhur me shfrytëzimin e inerteve lumore në shtretërit e lumenjve, etj. 3 produkte janë realizuar pjesërisht.

5.13 MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

MISIONI

Ministria e Integrimit Evropian ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet hartimit të politikave të integrimit, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit, zbatimit të rekomandimeve të BE-së lidhur me përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, bashkërendimit të ndihmës financiare të BE-së dhe informimit të publikut mbi procesin e integrimit evropian.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Integrimit Evropian, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas tre programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Gjatë vitit 2014, buxheti i planifikuar për këto 3 programe, është realizuar në masën 88.1 për qind, sikurse duket edhe nga tabela e mëposhtme.

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit (%)
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	50 700	49 880	96,0
2	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	45 500	45 500	67,7
3	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit	92 500	74 962	95,2
TOTALI		188 700	170 342	88,1

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Shënim: Në këtë analizë është marrë vetëm financimi i brendshëm. Në analizë nuk mund të marrim financimin e huaj, pasi ka një tejkalim të realizimit, pasi në këtë program ka disbursim të financimit të huaj, jashtë planit.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Integrimit, për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të miratuar 2014 dhe realizimit faktik për 12-mujorin e këtij viti, jepet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Struktura e shpenzimeve sipas PBA-së Viti 2014 (në %)	Struktura e shpenzimeve sipas Buxhetit Viti 2014 (në %)	Struktura e shpenzimeve faktike për 12-mujorin Viti 2014 (në %)
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	12.1	29.3	17.8
2	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	7.3	26.7	11.5
3	Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimit	80.6	44.0	70.7
TOTALI		100	100	100

Burimi: Ministria e Financave (2015)

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Për kryerjen e veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në këtë program kemi një realizim të shpenzimeve, që përfaqëson rreth 96 për qind të totalit të buxhetit faktik. Krahasuar me planin vjetor zërat kryesorë, rezultojnë si më poshtë:

- Shpenzimet korentë 96 për qind
 - Shpenzimet kapitale 100 për qind
- Gjithsej 96 për qind**

Për këtë program gjatë vitit 2014 janë parashikuar për t'u realizuar 8 produkte, nga të cilat vetëm 2 produkte janë realizuar plotësisht, 6 produkte janë realizuar pjesërisht.

Në mijë lekë

NR.	Emri i Produktit	Plani 2014 Në 000 lekë	Realizimi 2014		
			Në 000 lekë	Në përqindje	Statusi i produktit
1	Shërbime financiare	12 000	11 500	96	Pjesërisht
2	Pajisje zyresh të tjera	2 000	1 998	100	Plotësisht
3	Pajisje elektrike,elektronike të reja	3 180	3 161	99	Plotësisht
4	Menaxhim i burimeve njerëzore	10 840	10 540	97	Plotësisht
5	Shërbime ligjore	400	280	70	Pjesërisht
6	Marrëdhënie ndërkombëtare	400	350	88	Pjesërisht
7	Sigurim i shërbimeve të përgjithshme	5 500	5 400	98	Pjesërisht
8	Menaxhim i lartë	14 000	13 500	96	Pjesërisht
TOTALI		48 320	46 729	96	

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Programi “Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm”

Gjatë vitit 2014, për programin Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm, sikurse tregohet edhe në tabelën e mëposhtme, janë përdorur 30 813 000 lekë nga 45 500 000 lekë të alokuara për këtë program ose afërsisht 67.7 për qind e buxhetit alokuar për vitin 2014.

Realizimi për secilin nga 4 produktet e këtij programi paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR	Emri i Produktit	Plani 2014	Realizimi 2013		
			Fakti	Në përqindje	Statusi i produktit
1	Kontributi i Qeverisë Shqiptare për Raportin e Progresit 2014	11 000	8 050	73	Plotësisht
2	Takime BE - Shqipëri	21 900	14 313	65.4	Plotësisht
3	Plani kombëtar për Integrimin Evropian	11 500	8 450	73.5	Plotësisht
4	Negocimi i kapitujve të veçantë negociues në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE	1 100	0	0	Aspak
TOTALI		45 500	30 813	67.7	

Burimi: Ministria e Financave (2015)

Produkti 1-Takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian, është realizuar plotësisht gjatë vitit 2014. Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2014 u zhvilluan takimet e institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si më poshtë:

- Nënkomiteti Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, Tiranë, datë 23 tetor 2014;
- Nënkomiteti Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet, Bruksel, datë 29 – 30 tetor 2014;
- Nënkomiteti Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale, Bruksel, datë 25 – 26 nëntor 2014.

Në kuadër të Nënkomitetit Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale, zhvilluar në Bruksel, më 25–26 nëntor 2014 dhe Nënkomitetit Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, zhvilluar në Tiranë, më 23 tetor 2014 u hartuan dhe u paraqitën shërbimeve të Komisionit Evropian informacionet shtesë/plotësuese të kërkuara prej tyre.

Po ashtu, gjatë 3-mujorit të katërt, Drejtorja për Politikat Sektoriale koordinoi dhe hartoi raportimet vijuese për nënkomitetet e mëposhtme:

- Nënkomiteti Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal, më 15 dhjetor 2014;
- Nënkomiteti Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, në dhjetor 2014.

Produkti 2-Kontributi i Qeverisë shqiptare për Raportin e Progresit 2014, është realizuar plotësisht. Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2014, Drejtorja për Politikat Sektoriale analizoi Raportin e Progresit të Komisionit Evropian duke identifikuar arritjet dhe rekomandimet për ministrinë dhe institucionet e tjera publike shqiptare.

Produkti 3- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është realizuar plotësisht. Plani Kombëtar u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 2.7.2014 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014 – 2020” dhe u monitorua zbatimi i tij në muajin shtator 2014 dhe dhjetor 2014.

Analiza e vitit 2014 do të shërbejë gjatë hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2015 – 2020.

Produkti 4-Negocimi i kapitujve të veçantë negociues në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, nuk është realizuar për shkak se Komisioni Evropian e ka shtyrë për një datë të mëvonshme marrjen e vendimit për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë.

Programi “Mbështetja institucionale për Procesin e Integrimin”

Për këtë Program në buxhetin e vitit 2014 janë alokuar 290,860 mijë lekë nga të cilat me financim të brendshëm janë alokuar 70,860 mijë lekë. Në buxhetin e parashikuar për vitin 2014, është e përfshirë edhe asistencë e huaj në dobi të Ministrisë së Integrimin Evropian dhe përkatësisht në dobi të këtij Programi në shumën prej 220,000.0 mijë lekë.

Për vitin 2014, nga ky program, financim të brendshëm janë realizuar 67,265 mijë lekë shpenzime nga 70,860 mijë lekë që është plani ose rreth 95 për qind e tij.

Sa i përket asistencës së huaj nga planifikimi prej 220,000 mijë lekë, shuma e realizuar e financimit të huaj është 159.480 mijë lekë ose rreth 72 për qind. Bashkëlidhur gjeni raportet për të dyja llojet e financimeve për vitin 2014.

Në mijë Lekë

NR.	Emri i Produktit	Plani 2013	Realizimi 2013		
			Fakti	Në përqindje	Statusi i produktit
1	Përkthimi i akteve ligjore	6 400	2 600	40.6%	Pjesërisht
2	Metodologji të hartuara dhe të rishikuara	16 400	13 434	81.9%	Pjesërisht
3	Negocimi i anëtarësimit në BE	2 500	0	0.0%	Aspak
4	Kontributi Shqiptar për PR	25 000	25 000	100.0%	Plotësisht

5	Trajnimi dhe ndërgjegjësimi mbi procesin e integritimit	2 400	2 400	100.0%	Plotësisht
6	Hartimi i planit kombëtar për zbatimin e MSA-së	2 300	2 300	100.0%	Plotësisht
7	Informimi mbi procesin e anëtarësimit në BE	2 580	2 580	100.0%	Plotësisht
8	Paketa e projekteve IPA shumëpërfitues e miratuar	30 000	29 500	98.3%	Pjesërisht
9	Programimi i asistencës financiare BE (IPA II) për vitin aktual sipas prioriteteve	32 000	32 000	100.0%	Plotësisht
10	Miratim i projekt propozimeve për raundet vjetore të WBIF	800	700	87.5%	Pjesërisht
11	Programe BNK të miratuara/rishikuara	124 180	72 431	58.3%	Pjesërisht
12	Ditë informimi partneriteti dhe sesione trainimi të realizuara për përfituesit	0	0	0.0%	Aspak
13	Kapacitete funksionale për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE	1 600	1 300	81.3%	Pjesërisht
14	Marrëveshje financiare të IPA të miratuara	18 000	17 000	94.4%	Pjesërisht
15	Monitorimi i programeve IPA	19 000	18 500	97.4%	Pjesërisht
16	Mirëmbajtje dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	1 500	1 500	100.0%	Plotësisht
17	Rishikimi i përkthimit të legjislacionit evropian	6 200	5 500	88.7%	Pjesërisht
	SHUMA	290 860	226 745	78.0%	
1	FINANCIMI HUAJ /Mbështetje për Ministrinë e Integritimit III	42,600.0	42,400.0	99.5%	Plotësisht
2	FINANCIMI HUAJ /Mbështetje për zbatimin e programeve IPA CBC	122,200.0	61,880.0	50.6%	Plotësisht
3	FINANCIMI HUAJ /Mbështetje për përgatitjen e projekteve *(ka pësuar shtyrje dhe shtesë fondi, si pasojë realizimi 3-mujor është më i madh se plani vjetor)	55,200.0	55,200.0	100.0%	Aspak
	Tot Financimi i Huaj	220,000.0	159,480.0	72.5%	
	SHUMA	290,860.0	226,745.0	78.0%	

Gjatë këtij vitit janë realizuar plotësisht 6 produkte dhe pjesërisht 9 produkte.

Gjatë vitit 2014 për sa i përket produkteve të parashikuara për këtë program statusi i realizimit të aktiviteteve për ato produkte, të cilat janë aktive pra për të cilat janë miratuar fonde në PBA për vitin 2014, është si më poshtë:

- **Përkthimi i akteve ligjore**

Gjatë këtij viti është bërë përkthimi i direktivave të ndryshme të BE, me qëllim përafrimin e tyre me kuadrin tonë ligjor.

- **Metodologji të hartuara dhe rishikuara**

Gjatë këtij viti është hartuar metodologjia për hartimin dhe rishikimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014 – 2020, në bashkëpunim me SMEI 3. Në metodologjinë e parë përcaktohet mënyra e monitorimit të zbatimit të këtij Plani. Gjithashtu, është rishikuar dhe

përditësuar metodologjia për hartimin e kontributit të Qeverisë Shqiptare në kuadër të Raportit të Progresin, në përputhje me ecurinë e procesit të Integritimit Evropian të Shqipërisë.

- **Negocimi i anëtarësimit në BE**

Shqipëria mori statusin e vendit kandidat në 24 qershor 2014. Deri në hapjen e negociatave, Shqipëria duhet të përmbushë 5 prioritetet e caktuara nga Komisioni Evropian.

- **Kontributi shqiptar për PR**

Kontributi i parë i Progresit të Raportit u dorëzua në 2 maj 2014, ndërsa kontributi i dytë i Progresit të Raportit u dorëzua në datën 1 shtator 2014.

- **Trajnimi dhe ndërgjegjësimi mbi procesin e integritimit**

Në periudhën raportuese janë organizuar trajnimet e përmuajshme nga Projekti SMEI 3 mbi zhvillimet më të fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, në bashkëpunim me SMEI 3 janë organizuar trajnimet për Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integritimin Evropian, për hartimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) dhe të Progres Raportit.

- **Hartimi i planit kombëtar për zbatimin e MSA-së**

Ka përfunduar procesi i hartimit të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 108, datë 28.2.2014 “Për hartimin dhe rishikimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian, 2014 – 2020”. PKIE 2014 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 2.07.2014 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian, 2014 – 2020”. Në muajin shtator nisi procesi i monitorimit të PKIE-së, i cili është parashikuar të përfundojë në fund të muajit janar 2015.

- **Informimi mbi procesin e anëtarësimit në BE**

Gjatë kësaj periudhe janë informuar dhe shpërndarë materiale informuese për studentët lidhur me procesin e integritimit. Gjithashtu, janë shpërndarë edhe fletëpalosjet për arritjet e 300 ditëve për ministritë e linjës, agjencitë në varësi të tyre dhe agjencitë e pavarura, institucione të tjera, bashkitë dhe komunat, shkollat e mesme dhe universitetet.

- **Paketa e projekteve IPA shumëpërfitues i miratuar**

Gjatë muajit korrik 2014, Komisioni Evropian ka dërguar për komente Dokumentet e Veprimit për IPA me Shumë Përfitues 2014. Strukturat shqiptare bënë komentet përkatëse dhe i dërguan ato në KE. Në fund të vitit 2014 Paketa IPA me Shumë Përfitues u miratua nga Komisioni Evropian, duke i hapur kështu rrugë implementimit të projekteve. Ndërkohë janë evidentuar Prioritetet për IPA me Shumë Përfitues 2015.

- **Programimi i asistencës financiare BE (IPA II) për vitin aktual sipas prioriteteve**

Aktualisht është finalizuar procesi i përgatitjes së Programit Vjetor IPA 2014 dhe është dërguar në Komisionin Evropian drafti përfundimtar i Dokumenteve të Veprimit. Pas shqyrtimit nga strukturat e DG ELARG, Programi IPA 2014 u miratua nga Komisioni Evropian në 17 dhjetor 2014 dhe mendohet se implementimi i projekteve të nisë pas prillit 2015. Ndërkohë është drejt finalizimit procesi i evidentimit të prioriteteve për Programin vjetor IPA 2015.

- **Miratim i projekt propozimeve për raundet vjetore të WBIF**

Në raundin informal të Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF), 31 gusht 2014, Shqipëria dorëzoi për financim tre propozime nën koordinimin e Ministrisë së Integritimit Evropian me përfitues të mundshëm: Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Në muajin dhjetor 2014 u zhvillua takimi i Komitetit Drejtues të WBIF, i cili nga aplikimet e Shqipërisë shpalli fitues projektin e mëposhtëm: “Studim i detajuar për ndërlidhjen 400 kV OHTL Elbasan-Bitola (pjesa shqiptare)”.

- **Programe BNK të miratuara/rishikuara**

Gjatë kësaj periudhe janë ndjekur procedurat për draftimin dhe finalizimin e draft dokumenteve të programeve të reja të Bashkëpunimit Ndërkufitar që do të zbatohen gjatë periudhës 2014-2020. Në këtë kuadër janë dorëzuar në Komisionin Evropian programet: IPA CBC Shqipëri-Kosovë, IPA CBC Mali i Zi-Shqipëri, IPA CBC Maqedoni-Shqipëri, IPA CBC Greqi-Shqipëri, IPA CBC Ballkan-Mediterran, Programi MED (Mediterran) dhe Programi ADRION.

Gjatë dhjetorit 2014 janë miratuar nga Komisioni Evropian tre programe IPA-IPA (IPA CBC Shqipëri-Kosovë, IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri, IPA CBC Maqedoni – Shqipëri) dhe gjatë vitit 2015 pritet të miratohen edhe programet e tjera.

Gjithashtu, në këtë periudhë janë organizuar një sërë takimesh konsultative me grupet e interesit, si dhe me përfaqësues të KE dhe vendet pjesëmarrëse në këto programe.

- **Kapacitete funksionale për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve funksionale për menaxhimin e decentralizuar janë zhvilluar disa seanca trajnimi dhe seminare. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar aktivitete trajnimi për shpjegimin e risive që ka sjellë instrumenti i IPA II. Fokus primar është vendosur në analizimin e konceptit të mbështetjes buxhetore dhe mënyrës së plotësimit të Dokumentit të Planifikimit Sektorial.

- **Marrëveshje financiare të IPA të miratuara**

Gjatë vitit 2014 janë finalizuar dhe nënshkruar Marrëveshjet si më poshtë:

- Marrëveshja e Financimit IPA 2013 (menaxhim i centralizuar);
- Marrëveshja e Financimit IPA 2013, (menaxhim i decentralizuar);
- Amendimi i Marrëveshjes së Financimit për IPA 2012.

Ndërkohë kanë nisur procedurat për miratimin në parim të Marrëveshjes Kuadër IPA II.

- **Monitorimi i programeve IPA**

Akreditimi i strukturave që do të menaxhojnë fondet IPA miratuar më 25 mars 2014 nga Komisioni Evropian ka qenë një nga ngjarjet më të rëndësishme në kuadrin e monitorimit të programit IPA komponenti I. Gjithashtu edhe zhvillimi i takimit të Komitetit të monitorimit IPA është aktiviteti më i rëndësishëm i kësaj periudhe.

Ndërkohë, ka vijuar ndjekja dhe monitorimi i projekteve IPA në zbatim me fokus projektet problematike, për adresimin e të cilave janë zhvilluar disa takime ndërinstucionale.

Gjithashtu, gjatë tremujorit të fundit 2014 ka vijuar sipas parashikimit monitorimi i projekteve IPA CBC në zbatim me fokus projektet problematike.

Në kuadër të monitorimit të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA CBC me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Greqinë, janë zhvilluar vizitat monitoruese sipas kalendarit të propozuar. Gjatë muajit nëntor u zhvilluan trajnimet lidhur me çështje të implementimit të kontratave për përfituesit e kontratave të reja të grantit të nënshkruara gjatë muajit shtator nga programet CBC me Greqinë dhe Kosovën, të cilat kanë hyrë tashmë në fazën e implementimit.

- **Mirëmbajtje dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit**

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar puna për mirëmbajtjen dhe pasurimin e website të MIE. Në website janë pasqyruar në kohë reale takimet e Ministres, eventet kryesore të organizuara, njoftime, etj.

- **Rishikim i përkthimit të legjislacionit evropian**

Gjatë këtij viti është bërë rishikimi dhe redaktimi juridik, teknik dhe gjuhësor i një sërë direktivash, planeve të veprimit të Shqipërisë si dhe raporteve të progresit etj.

5. 14 MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

MISIONI

Misioni i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë konsiston në: “Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjitike dhe minerale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore për mjedisin”

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Industrisë dhe Energjisë, për vitin 2014, ka administruar fondet për katër programe. Programet sipas të cilave janë administruar fondet buxhetore nga kjo ministri janë të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas katër programeve buxhetore të miratuara, e më specifikisht:

- Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”
- Mbështetje për Energjinë
- Mbështetje për Burimet Natyrore
- Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike të hidrokarbureve dhe minierave

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë mbi monitorimin e buxhetit për periudhën 12-mujore, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë institucion, paraqitet si më poshtë vijon.

	Emërtimi	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	Përqind e realizimit
1.	Shpenzime Korente	890.510	702.509	65,3%	60,3%	78,9%
1.1	Personeli	429.186	398.917	31,5%	34,2%	92,9%
1.2	Operative	461.324	303.592	33,8%	26,0%	65,8%
2	Shpenzime kapitale	473.274	454.454	34,7%	39,0%	96,0%
2.1	Financim i brendshëm	282.274	280.393	20,7%	24,0%	99,3%
2.2	Financim i huaj	191.000	174.061	14,0%	14,9%	91,1%
3	SHUMA	1.363.784	1.156.963	100,0%	99,2%	84,8%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		8.954	0,0%	0,8%	
4	TOTALI	1.363.784	1.165.917	100,0%	100,0%	85,5%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse evidentohet edhe nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente përbëjnë rreth 65 për qind të fondeve të planifikuara për 2014 për MEI dhe rreth 60 për qind të shpenzimeve faktike të periudhës 12-mujore. Shpenzimet korente paraqesin një realizim prej 78.9 për qind në raport me planin vjetor. Shpenzimet për personelin, rezultojnë në rreth 31.5 për qind të planit total vjetor, ndërkohë që shpenzimet operative rezultojnë në 33.8 për qind të planit. Niveli i investimeve, i planifikuar për vitin 2014, përbën rreth 35 për qind të fondeve të institucionit dhe në terma vjetorë ato paraqesin një nivel realizimi prej 96 për qind. Kjo tregon një përshejtim të zbatimit të projekteve të investimeve në raport me pjesën tjetër të vitit, ku niveli i realizimit i investimeve ka qenë më i ulët.

Për periudhën 12-mujore, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, për secilin program, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			TOTALI I SHPENZIMEVE		% e realizimit
	PLAN	FAKT	Realizimi	PLAN	FAKT	Realizimi	Plan	Fakt	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	448,736	312,015	69.5	302,500	284,266	94.0	751,236	596,281	79.4
Mbështetje për Energjinë	12,000	8,309	69.2	763	751	98.4	12,763	9,060	71.0
Mbështetje për Burimet Natyrore	164,647	153,637	93.3	103,919	104,055	100.1	268,566	257,692	96.0
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Standardeve të Hidrokarbureve dhe Minierave	265,127	228,548	86.2	66,092	65,382	98.9	331,219	293,931	88.7
TOTALI	890,510	702,509	78.9	473,274	454,454	96.0	1,363,784	1,156,964	84.8

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Për të katërt programet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, përqindja e realizimit të shpenzimeve, varion nga 71 për qind për programin “Mbështetje për energjinë”, deri në 96 për qind për programin “Mbështetje për Burimet Natyrore”, gjë që ka çuar në një realizim prej 84.8 për qind në rang institucioni.

Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime 2014 dhe realizimit të tremujorit të katërt të vitit 2014, paraqitet si më poshtë:

Kodi	Emërtimi i Programit	Struktura e Buxhetit 2014 (në %)		
		Plani Fillestar	Plani me ndryshime	Fakti
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	54.5	55.1	51.5
04320	Mbështetje për Energjinë	1.0	0.9	0.8
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	19.7	19.7	22.3
04440	Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike të hidrokarbureve dhe minierave	24.8	24.3	25.4
	TOTALI	100.00	100.00	100.00%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në terma vjetorë, programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, zë rreth 55 për qind të fondeve totale të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në vitin 2014. Ndërkohë, referuar shpenzimeve faktike të 12-mujorit, evidentohet se shpenzimet për aparatën e MEI-t rezultojnë të jenë 51.5 për qind e shpenzimeve të periudhës. Pjesa tjetër e fondeve të miratuara për këtë ministri, shpërndahen në tre programet buxhetore sipas radhës së mëposhtme: rreth 20 për qind e totalit të shpenzimeve faktike, janë përdorur në programin buxhetor “Mbështetje për Burimet Natyrore”, 25 për qind në “Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike të hidrokarbureve dhe minierave” dhe në fund vetëm 1 për qind në programin “Mbështetje për Energjinë”.

MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE DHE PRODUKTEVE BUXHETORE

Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 51.5 për qind të totalit të shpenzimeve 12-mujore, të fondeve të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Sipas zërave kryesorë të klasifikimit ekonomik, krahasuar me planin vjetor, dhe faktin e periudhës, realizimi paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani/Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	448,736	312,015	59.7%	52.3%	69.5%
1.1	<i>Personeli</i>	130,186	117,045	17.3%	19.6%	89.9%
1.2	<i>Operative</i>	318,550	194,970	42.4%	32.7%	61.2%
2	Shpenzime kapitale	302,500	284,266	40.3%	47.7%	94.0%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	111,500	110,205	14.8%	18.5%	98.8%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	191,000	174,061	25.4%	29.2%	91.1%
3	TOTALI	751,236	596,281	100.0%	100.0%	79.4%

Burimi: Ministria e Financave(2015);

Sikurse mund të konstatohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet korente faktike prej 312 milionë lekë, që përbëjnë 52.3 për qind të fondeve totale të shpenzuara për vitin 2014, paraqesin një nivel realizimi prej rreth 70 për qind. Brenda tyre, shpenzimet për personelin, të parashikuara në 117 milionë lekë, paraqesin një nivel realizimi prej rreth 90 për qind të planit vjetor, ndërkohë që edhe shpenzimet operative shfaqin një nivel realizimi mjaft të ulët prej vetëm 61.2 për qind, në terma vjetorë.

Referuar të dhënave analitike në këtë zë ku konstatohet një nivel i ulët realizimi, theksojmë se në shpenzimet e sipërpërmendura në planin e vitit 2014 janë përfshirë edhe fondet e planifikuar për pagesat e konsulencës për CEZ Sh.a në zbatim të VKM nr. 137 datë 20.02.2013 dhe VKM nr. 141, datë 20.02.2013 lidhur me pagesat e studiove ligjore, ekspertëve teknikë dhe financiare të kontraktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë CEZ sh.a. Duke qënë se problemet ligjore me CEZ. Sh.a gjatë vitit 2014 janë zgjidhur, pjesa e mbetur e këtij fondi nuk është shpenzuar dhe për këtë arsye ky zë rezulton me realizim më të ulët.

Shpenzimet kapitale, prej 284.3 milionë lekë, përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxhetit të MEI-t, për vitin 2014. Gjithashtu, në përbërjen e investimeve vihet re prevalenca absolute në planifikim e projekteve me financim të huaj, prej 191 milionë lekë në vit. Më konkretisht, shpenzimet kapitale përbëjnë 40 për qind të buxhetit vjetor të miratuar për MEI-n dhe 48 për qind të shpenzimeve faktike të periudhës. Investimet janë realizuar në 94 për qind të fondit vjetor.

Përgjithësisht, një arsye për këtë nivel të ulët realizimi në total të programit prej vetëm 79.4 për qind është procesi i prokurimit publik, i cili kërkon plotësimin e afateve ligjore, të cilat në mjaft raste mund të kërkojnë një periudhë të gjatë kohe. Në këtë program janë parashikuar 12 produkte buxhetore, të cilat, janë realizuar plotësisht në terma sasiorë, ndërkohë që në vlerë janë realizuar në masën 79.4 për qind të planit vjetor prej 751 milionë lekë.

Programi “Mbështetje për Energjinë”

Ky program përmbledh vetëm 1 për qind të fondeve vjetore të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Në total, programi rezulton me një realizim të shpenzimeve prej rreth 71 për qind, ndërkohë që shpenzimet për personelin, si zëri kryesor i shpenzimeve për programin, shfaqin nivelin realizimit prej rreth 80 për qind të planit vjetor të programit.

Në mijë lekë

04320	Mbështetje për Energjinë	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	12,000	8,309	94.0%	91.7%	69.2%
1.1	<i>Personeli</i>	9,000	7,206	70.5%	79.5%	80.1%
1.2	<i>Operative</i>	3,000	1,103	23.5%	12.2%	36.8%
2	Shpenzime kapitale	763	751	6.0%	8.3%	98.4%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	763	751	6.0%	8.3%	98.4%
2.2	<i>Financim i huaj</i>	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	12,763	9,060	100.0%	100.0%	71.0%
	<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</i>	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	12,763	9,060	100.0%	100.0%	71.0%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në këtë program është parashikuar vetëm një produkt buxhetor i lidhur me kuadrin ligjor, i cili raportohet të jetë realizuar plotësisht në terma sasiorë dhe sikurse tregon tabela e mësipërme, pjesërisht në terma të vlerës. Ministria e Energjisë dhe Industrisë duhet të punojë për identifikimin dhe emërtimin e përshtashëm të disa produkteve buxhetore për këtë program.

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”

Realizimi i shpenzimeve të këtij programi përfaqëson rreth 22.3 për qind të totalit të shpenzimeve faktike 12-mujore. Sipas zërave kryesore krahasuar me zërat e planit vjetor realizimi paraqitet si më poshtë:

04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	Përqindje realizimit
-------	---------------------------------	-------	-------	-------------------	--------------------	-------------------------

1.	Shpenzime Korente	164.647	153.636	61,3%	57,6%	93,3%
1.1	Personeli	132.700	128.398	49,4%	48,2%	96,8%
1.2	Operative	31.947	25.238	11,9%	9,5%	79,0%
2	Shpenzime kapitale	103.919	104.055	38,7%	39,0%	100,1%
2.1	Financim i brendshëm	103.919	104.055	38,7%	39,0%	100,1%
2.2	Financim i huaj	0	0	0,0%	0,0%	
3	SHUMA	268.566	257.691	100,0%	96,6%	96,0%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	8.954	0,0%	3,4%	
4	TOTALI	268.566	266.645	100,0%	100,0%	99,3%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”, përmbledh fondet e miratuara për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, dhe fondet e alokuara nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për këtë program, përbëjnë rreth 19.7 për qind të fondeve të miratuara për këtë ministri. Sikurse evidentohet nga tabela e mësipërme, për vitin 2014, shpenzimet për personelin përbëjnë rreth 49 për qind të planit vjetor dhe shfaqin një nivel realizimi prej rreth 97 për qind. Ndërkohë shpenzimet operative sërish shfaqin një nivel realizimi prej rreth 79 për qind. Shpenzimet kapitale në këtë program, shfaqin një nivel realizimi më të lartë sa ato të programeve të tjera, me 100 për qind, në raport me planin vjetor. Si konkluzion, ky program rezulton me një nivel realizimi të shpenzimeve buxhetor prej rreth 99.2 për qind, duke shfaqur kështu një performancë mjaft të mirë. Në këtë program janë parashikuar 13 produkte buxhetore, të lidhura me auditime, raportime, vlerësime, studime e të ngjashme, të cilat janë realizuar plotësisht në terma sasiorë, në raport me planin vjetor.

Programi “Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike të hidrokarbureve dhe minierave”

Gjithashtu edhe ky program përmbledh 24.3 për qind të fondeve të miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për vitin 2014 dhe në kompleks, përmbledh fondet e miratuara për funksionimin e Inspektoriatit Qendror Teknik. Realizimi i shpenzimeve krahasuar me planin vjetor jepet nga tabela e mëposhtme:

Në mijë lekë

04440	Mbështetje për Mbikëqyrjen e Standardeve të Hidrokarbureve dhe Minierave	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti / Totalin	Perqindja e realizimit
1.	Shpenzime Korente	265,127	228,549	80.0%	77.8%	86.2%
1.1	Personeli	157,300	146,268	47.5%	49.8%	93.0%
1.2	Operative	107,827	82,281	32.6%	28.0%	76.3%
2	Shpenzime kapitale	66,092	65,382	20.0%	22.2%	98.9%
2.1	Financim i brendshëm	66,092	65,382	20.0%	22.2%	98.9%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	0.0%	
3	SHUMA	331,219	293,931	100.0%	100.0%	88.7%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0.0%	0.0%	
4	TOTALI	331,219	293,931	100.0%	100.0%	88.7%

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sikurse mund të evidentohet edhe nga tabela, programi paraqet një nivel realizimi të shpenzimeve publike prej rreth 89 për qind në total, ndërkohë që shpenzimet korente janë realizuar në masën rreth 86.2 për qind për vitin 2014. Sërish shpenzimet e personelin renditen në nivelin prej 93 për qind të planit vjetor, ndërsa shpenzimet operative sërish në nivele të ulta, prej 76.3 për qind. Shpenzimet kapitale janë realizuar në një nivel të lartë. Investimet këtu përbëjnë rreth 20 për qind të fondeve të planifikuara ndërkohë që realizimi i tyre për periudhën 12-mujore është vetëm 98.9 për qind. Në këtë program janë parashikuar 9 produkte buxhetore, të cilat janë realizuar plotësisht në terma sasiorë, me një një buxhet prej 294 milionë lekë, nga 331 milionë lekë të parashikuar.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË SHPENZIMEVE FAKTIKE

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e shpenzimeve faktike të raportit të hartuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të krahasuara me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit në Ministrisë së Financave.

Në mijë lekë

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	MEI	MF	Dif	MEI	MF	Dif.	MEI	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	312.015	312.015	0	284.266	284.266	0	596.281	596.281	0
Mbështetje për Energjinë	8.309	8.309	0	751	751	0	9.060	9.060	0
Mbështetje për Burimet Natyrore	153.637	153.637	0	104.055	104.055	0	257.692	257.692	0
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Standardeve të Hidrokarbureve dhe Minierave	228.548	228.548	0	65.382	65.382	0	293.931	293.931	0
Totali i Shpenzimeve	702.509	702.509	0	454.455	454.455	0	1.156.964	1.156.964	0

Burimi: Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (2015);

Sikurse evidentohet nga tabela me sipër, nuk ka diferenca midis të dhënave faktike të raportuara nga institucioni dhe të dhënave të regjistruara në sistemin e thesarit.

VOLUMI DHE MADHËSIA E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për të katërt programet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Programet	Buxheti fillestar 2014	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	676,990	751,235	74,245
Mbështetje për Energjinë	13,000	12,763	-237
Mbështetje për Burimet Natyrore	244,200	268,566	24,366
Mbështetje për mbikëqyrjen e standardeve teknike të hidrokarbureve dhe minierave	308,040	331,219	23,179

Totali i institucionit	1,242,230	1,363,783	121,553
-------------------------------	------------------	------------------	----------------

Burimi: Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (2015);

Ndryshimet në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e miratuara për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në vijim të:

- përdorimin e fondit të veçantë, rreth 8 milionë lekë, sipas miratimeve rast pas rasti nga Ministri i Financave, konform legjislacionit në fuqi dhe në vijim të kërkesave të institucionit;
- ndryshimeve të fondeve me Aktet Normative, shuma totale rezultuese me shtesat dhe pakësimet për programet, 31.3 milionë lekë,
- Vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilat kanë prekur nëpërmjet ri-shpërndarjes dhe pakësimit fondet e MEI në shumën përfundimtare rezultuese prej -2 milionë lekë.
- Pjesa më e madhe e ndryshimit të planit vjen si pasojë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për MEI, ku janë akorduar fonde në shumën prej rreth 91.5 milionë lekë.

5.16 MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

MISIONI

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ka si mision të saj hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë modernizimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban, strehimit, legalizimit e integritit të ndërtimeve informale dhe turizmit.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në përputhje me legjislacionin përkatës kjo ministri e ushtroi veprimtarinë e saj për vitin 2014 në:

- Fushën e planifikimit e të zhvillimit urban, administrimit të tokës dhe zhvillimit të qëndrueshëm e kontrollit të territorit;
- Fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit;
- Fushën e strehimit;
- Fushën e legalizimit e integritit të zonave dhe ndërtimeve informale;
- Fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial.

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas tre programeve të miratuara, të paraqitura në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Buxhetit 2014

Situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve faktike të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Programit	Përqindja e realizimit të shpenzimeve kundrejt planit të vitit 2014
Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	66.5
Planifikim Urban dhe Strehimi	96.5
Zhvillimi i Turizmit	97.7

TOTALI**91.3***Burimi: Ministria e Financave (2015);*

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, realizimi faktik për vitin 2014 paraqitet i tillë:

Emërtimi i Programit	Shpenzime korente (në %)	Shpenzime kapitale (në %)
Planifikim, menaxhim dhe administrim	92.6	41.7
Planifikim Urban dhe Strehimi	97.5	93.5
Zhvillimi i Turizmit	97.7	94.4
TOTALI	96.9	77.4

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet korente**, sipas programeve të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	243,602	225,480	92.6
2	Planifikim Urban dhe Strehimi	1,660,136	1,618,203	97.5
3	Zhvillimi i Turizmit	131,153	128,195	97.7
	TOTALI	2,034,891	1,971,878	96.9

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të sistemit financiar informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm**, sipas programeve të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	255,712	106,563	41.7
2	Planifikim Urban dhe Strehimi	563,037	526,680	93.5
3	Zhvillimi i Turizmit	2,252	2,125	94.4
	TOTALI	821,001	635,368	77.4

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të sistemit financiar informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje **për shpenzimet kapitale me financim të Huaj**, sipas programeve të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim			

2	Planifikim Urban dhe Strehimi	720,000	894,779	124.3
3	Zhvillimi i Turizmit			
TOTALI		720,000	894,779	124.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje sipas programeve të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, **në total (pa financimin e huaj)**, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	499,314	332,043	66.5
2	Planifikim Urban dhe Strehimi	2,223,173	2,144,883	96.5
3	Zhvillimi i Turizmit	133,405	130,320	97.7
TOTALI		2,855,892	2,607,246	91.3

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të qeverisë, plani me ndryshime i buxhetit të vitit 2014, realizimi faktik dhe realizimi në përqindje sipas programeve të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, **në total me financimin e huaj**, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

NR.	Emërtimi i Programit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	499,314	332,043	66.5
2	Planifikim Urban dhe Strehimi	2,943,173	3,039,662	103.3
3	Zhvillimi i Turizmit	133,405	130,320	97.7
TOTALI		3,575,892	3,502,025	97.9

Burimi: Ministria e Financave (2015);

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE

1. Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”

Me anë të këtij programi synohet të arrihet mbulim eficient i nevojave, për një mbarëvajtje sa më të mirë të punës brenda institucionit, si dhe realizimi i misionit të MZHUT, brenda fushës që mbulon. Ky program synon edhe mbulimin dhe pjesëmarrjen e strukturave përkatëse brenda MZHUT, në aktivitetet dhe trajnimet brenda dhe jashtë vendit.

Për vitin 2014, ky program që ka përfaqësuar vetëm 9.5 për qind të totalit të shpenzimeve faktike të ministrisë, rezulton me një realizim prej rreth 66.5 për qind të planit vjetor me ndryshime.

Sipas klasifikimit ekonomik realizimi i shpenzimeve të këtij programi paraqitet si më poshtë (në mijë lekë):

NR.	Emërtimi i Shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
-----	-----------------------	------------	------------	------------------------

1	Shpenzime korrente	243 602	225 480	92.6
2	Shpenzime kapitale	255 712	106 563	41.7
TOTALI		499 314	332 043	66.5

Burimi: *Ministria e Financave (2015)*;

Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, u parashikuan 5 produkte. Produkti “Administrata funksionale” rezulton i realizuar pjesërisht si rrjedhojë e mosplotësisht të organikës. Produktet “Blerje pajisje zyrash”, “Blerje Pajisje elektronike” dhe “Sipërfaqe e godinës e rikonstruktuar” rezultojnë të realizuara plotësisht.

Në performancën e ulët në realizimin e shpenzimeve të këtij programi ndikimin kryesor e jep mosrealizimi i plotë i investimeve për produktin “Shpronësime të pasurive të paluajtshme në seg. Skelë-Vlorë dhe Lin-Pogradec”.

2. Programi “Planifikimi urban dhe strehimi”

Ky program harton, mbështet dhe monitoron proceset planifikuese kombëtare dhe rajonale, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit; promovon dhe monitoron projektet për zhvillimin e zonës bregdetare; harton, mbështet zbatimin dhe monitoron politika për strehimin; mbështet nëpërmjet studimeve zbatimin e politikave kombëtare dhe rajonale për depotizimin e mbetjeve urbane; kryen procesin e legalizimit dhe përpunimit të informacionit tekniko-ligjor për ndërtimet informale dhe siguron financime për realizimin e politikave të programit.

Shpenzimet faktike për programin “Planifikimi Urban dhe Strehimi”, që përfaqësojnë rreth 86.8 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, ishin realizuar në rreth 103.3 për qind të planit vjetor me ndryshime.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi i shpenzimeve të këtij programi paraqitet si më poshtë, (në mijë lekë):

NR.	Emërtimi i Shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Shpenzime korrente	1 660 136	1 618 451	97.5
2	Shpenzime kapitale	1 283 037	1 421 458	110.8
TOTALI		2 943 174	3 039 909	103.3

Burimi: *Ministria e Financave (2015)*;

Në programin “Planifikimi urban dhe strehimi” që përfaqëson rreth 86.8 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, paraqitet me një realizim prej rreth 103.3 për qind të planit vjetor me ndryshime, për shkak të realizimit të financimit të huaj mbi planifikimin 2014 në masën 124.3 për qind. Në këtë program janë parashikuar 12 produkte, të cilat në përgjithësi janë realizuar plotësisht.

3. Programi “Zhvillimi i Turizmit ”

Programi i zhvillimit të turizmit mbështetet në strategjinë sektoriale të turizmit, në planin e veprimtimit dhe të masave në strategjitë ndër-sektoriale. Ai synon përmirësimin në vazhdimësi të

kuadrit ligjor për turizmin, me fokus harmonizimin e tij me politikat e qeverisë; përmirësimin e klimës së biznesit, etj. MZHUT në bashkëpunim me pushtetin vendor, synon ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të përmirësuar cilësinë e produktit turistik, rritjen e cilësisë së shërbimeve turistike, mbrojtjen e konsumatorit, etj.

Realizimi i shpenzimeve faktike për programin “Zhvillimi i turizmit”, që përfaqëson rreth 3.7 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, është rreth 97.7 për qind të planit vjetor me ndryshime.

Sipas klasifikimit ekonomik realizimi i shpenzimeve të këtij programi paraqitet si më poshtë (në mijë lekë):

NR.	Emërtimi i Shpenzimit	Plani 2014	Fakti 2014	Përqindja e realizimit
1	Shpenzime korrente	131 153	128 195	97.7
2	Shpenzime kapitale	2 252	2 125	94.4
TOTALI		133 405	130 320	97.7

Burimi: Ministria e Financave (2015);

Në programin “Zhvillimi i turizmit” që përfaqëson rreth 3.7 për qind të totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2014, paraqitet me një realizim prej rreth 97.7 për qind të planit vjetor me ndryshime, janë parashikuar 7 produkte, ku mund të përmendim “Sipërmarrje turistike të monitoruara”, “Marketing promocion për përmirësimin e imazhit” apo “Trajnim i stafit” të realizuar në masën 100 për qind.

MINISTRIA E FINANCAVE